

LE MONDE. *shqip* diplomatique

Një rezultat
që nuk do të
pranohet

Nga Serge Halimi
/Faqe 3

Nr. 798 / Viti i 67 i botimit / Tetor 2020

KOSOVA PAS NGRITJES SË AKTAKUZAVE NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK

(Pa)drejtësia ndërkombëtare dhe narracioni i (pa)mundur i luftës çlirimtare



NGA BELGZIM KAMBERI

Shumë pikëpyetje janë ngritur në shoqërinë kosovare pas ngritjes së aktakuzave ndaj ish-krerëve të UÇK-së. A është e mundur drejtësia tranzicionale? A do të sjellë gjykata speciale drejtësi? Ç'do të prodhojnë proceset gjyqësore në raport me narracionin e (pas)luftës dhe me të vërtetën? //faqe 2

A ËSHTË I MUND SHËM NJË SISTEM PENSIONAL I NDARË NGA KARRIERA?

Për një pension realisht universal



Përkundër këshillës së organizatave të punonjësve dhe punëdhënësve, Presidenti i Republikës është i vendosur ta reformojë sistemin e pensioneve. Nën pretekstin e standardizimit, modeli i propozuar, i cili rrënon themelet e uljes së moshës së pensionimit të plotë, rrezikon të rezultoi në varfërimin e shumicës. Reflektimi mbi një arkitekturë të mundshme universale kalon nëpër një rrugë krejt ndryshe.

NGA ANNE DEBREGEAS*

Gjatë mobilizimit të gjerë kundër projektit të reformës së pensioneve në dimrin e kaluar, kërkesat mbetën kryesisht të modeluara sipas sistemit ekzistues, me synim ruajtjen e standardit të jetës së pensionistëve me referim në pagën më të mirë

ose pagën e fundit. Duke vepruar kështu, validojmë riprodhimin e pabarazive të botës së punës për ato dhe ata që e lënë atë.

Si mund të justifikohet fakti që një kuadër do të merr një pension më të mirë se një pastruese? Pse do

të meritonte ai të fiton më shumë për t'u kujdesur për kopshtin e tij, për të mbështetur familjen e tij ose për të marrë pjesë në jetën e komunitetit, për të lexuar ose për të peshkuar? Argumentet që zakonisht parashtrihen për ta justifikuar dallimin në paga – dallimi

në kualifikim, motivim, investim, vështirësitë, "produktivitet" ose "punësueshmërinë" – nuk mund të përdoren në rastin e pensionimit. Në këtë pyetje të pashtuar ndonjëherë, përgjigja e nënkuptuar qëndron shpesh në kuptimin e pensionit si një pagë e //faqe 5

Debat

Debat Midis
identitarizimit
të fesë dhe
fetarizimit të
identitetit

Nga Shkodran Hoti /Faqe 4-5

Reagimet e shumta kundër Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Francë pasi që shpërndau në Twitter një

Editorial

Rikthimi i
diplomacisë
transatlantike në
Ballkan

Nga Drilon S. Gashi /Faqe 6

Fitorja e të zgjedhurit President Biden risjell në Ballkan një udhëheqës amerikan që për shumëkë është i

Koment

Vala demokratike
drejt digave të
pushtetit serb

Nga Dejan Iliq /Faqe 7

Serbia është e rrethuar. Rrethi i ndryshimeve demokratike po ngushtohet rreth saj. A do t'i rezistoj ndryshimeve regjimi i Vuçiqit? Situata po vështirësohet: nga brenda regjimin e gërryen korona, nga jashtë presioni i vullnetit të shprehur të popu-

Film

Moda sipas
James Bondit

Nga Aliocha Waldlasowski*
/Faqe 18

Ikonë pop dhe glamuroze e kulturës moderne, personazhi i James Bond-it u krijua nga Ian Fleming në vitin 1953, në Gold-eneye, rezidenca e tij xhamajkane. Gazetar i agjencisë së lajmeve Reuters, pastaj ndërmjetës bankash investimesh, Fleming, lindur në

KOSOVA PAS NGRITJES SË AKTAKUZAVE NDAJ ISH-KRERËVE TË UÇK

(Pa)drejtësia ndërkombëtare dhe narracioni i (pa)mundur i luftës çlirimtare

Shumë pikëpyetje janë ngritur në shoqërinë kosovare pas ngritjes së aktakuzave ndaj ish-krerëve të UÇK-së. A është e mundur drejtësia tranzicionale? A do të sjellë gjykata speciale drejtësi? Ç' do të prodhojnë proceset gjyqësore në raport me narracionin e (pas)luftës dhe me të vërtetën? Debat me gazetarin Enver Robellin, sociologun Dukagjin Gorani dhe Bekim Blakaj, drejtor i Fondit për të Drejtën Humanitare në Kosovë.

NGA BELGZIM KAMBERI

— Si e komentoni reagimin dominues të opinionit publik në Kosovë në aktakuzat e para nga Dhomat e Specializuara kundër ish-krerëve të UÇK-së?

Bekim Blakaj : Qysh nga krimi i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit Special ka qenë e pritur se do të akuzohen udhëheqësit e lartë të UÇK-së. Megjithatë, pas ngritjes e aktakuzës ndaj Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit, reagimet në opinionin publik janë të shumta dhe jashtëzakonisht të ashpra. Mendoj se kësaj i ka paraprirë një fushatë mediatike e cila kishte filluar në qershor, pasi Zyra e Prokurorit Special nxori një komunikatë ku bëri të ditur se ka dorëzuar tek gjykatësi i procedurës paraprake një aktakuzë ndaj Thaçit, Veselit dhe të tjerëve. Kjo fushatë ende është duke vazhduar dhe si rezultat i saj diskursi publik është unifikuar edhe më shumë në kritikën ndaj Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit Special. Pak a shumë kjo ka qenë e pritur, mirëpo është për keqardhje që në krejt këtë situatë pothuajse askush nuk e trajton çështjen nga këndvështrimi i viktimave, dhe të drejtën e tyre në drejtësi.

“Si në rastin e Kroacisë, edhe në Kosovë, shumë njerëz nuk janë të gatshëm të kuptojnë se edhe në një luftë mbrojtëse dhe çlirimtare, te pala e sulmuar mund të ketë individë që shkelin rregullat e luftës, apo kryejnë ndonjë krim” — Enver Robelli

Enver Robelli : Kryesisht reagime emocionale pa një analizë të ftohtë se çka i parapriu këtyre aktakuzave. E këtyre



DUKAGJIN GORANI

aktakuzave i parapriu një periudhë e gjatë e mosndriçimit të disa krimeve në Kosovë që nga koha e luftës. Këtu hyjnë krimet ndaj pjesëtarëve të pakicave, por edhe krime kundër atyre që perceptoheshin si kundërshtarë politikë të krahut të luftës. Për shkak se në Serbi kanë mbetur të padënuar qindra kriminelë të luftës, kjo nuk e rrit assesi gatishmërinë e palës kosovare për t'u marrë me gabimet e saj gjatë dhe pas luftës. Si në rastin e Kroacisë edhe në Kosovë, shumë njerëz nuk janë të gatshëm të kuptojnë se edhe në një luftë mbrojtëse dhe çlirimtare, te pala e sulmuar mund të ketë individë që shkelin rregullat e luftës, apo kryejnë ndonjë krim.

Dukagjin Gorani : Nuk mendoj se kishte reagim ‘dominues’ apo mbizotërues. Siç edhe është bërë zakon, pati reagime konfrontuese mes grupeve të polarizuara të intereseve sociale, ekonomike dhe me ambicie pushtetore. Ato grupe që identifikohen me narrativin historik të UÇK-së e përjetojnë Gjykatën Speciale si dëmtim strukturor — dhe retroaktiv — të postulateve të tyre ideologjike, çfarë ishte edhe përpjekja e armatosur për çlirim kombëtar. Grupet oponente të tyre e shohin Gjykatën si vegël politike që do të ndihmojë në përmbysjen e rendit simbolik dhe ekonomik të krijuar pasluftë, e të cilin e shohin të uzurpuar nga narrativi historik që ka në qendër UÇK-në.

Sikurse edhe shumëkund tjetër në botë, as në Kosovë nuk ekziston opinion i jopolarizuar publik — e aq më pak opinion unifikues që do të udhëheqej nga përpjekja për të ndërtuar përbashkësi botëvështrimesh dhe interesesh brenda shtetit të përbashkët.

— Duke pasur parasysh përvojën dhe lëshimet e Tribunalit të Hagës, a besoni se Dhomat e Specializuara do të mund të kontribuojnë në pranimin e idesë së drejtësisë tranzicionale. Cilat janë përparësitë dhe dobësitë e Dhomave të Specializuara?

Bekim Blakaj : Në fakt Dhomat e Specializuara janë në pozitë edhe më të disfavorshme sesa Gjykata Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavi, dhe këtë për shkak të mandatit të saj specifik, respektivisht për faktin se juridiksioni lëndor i saj kufizohet në krimet e supozuara që kanë qenë subjekt në



Raportin e Asamblesë së Këshillit të Evropës, si dhe subjekt i hetimeve të Task Forcës Speciale Hetuese (SITF). Prandaj, mendoj se kjo gjykatë në Kosovë pothuajse gjithmonë do të shihet dhe komentohet si një gjykatë e njëanshme dhe jo e ndershme. Gjithashtu, gjasat janë të vogla që faktet që do të vërtetohen nga kjo gjykatë do të zënë vend të merituar në krijimin e narracionit të përgjithshëm mbi luftën në Kosovë, por shpresoj që së paku Dhomat e Specializuara do të kenë sukses të adresojnë nevojat e viktimave dhe se megjithatë do të kontribuojnë në një të ardhme më të largët në plotësimin e tablosë për ngjarjet e luftës.

Enver Robelli : Prokuroria Speciale është themeluar para 5 viteve dhe tek tani arriti të prezantojë disa aktakuza. Kjo vonesë është shenjë se prokuroria ka probleme të mëdha me sigurimin e fakteve dhe provave. Që nga koha kur janë kryer krimet potenciale, ka kaluar një kohë e gjatë, shumë njerëz kanë vdekur, disa dëshmitarë janë zhdukur, ndonjë që është gjallë nuk dëshmon nga frika. Mbetet të shihet në të ardhmen se çfarë provash e dëshmitarësh do të nxjerrë prokuroria. Formulimi « ndërmarrje e përbashkët kriminale » për grupin e njerëzve të akuzuar është paralajmërim se prokuroria si rrugëdalje të vetme e sheh dënimin sipas përgjegjësisë komanduese. Por, UÇK ka qenë një organizatë e ndërlikuar, heterogjene dhe pa struktura unike komanduese, përkundër se në komunikata është përpjekur të krijojë përshtypjen se është ushtri e organizuar. Nuk ka qenë e tillë kurrë. Nëse më herët gjykata e Hagës për krimet në ish-Jugosllavi nuk ka arritur t'i dënojë komandantët e UÇK-së për

përgjegjësi komanduese, si do të arrijë ta bëjë këtë Gjykata Speciale? Një proces i padrejtë do të ngjallte edhe më shumë zemërim në Kosovë dhe nuk do të ndikonte ne pajtim, por në acarim të raporteve ndëretnike. Gjykata Speciale e ka kredibilitetin e cenuar. Me vite të tëra, duke u bazuar në raportin kontradiktor të politikanit zviceran Dick Marty, disa media perëndimore kanë përhapur legjendën për « tregti me organe ». Tash shohim aktakuzat kundër Thaçit dhe shokëve të tij dhe aty nuk ka asnjë shkronjë për këtë akuzë të rëndë dhe të pabazuar.

“Gjasat janë të vogla që faktet që do të vërtetohen nga kjo gjykatë do të zënë vend të merituar në krijimin e narracionit të përgjithshëm mbi luftën në Kosovë, por shpresoj që së paku Dhomat e Specializuara do të kenë sukses të adresojnë nevojat e viktimave dhe se megjithatë do të kontribuojnë në një të ardhme më të largët në plotësimin e tablosë për ngjarjet e luftës” — Bekim Blakaj

Dukagjin Gorani : Jo, nuk besoj. Gjykata Speciale do të merret me pohimet për krime që supozohet të jenë kryer para dy dekadave.



BEKIM BLAKAJ

Distanca kaq e madhe kohore rrezikon ta shndërron atë në një farsë juridike. Institucioni i saj ka vetëm rëndësi formale, jo edhe përmbajtësore. Ajo është e menduar si mekanizëm që e adreson nevojën formale të bashkësisë ndërkombëtare për ta përmbyllur kapitullin (ende të hapur) të legjitimitetit të intervenimit ushtarak dhe politik në Kosovë dhe ish-Jugosllavi. Sipas saj, ky legjitimitet mund të vazhdojë të kontestohet nëse sistemi i drejtësisë ndërkombëtare nuk e adreson përgjegjësinë e të gjitha palëve të përfshira në konfliktin e viteve 1998-1999. Pra, kërkohet që Gjykata Speciale të shihet në këtë kontekst : se ajo u themelua për t'i adresuar krimet e supozuara edhe të palës shqiptare/kosovare dhe se, përmes gjykimeve të tyre, ajo do ta përmbushë formalisht parimin e paanshmërisë politike dhe të juridiksionit gjithëpërfshirës të drejtësisë ndërkombëtare. Kësisoj, ky institucion shihet i domosdoshëm nga logjika juridike perëndimore/ndërkombëtare. Andaj, përmbyllja e punimeve të Gjykatës Speciale do të interpretohet si qartësim

përfundimtar juridik i një polemike të vazhdueshme politike, çfarë ishte intervenimi ushtarak ndaj ish-Jugosllavisë gjatë agresionit mbi shqiptarët e Kosovës. Këtu, në veçanti, Gjykata Speciale do të përpiqet ta adresojë vakuumin e sistemit të drejtësisë gjatë periudhës së administratës ndërkom-bëtare në Kosovë (1999-2008), e që shihet si interes historik i shteteve pjesëmarrëse në atë administrim të zbatuar nën flamurin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (Misioni UNMIK). Përparësitë e Dhomave të Specializuara janë formale, kurse dobësitë (dhe dëmet) do të jenë përmbajtësore. Formalisht, fillimi dhe përfundimi i proceseve gjyqësore do të interpretohet si triumf i këmbënguljes së drejtësisë ndërkombëtare dy dekada pas konfliktit. Përmbajtësisht, vendimet e Gjykatës do të ndihmojnë në barazimin e përgjegjësisë ndaj krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë. Me këtë, agresioni shtetëror serb mbi shqiptarët do të barazohet me krimet e supozuara individuale të pjesëtarëve të UÇK-së. Një konstrukt i tillë juridik do t'i dekontekstualizojë faktet historike dhe shkaqet politike që çuan në vrasjet masive të shqiptarëve të Kosovës nga aparati shtetëror, policor dhe ushtarak i ish-Jugosllavisë – e të cilat shkak-tuan edhe rezistencën e armatosur të tyre që u materializua përmes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Mbase, barazimi i vëllimit dhe i peshës së krimeve mes Serbisë dhe UÇK-së nuk është synim i Gjykatës Speciale, porse ka shumë të ngjarë të jetë pasoja e fundme e vendimeve të saj. Mbase, drejtësia duhet të jetë e verbër, por jo edhe e shurdhër. Një pasojë e tillë vetëm sa do t'i thellonte tutje antagonizmat politikë e historikë mes shqiptarëve dhe serbëve në Ballkan.

– **Sa do të mundet shoqëria kosovare me u përballur me të kaluarën dhe të vërtetën përtej krimeve të kryera nga regjimi i Millosheviqit, edhe duke pasur parsysh që çështjen e krimeve dhe të viktimave të luftës e trajton brenda kontekstit të luftës midis Serbisë si agresore dhe Kosovës si viktimë?**

Bekim Blakaj : Ballafaqimi me të kaluarën është një proces i gjatë dhe shpesh i dhimbshëm. Segment



ENVER ROBELL

i veçantë i saj është gjetja dhe pranimi i së vërtetës nga të gjitha palët. Ky proces edhe më shumë vështirësohet kur njëra nga palët reziston që të pranojnë faktet, qoftë edhe ato të konfirmuara para gjykatave, dhe vazhdon të mohojë viktimat e shkaktoara. Kjo është

situata që është duke vazhduar për më shumë se dy dekada ku Serbia në përgjithësi nuk e ka pranuar përgjegjësinë e vet për krimet e kryera në Kosovë, dhe kjo ka krijuar rezistencë edhe tek shoqëria kosovare e cila nuk është e gatshme të pranojë krimet e kryera nga ish-pjesëtarët e UÇK-së. Këtë situatë edhe mëtej e komplikojnë problemet politike, mosnjohja e Kosovës nga Serbia dhe pretendimet e saj mbi territorin e Kosovës. Në këto rrethana është e vështirë të pritët që shoqëria kosovare të gjejë forcën që të ballafaqohet me të kaluarën dhe të tejkalojë narracionin nacional që tashmë është vendosur.

Enver Robelli : Shoqëria e Kosovës për fat të keq nga kjo distancë kohore tregon njëfarë indiference ndaj gabimeve që mund të kenë bërë krerët e UÇK-së. Mes politikanëve shpesh ka akuza për krime, por kur vjen puna e ndriçimit të tyre çdo gjë merr fund. Nuk jam i sigurt nëse Gjykata Speciale do të arrijë ndonjë ndryshim në këtë qasje. Ndoshta ndryshimi vjen tek pasi Serbia të pranojë Kosovën si shtet dhe të dy vendet të kenë mjaft energji për t'u marrë me veten.

Dukagjin Gorani : Kjo çështje problematike nuk do të lehtësohet përmes Gjykatës Speciale. Kam frikë se do të shkaktohet e kundërta : me ta kuptuar se vendimet e Gjykatës nuk do ta ndryshojnë realitetin shoqëror dhe rendin simbolik në Kosovë, e veçanërisht raportin e forcave të grupeve të konfrontuara të intereseve politike, shqiptarët do të ndjehen të mashtruar dhe të shpërdorur nga një qasje e tillë dekontekstualizuese e drejtësisë ndërkombëtare. Parashoh se që me fillimin e proceseve gjyqësore, në shoqërinë kosovare do të përhapet përshtypja se janë humbës në betejën interpretuese të historisë së konflikteve ish-jugosllave. Tutje, kjo mund ta përforcojë qasjen viktimizuese dhe kësisoj t'i perpetualizojë antagonizmat e vjetër rajonalë.

– **Si të rindërtohet një narracion historik të viteve '90, të represionit të regjimit të Serbisë dhe të luftës, i cili do ta përfshinte realitetin e krimeve të kryera nga regjimi i Serbisë, por edhe nga palët e tjera, përfshirë edhe ato të pjesëtarëve të UÇK-së?**

Bekim Blakaj : Rindërtimi i narracionit të saktë historik për periudhën e represionit të regjimit serb që i ka paraprirë luftës, periudhën e luftës ku forcat serbe kanë kryer krime masive të tmerrshme ndaj civilëve shqiptarë dhe ku ka pasur edhe krime të kryera ndaj civilëve joshqiptarë, si dhe krimet dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut pas përfundimit të luftës, duhet të merret tepër seriozisht jo vetëm nga pala kosovare. Vendosja e narracionit të saktë historik, që bazohet në fakte dhe i cili pranohet nga të gjithë, nuk mund të bëhet vetëm nga njëra palë. Kur bëhet fjalë për narracionin historik mbi vitet e 90-ta, situata nuk dallon shumë as me luftën e Bosnje e Hercegovinës dhe Kroacisë, e në të gjitha këto luftëra ka qenë e përfshirë Serbia. Prandaj, do ishte ideale nëse të gjitha këto vende

do e krijonin një komision të përbashkët për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut gjatë shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Në fakt, ekziston një nismë që promovon krijimin e një komisioni të tillë, të quajtur KOMRA, por kjo nismë e shoqërisë civile nuk ka pasur sukses t'i bindë të gjitha shtetet e dalura nga ish-Jugosllavia të krijojnë një komision të përbashkët. Ende besoj se vendet e dala nga ish-Jugosllavia duhet ta gjejnë mënyrën që të kaluarën ta trajtojnë drejtë dhe të gjitha palët të pranojnë faktet dhe të respektojnë të gjitha viktimat. Motivin për të bërë këtë duhet ta kërkojnë në të mirë të gjeneratave të reja, të cilat nëse bëhet kjo në mënyrë të duhur, mund të jetojnë në paqe pa frikë se mund të përsëriten luftërat në këtë rajon.

“Parashoh se që me fillimin e proceseve gjyqësore, në shoqërinë kosovare do të përhapet përshtypja se janë humbës në betejën interpretuese të historisë së konflikteve ish-jugosllave. Tutje, kjo mund ta përforcojë qasjen viktimizuese dhe kësisoj t'i perpetualizojë antagonizmat e vjetër rajonalë” – Dukagjin Gorani

Enver Robelli : Siç e thashë më parë, për aq kohë sa Serbia sillet si shtet që ka ambicie të ripush-tojë Kosovë, t'ia marrë një pjesë të territorit apo ta keqpërdorë pakicën serbe në Kosovë për ta sabotuar shtetin e Kosovës, pajtimi është larg, madje i pamundur. Derisa është kështu, edhe në mesin e palës shqiptare do të ketë pak njerëz që janë të gatshëm të kërkojnë fajtorët edhe për vrasjen e civilëve serbë apo romë, sidomos pas luftës. Në gjithë këtë debat nuk duhet humbur nga fokusi relacionet: Serbia si shtet pushtues ka vlarë rreth 10 mijë shqiptarë të Kosovës, ka dëbuar rreth 1 milionë shqiptarë dhe ka fshehur rreth 1000 kufoma në Serbi. Nuk ka një pllakë të vetme që kujton viktimat shqiptare të regjimit serb në asnjë nga këto varreza masive me shqiptarë në Serbi. Lufta e kosovarëve ka qenë luftë dekolonizuese. Në këtë betejë, individë shqiptarë nga UÇK kanë keqpërdorur pushtetin e tyre dhe për këtë duhet të marrin dënimet e merituar më së miri nga gjykatat kosovare. Por kjo rrugë është e largët.

Dukagjin Gorani : Edhe pse krimet janë çështje për drejtësinë, në kontekstin zhvillimor shoqëror mund të adresohen vetëm përmes proceseve politike. Kjo për faktin se janë pasojë e veprimeve politike të ndërmarra gjatë periudhës së agresionit ish-jugosllav. Proceset politike duhet ta synojnë ardhmërinë e shoqërive në Ballkan duke i adresuar tragjeditë e së kaluarës si arsye për paqe dhe zhvillim, e jo si vegla juridike për reduktim dhe barazim të përgjegjësisë.

ZGJEDHJET PRESIDENCIALE AMERIKANE

Një rezultat që nuk do të pranohet

NGA SERGE HALIMI



Akemi të bëjmë thjesht me produkt të një klime të nxehtë politike? Sido që të jetë, tashmë pothuajse pak njerëz mendojnë se rezultati i zgjedhjeve presidenciale do të pranohet nga të dyja palët.

Çfarëdo që do të ndodhë të martën e ardhshme, më 3 nëntor, një numër i rëndësishëm i demokratëve do t'ia faturojnë humbjen e tyre të mundshme Ruisë, ose Kinës, ose më arsyeshëm, ndalimit të votimit që guvernatorët republikanë si ai i Floridës ua bëjnë të dënuarve – shpesh të varfër, zezakë ose hispanikë, si votues të supozuar demokratë – shumë kohë pasi kanë kryer vuajtjen e dënimit.

Sa i përket z.Donald Trump, ai tashmë e ka të paracaktuar : mund të humb zgjedhjet vetëm nëse janë të manipuluara (“zgjedhjet e manipuluara janë mënyra e vetme e tyre për të na mundur”, deklaroi ai më 24 gusht). Ai e ka identifikuar që tani mjetin : votimi me postë, numri i të cilit rrezikon të shpërthejë për shkak të koronavirusit.

Në Shtetet e Bashkuara, secili shtet përcakton një numër rregullash votimi, përfshirë të drejtën e votuesit për të votuar në një mënyrë të tillë deri në një datë të caktuar. Në Pensilvani, një shtet pothuajse gjithmonë i pavendosur për nga rezultati zgjedhor (swing state), mund të kërkohej një fletëvotim me postë deri në 27 tetor. Ai fletëvotim duhet të arrijë në qendrën e votimit deri në orën 8 të së martës zgjedhore. Një afat jashtëzakonisht i shkurtër, sidomos nëse posta nuk funksionon mirë. Në Minnesota, një votues mund ta kërkojë një votë me korrespondencë (me postë) deri një ditë para zgjedhjeve. Diku tjetër, rregullat janë më ndryshe dhe mund të ndryshojnë ende deri më 3 nëntor ...

Gjatë zgjedhjeve presidenciale, rreziku i përplasjeve është i madh, sidomos nëse dyshimet për vjedhje helmojnë

paraprakisht atmosferën. Të gjithë e mbajnë në mend numërimin e pafund të votave në Florida, gjatë zgjedhjeve presidenciale të nëntorit 2000, që përfunduan me zgjedhjen e z.George W. Bush.

A priori, ekuacioni politik është i thjeshtë dhe shpjegon në mënyrë të përsosur strategjinë e dyshimit të Presidentit në largim: 58% e amerikanëve që planifikojnë të votojnë me prani fizike më 3 nëntor janë të prirur të votojnë për z.Trump, por 75% e atyre të cilët parapëlqejnë të votojnë me korrespondencë (me postë) janë të prirur të votojnë për kundërshtarin e tij, z.Joseph Biden. Është shumë e mundshme që natën e zgjedhjeve, numërimet e para i japin përparësi kandidatit republikan – dhe ndjenjën e mbështetësve të tij se ka fituar – para numërimit të dhjetëra miliona votave postare (tridhjetë e tre milion në vitin 2016) që do të përmbysnin rezultatin.

Por, nga të gjitha mangësitë që i atribuohen z.Trump, një është e sigurtë : ai është një humbës shumë i keq me vetëbesim të madh. Prandaj është më se e mundshme që nëse mposhtet – në mënyrë të drejtë, por falë votave postare të cilat ai veç tashmë pretendon se do të jenë të manipuluara – z.Trump do ta kundërshtojë vendimin e rezultatit. Deri në masën e refuzimit të kalimit të pushtetit për njeriun që e ka mposhtur? Ish-këshilltari i tij Steve Bannon sapo ka nisur një fushatë me temën : “Komploti për të vjedhur 2020”. Dy nga shënjestrat e tij janë Twitter dhe Facebook, të cilat sipas tij do të refuzojnë ta shpallin rezultatin natën e zgjedhjeve deri në numërimin e plotë të votave postare. Një krim që z.Bannon është afër për ta gjykuar si të pafalshëm.

HISTORIKU I HETIMEVE TË GJYKATËS SPECIALE NË SHQIPËRI

Specialja shqiptare

Teksa shihet se debati në Shqipëri për hetimin e UÇK i ka tejkaluar limitet e normales, ajo që mund të themi është se, pritet që lufta politike të vijojë me intensitet akoma më të lartë, pasi zgjedhjet parlamentare janë në prag dhe vendi praktikisht ka hyrë në fushatë.

NGA JAKIN MARENA

Burgosja e ish-komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Gjykatën Speciale të Hagës për krime lufte, ka ngritur “sentimetin” e politikës shqiptare në të dy anët e kufirit.

Hashim Thaçi, presidenti i dorëhequr i Kosovës, ish-kryetari i Parlamentit Jakup Krasniqi, ish-kryetari i Kuvendit e kreu i PDK Kadri Veseli dhe ish-shefi i grupit parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Rexhep Selimi janë njohur me aktakuzën që rëndon mbi ta për krime lufte.

Gjykata Speciale pretendon që janë përfshirë në krime lufte dhe krime kundër njerëzimit mbi dy baza: Si përgjegjës të ndërmarjes kriminale të përbashkët dhe mbi bazat e përgjegjësisë personale.

Sipas Hagës, Thaçi në periudhën prej marsit të vitit 1998 deri në shtator 1999 është i përfshirë në krime kundër civilëve, kundër serbëve, shqiptarëve, romëve, katolikëve, kundërshtarëve politikë, kundërshtarëve të UÇK, personave për të cilët pretendohet se bashkëpunojnë me forcat serbe apo ishin në kundërshtim dhe të tjerëve por edhe kundër kundërshtarëve politikë.

Në këtë kontekst u përmendën edhe vrasjet e kundërshtarëve politikë edhe kundërshtarët e UÇK. Por dhe burgosjet në “burgjet e UÇK” në Shqipëri! Me të njëjtën akuzë gjykohen dhe të tjerët! Të akuzuarit i kanë mohuar akuzat.

Lulzim Basha i hetimeve klandestine

Pjesë për ngritjen e akuzave ndaj ish-krerëve të UÇK ishte edhe misioni faktmbledhës i UNMIK. Në përbërje të këtij misioni ka qënë dhe kreu aktual i PD Lulzim Basha.

Baza e materialit hetimor të Gjykatës Speciale ndaj Thaçit dhe krerëve të UÇK-së ishte pikërisht raportit i Dick Marty-t, senatorit zviceran, raport i cili u kthye në rezolutë në Këshillin e Europës.

Raporti pasoi librin “Gjuetia” të Carla Del Pontes, ish-kryeprokurores së Gjykatës së Hagës, që flet për të ashtuquajturën “Shtëpi të Verdhë” në Mat.

Pas botimit të librit, disa hetues të Gjykatës së OKB-së për ish-Jugosllavinë nisën të hetojnë për “Shtëpinë e Verdhë”.

Jose Pablo Baraybar, një mjek antropolog peruan që ishte në grupin e hetimeve të prokurorisë së Hagës tha më 2010 për gazetën zvicerane “Le Temps”, se kishte pasur dhe një përkthyes shqiptar, i cili quhej Lulzim Basha. Kur Gjykata e Hagës nisi hetimet, Basha ishte i punësuar në Kosovë, si pjesë e administratës ndërkombëtare të OKB-së. “Përkthyesi im quhej Lulëzim Basha, ai ka punuar si mbledhës të dhënash përmes përkthimit për Gjykatën Ndërkombëtare Penale për ish- Jugosllavinë (ICTY). Më vonë ai u bë Ministër i Punëve Publike në Shqipëri. E kam dëgjuar të deklarojë se kjo histori e organeve është asgjë. Ai ishte me mua. Ai ka regjistruar dëshmitë bashkë me mua. Ai kishte dosjen”, ka thënë Jose Pablo Baraybar i cili ka punuar si ekspert i OKB në pjesën më të madhe të skenave të krimeve të luftës e genocidit në botë si Haiti, Ruanda, Bosnjë, Kroaci si dhe Kosovë.

Baraybar sqaron se “së bashku me Bashën

kanë qënë në Gurrë të Matit të kamufluar për të parë në vend “Shtëpinë e Verdhë” ku kishte dyshime se janë kryer transplant organesh njerëzore. Gjatë hetimeve u jemi prezantuar njerëzve si inxhinierë për të ndërtuar një rrugë. Gjatë bisedave kemi bërë dhe pyetje në lidhje me kampet e UÇK-së. Qëllimi ynë kryesor ishte varreza në Bicaj, në jug të Kukësit, ku sipas dosjes që ne kishim ishin trupat e serbëve të Kosovës. Dick Marty flet gjithashtu për këtë. Ne e kemi identifikuar. Ishim me një ‘Land Rover’ me targa britanike, duhet të ketë qënë pranvera e 2003-it. Pas Kukësit u nisëm për në Bicaj, folëm me disa fshatarë. Basha ka qënë përkthyesi im në atë udhëtim”.

Basha e ka mohuar këtë fakt duke thënë se s’ka qënë pjesë e hetimeve, por mjeku i OKB i kujton dhe punën specifike që ka bërë dhe që ishte në dijeni të plotë të të saj teksa thotë se “Basha ka qënë në dijeni të hamendësimeve për sjellje të serbëve e shqiptarëve të Kosovës në Shqipëri pas lufte, për shkak të punës së tij në Ministrinë e Drejtësisë”.

Në të njëjtën gjatësi vale ka qënë dhe Tomë Gashi, avokati që ka mbrojtur në Hagë, Haradinajn dhe Limajn, i cili thotë se dosjet janë aty dhe është hasur në shumë prej tyre firma e vetë Lulzim Bashës, asokohe në përbërje të misionit të UNMIK.

Lulzim Basha nuk ka sqaruar asnjëherë pozicionin e tij, duke këmbëngulur se është marrë vetëm me riorganizimin e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës. Madje dhe në daljen e fundit publike, Basha u fsheh pas prejardhjes së gjyshit të tij, duke thënë se ishte patriot.

“Desantimi” i faktmbledhësve të UNMIK mes të cilëve dhe Basha konfirmohet dhe nga një deklaratë të Prokurorisë shqiptare në lidhje me ngjarjet që pretendohet të kenë ndodhur në vitin 2003-2004 në zonën e Burrelit, ku ndër të tjera thuhej: “është zhvilluar një proces inspektimi dhe verifikimi i përbashkët i hetuesve të ardhur nga Haga dhe prokurorëve të rrethit të Matit në disa ambiente në zonën e Burrelit. Në përfundim të këtij procesi hetuesit e Hagës së bashku me prokurorët e Matit arritën në konkluzionin se të dhënat që posedonin hetuesit e Hagës për atë që pretendohet se kishte ndodhur në Burrel nuk rezultuan të vërteta”.

Praninë e grupit të UNMIK e ka pranuar dhe prokurori i Matit i asaj kohe, Arben Dyla që hedh dritë mbi të vërtetën e hetimit ndërkombëtar në Gurrë. Ai thotë se “kërkoni varreza serbe në këtë zonë, por që kishin drejtim të përcaktuar qartë, pasi menjëherë u drejtuan tek shtëpia e Dull Katuçit në Gurrë”. Prokurori thotë se nuk gjetën asgjë të dyshimtë.

Baraybar nuk është i vetmi që thotë se Basha ka qënë me të. Mjeku nga Kosova, Tefik Gashi, dhe ai pjesë e ekipit të hetimit, dëshmon praninë e tij në hetimet rreth “Shtëpisë së Verdhë”.

Një tjetër konfirmim vjen nga Fred Abrahams i Human Rights Watch, që bën të qartë se “Basha ka punuar për Gjykatën e Departamentin e Drejtësisë pranë UNMIK pas luftës, dhe personalisht ka hetuar informacionet për vendet e këtyre burgosjeve në Veri të Shqipërisë”.

Basha i është shmangur gjithnjë faktit se ka qënë pjesë e grupin e verifikimit dhe të selektimit të dosjeve kundër UÇK. Por ish kryeministri Sali Berisha, në stilin e tij “moho duke pohuar” ka dhënë për herë të parë një version

të ri për hetimet në “Shtëpinë e Verdhë”!

“Unë e kundërshtova aktakuzën në të gjitha nivelet ndërkombëtare. Në PE, në KE, kudo. Sepse në mënyrën më djallëzore, ky kishte vendosur në raport transplant organesh, që ishte krimi më monstruoz. E dija që ishte një trillim i stisur. Gjetën një familje të varfër në Burrel, të thoshte se e kishte kthyer shtëpinë në spital ku bëhej transplante organesh”, tha Berisha.

Qeveria Berisha pro Raportit Marty

Përkundër deklaratave të ish-kryeministrit Sali Berisha se kishte kundërshtuar raportin e Dick Marty-t që akuzonte pjesëtarë të UÇK-në për krime lufte dhe transplant organesh njerëzore, mazhoranca e asaj kohe e mbështeti me votë ndërkombëtarisht rezolutën e dalë nga ky raport.

Më 26 janar të vitit 2011 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi raportin e paraqitur nga Dick Marty-t, duke i dhënë atij fuqinë e një rezolute. Raporti u miratua me 191 vota pro dhe me vetëm 8 vota kundër. Votoi pro dhe kreu i delegacionit shqiptar në Asambelenë e Këshillit të Europës, deputeti i asaj kohe i PD në qeverisje, Ilir Rusmali. Kundër votuan deputeti i PS Damian Gjikhuri dhe kreu aktual i PDIU Shpëtim Idrizi. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës e ka publikuar në faqen e saj zyrtare proces-verbalin e seancës së mbajtur më 26 janar 2011, ku përfshihet lista dhe mënyra e votimit të pjesëmarrësve. Është dhe vota pro e deputetit të PD shqiptare, Ilir Rusmali.

Sipas “Beta”, Beogradi në këtë mbledhje përfaqësohej me një delegacion të Kuvendit të Serbisë, me në krye me Dragolub Micunoviq, ku detyra kryesore e tyre ishte bindja e sa më shumë europarlamentarëve që të votojnë për rezolutën. Në atë kohë kishte një debat të fortë politik në Shqipëri e Kosovë në lidhje me votën shqiptare pro raportit të Marty-t, i cilësuar i njëjtit me akuzat e Beogradit ndaj ish komandantëve të UÇK, që akuzoheshin për krime lufte dhe për transplant organesh. Debat që vijon dhe sot!

Në një deklaram të këtyre ditëve, ish kryeministri Berisha, teksa akuzon Dick Marty-n si një serbofil, nuk ka dhënë një shpjegim të qartë se përse atëherë e votoi pro në KE këtë raport.

Ndërsa kryeministri Edi Rama, asokohe në opozitë, deklaroi këto ditë se e kishte urdhëruar deputetin e tij Gjikhuri të votonte kundër rezolutës. I kërkonte madje të ndikonte dhe tek Ilir Rusmali që tre votat shqiptare të ishin kundër. Por deputeti i PD votoi pro rezolutës.

Legalizimi i hetimeve në Shqipëri

Përpjekja e ish-udhëheqësve të UÇK për të provuar pafajësinë duket se do të vijojë edhe për disa kohë nëpër dyert e gjykatave ndërkombëtare. Akuzat për krime kundër njerëzimit s’janë të reja. Nisën kur më 2011 raporti i KE, Dick Marty nxori raportin e shumëdebatuar për “Shtëpinë e Verdhë” në zonën e Matit, në Shqipëri, nën akuzën se pjesëtarë të UÇK kishin bërë trafik të organeve njerëzore. Akuzat nuk u provuan asnjëherë në shumë misione hetimi në territorin shqiptar.



Në ndihmë këtyre hetimeve ilegale u erdhi ligji i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në 10 maj 2012. Kryeministri i asaj kohe Sali Berisha, me procedurë të përshpejtuar miratoi ligjin që autorizonte EULEX-in të kryente veprime hetimore në territorin shqiptar. Tashmë legale.

Dhe nga maji i vitit 2012 janë kryer disa misione hetimore nga prokurorët e huaj në territorin e Shqipërisë dhe të asistuar nga prokurorët shqiptarë. Në fund dolën në konkluzionin se ‘Shtëpia e Verdhë’ nuk kishte ekzistuar asnjëherë, si bazë për transplantin e organeve njerëzore.

Pavarësisht rezultatit të hetimeve mbi raportin e Marty-t, aktakuza e publikuar këto ditë sërish hedh dyshime se pjesëtarë të UÇK kanë kryer krime kundër njerëzimit në qytetet veriore të Shqipërisë, ku të dhënat i kanë marrë pas autorizimit që i dha Parlamenti me ligj të veçantë në vitin 2012.

Për ish-Prokurorin e Përgjithshëm, Arben Rakipi, ligji për lejimin e hetimeve të EULEX-it

territorin shqiptar binte ndesh me Kodin e Procedurës Penale, pasi i jepej e drejta e arrestimit një institucioni të huaj brenda territorit shqiptar, që përbën dhe shkelje të rëndë Kushtetute.

Ish kryeministri Berisha tentoi ta justifikojë duke thënë se “ajo rezolutë kërkonte hetim e hetimi është kërkuar nga vetë udhëheqja politike e Kosovës, SHBA dhe BE. Do të ishte hetimi që do të provonte pafajësinë. Gjatë qeverisë qeverisë sime, në Shqipëri janë zhvilluar hetime intensive. Është një marrëveshje në parlamentin shqiptar për të lehtësuar çdo hetim”!

Institucionet e hetimit të krimeve të luftës në Kosovë dhe sidomos organet e specializuara serbe, sikurse e kanë pranuar dhe vetë se kanë furnizuar Hagën për të “fryrë” sa më shumë dosjen në ngarkim të UÇK, kanë qënë të vëmendshëm ndaj ‘rezultatit’ të hetimeve në Shqipëri.

Jashtë “radarit” të tyre nuk kanë mbetur as përplasjet politike si brenda Shqipërisë ashtu dhe në anën tjetër të kufirit, si dhe akuzat e ndërsjella.

Si bazë të “dhënash” kanë shërbyer sidomos shkëmbimi i akuzave mes aktorëve kryesorë të asaj kohe, ish kryeministrit Sali Berisha dhe ish Presidentit Hashim Thaçi. Berisha ka akuzuar se “janë 200 anëtarë e drejtues të LDK të ekzekutuar pas lufte. Nga drejtues kryesorë, gazetarë e anëtarë të thjeshtë. Ky është numri i saktë. Thaçi duhet të shkojë atje të pastrohet, gjykata është ngritur për raportin Dick Marty.

Këtë e di se kam qënë kryeministër kur është ngritur gjykata...”!

Ndërsa kryeministri Edi Rama po kërkon ta shfrytëzojë situatën politikisht, teksa në kulmin e pandemisë, nuk “harron” t’i kujtojë Bashës hetimin me “kapuç në kokë” që ka bërë në Shqipëri në kohën kur ka qënë në përbërje të UNMIK, për ish-komandantët e UÇK.

Nën kërkesën për transparencë, Rama kërkon nga Basha të sqarojë publikisht rolin e tij në hartimin e raportit të Dick Marty-t. Ndërsa paralajmërohet se do të ngrihet një komision hetimi parlamentar për raportin e përfshirjen e liderit demokrat.

Ndërsa Berisha këmbëngul në akuzat për vrasje politike në Kosovë nga njerëzit e UÇK, duke mbështetur Bashën dhe duke nxjerrë në skenë emrin e vajzës së tij Argita, ku njëri ka hetuar krimet e “Kasapit të Ballkanit” ndërsa tjetra 11 serbë!

“20 vite më parë Beogradi është përpjekur me gjithë makinerinë e tij bashkë me rusët, që UÇK-në ta konsiderojë grup kriminal terrorist. Duket ta pranoj, diskutimet kanë qënë jo të pakta.

Në mbështetje të kësaj akuze shkonin dhe disa ekspononte të kësaj organizatë (UÇK), që bënin edhe lista të vdekurish, si Ibrahim Rugovën, Sali Berishën, dhe persona të tjerë të Berishës.

Nuk mund të mohohet se krimet janë kryer, se në Kosovë janë ekzekutuar bashkëpunëtorë të ngushtë të Presidentit Rugova, në prita komandantë legjendarë, luftëtarë të vendosur të UÇK.

Një numër vrasjesh janë bërë dhe nga ana tjetër. Në këtë aspekt s’ka prokuror që këto akuza mos i fusë në dosje. Janë ekzekutuar personalitete të shquara të LDK, Ushtrisë së Kosovës, askush nuk është dënua për këto”, akuzon Berisha.

Një qëndrim i stilit të Berishës, që i jep të drejtë UÇK-së, duke i ngarkuar akuza që as vetë Haga nuk i ka përmendur deri më tani, por që kanë qënë hamendësime në media dhe deklarata për përdorim të brendshëm politik.

Teksa shihet se debati në Shqipëri për hetimin e UÇK i ka tejkaluar limitet e normales, ajo që mund të themi është se, pritet që lufta politike të vijojë me intensitet akoma më të lartë, pasi zgjedhjet parlamentare janë në prag dhe vendi praktikisht ka hyrë në fushatë.

A ËSHTË I MUND SHËM NJË SISTEM PENSIONAL I NDARË NGA KARRIERA?

Për një pension realisht universal

Përkundër këshillës së organizatave të punonjësve dhe punëdhënësve, Presidenti i Republikës është i vendosur ta reformojë sistemin e pensioneve. Nën pretekstin e standardizimit, modeli i propozuar, i cili rrënon themelet e uljes së moshës së pensionimit të plotë, rrezikon të rezultoi në varfërimin e shumicës. Reflektimi mbi një arkitekturë të mundshme universale kalon nëpër një rrugë krejt ndryshe.

NGA ANNE DEBREGEAS*

Gjatë mobilizimit të gjerë kundër projektit të reformës së pensione në dimrin e kaluar, kërkesat mbetën kryesisht të modeluara sipas sistemit ekzistues, me synim ruajtjen e standardit të jetës së pensionistëve me referim në pagën më të mirë ose pagën e fundit. Duke vepruar kështu, validojmë riprodhimin e pabarazive të botës së punës për ato dhe ata që e lënë atë.

Si mund të justifikohet fakti që një kuadër do të merr një pension më të mirë se një pas-truese? Pse do të meritonte ai të fiton më shumë për t'u kujdesur për kopshtin e tij, për të mbështetur familjen e tij ose për të marrë pjesë në jetën e komunitetit, për të lexuar ose për të peshkuar? Argumentet që zakonisht parashtrihen për ta justifikuar dallimin në paga – dallimi në kualifikim, motivim, investim, vështirësitë, “produktivitet” ose “punësueshmërinë” – nuk mund të përdoren në rastin e pensionimit. Në këtë pyetje të pashtuar ndonjëherë, përgjigja e nënkuptuar qëndron shpesh në kuptimin e pensionit si një pagë e shtyrë, që justifikohet nga nevoja për ta zgjatur standardin e jetesës së një personi : një person i varfër është mësuar të jetë i varfër. Të tjerë mendojnë se një pagë e lartë jep të drejtën për një pension të lartë, pasi që shoqërohet me një kontribut proporcional. A duhet të trajtohen më mirë ata që kanë paguar më shumë në sigurimin shëndetësor? A duhet që fëmijët e atyre që paguajnë më shumë taksa të marrin një arsim më të mirë? Sistemi i rishpërndarjes nuk nënkupton kthimin e asaj që është paguar.

Në një kohë kur modeli ynë i shoqërisë tronditet nga kriza Covid-19, shumë iniciativa na ftojnë të ripërcaktojmë konturat e një bote të qëndrueshme. A nuk është koha për ta konsideruar zëvendësimin e logjikës aktuale kontribuese të pensionit me një të drejtë të re universale, që nuk varet nga niveli dhe kohëzgjatja e kontributeve? Nga një moshë e caktuar, çdo njeri do të kishte pension identik. Ky parim do të ndërlihej me parimin e sigurimeve shoqërore ose shërbimeve publike duke u ofruar të gjithëve të njëjtat shërbime, pavarësisht nga niveli i kontributit të asocuar në pagën e tyre. Për të marrë parasysh zbatueshmërinë dhe interesin e një pensioni realisht universal, duhet t'i gjejmë përgjigjet më të mira në pyetjet



legjitime që paraqiten.

Cila mund të jetë vlera e këtij pensioni unik? Padyshim që duhet të përcaktohet në mënyrë demokratike. Mund të imagjinohet, për shembull, të caktohet vlera 2,000 euro neto në muaj, do të thotë pak më pak se të ardhurat mesatare (2,200 euro neto sot, duke përfshirë të ardhurat kapitale. Dukshëm më shumë se pensioni mesatar aktual (1,444 euro neto në muaj), që do të nënkuptojë një rritje në pensione për më shumë se 80% të 17.2 milion pensionistëve aktualë (pas tërheqjes së kontributeve shoqërore, por jo tatimit).

Një pension unik nuk do t'i zgjidhte të gjitha pabarazitë, për shembull pabarazitë që lidhen me pasurinë, me të ardhurat mbi pronën ose kujdestarinë e fëmijëve, të cilat do të duhej të rregulloheshin nga taksat, garancë e shërbimeve publike cilësore. Duke filluar nga cila moshë? Të shtyhet ndërprerja e aktivitetit përtej moshës 60 vjeç (duke përfshirë rastet e vështira) që privon njerëzit nga vitet më të mira të pensionit, duke pasur parasysh se tanimë jetëgjatësia e shëndetshme është 64 vjet. Tregu i punës refuzon një pjesë të madhe të “të moshuarve” të cilët vështirë gjejnë punë në vitet e tyre të fundit të aktivitetit. Përveç kësaj, shtyrja e moshës së pensionimit

automatizisht i privon më të rinjtë të kenë qasje në punë: më shumë se një milion vende pune janë të zënë nga persona mbi 60 vjeç, një shifër që pritet të rritet. Përgjigja ndaj papunësisë masive kërkon një ndarje të punës, duke pasur parasysh se rritja e përhershme nuk është as e mundur as e dëshirueshme në rrafshin ekologjik.

Sa do të kushtonin këto pensione dhe si do të financoheshin? Një pension neto prej 2000 euro për të gjithë në moshën ligjore aktuale 62 vjeçare do të krijonte një nevojë shtesë për financim prej rreth 80 miliardë euro, ose 3.4% të produktit të brendshëm bruto (PBB). Kjo vlerë do të arrinte në 110 miliardë euro, ose 4.7% të PBB-së për një pension prej 2000 eurosh që nga moshja 60 vjeç. Që të arrihet ky revolucion shoqëror do të nevojitej përpjekje për një rritje prej rreth 10% mesatarisht në kontributet e detyrueshme. Kjo rritje do t'i targetonte të ardhurat më të larta, duke futur për shembull progresivitetin në kontribute dhe duke zgjeruar bazën për tatimin në burim. Të kujtojmë se futja e “taksës së sheshtë” në vitin 2018 e kishte kufizuar vlerën e tatimit mbi të ardhurat në 12.8% (pa kontributet e sigurimeve shoqërore), shumë më pak se norma e fundit e tatimit mbi të ardhurat që është caktuar 45 %. Kjo përpjekje financiare

do të nënkuptonte ndarjen e të ardhurave të prodhuara, gjë që duket më legjitime sesa dënimi i pensionistëve në varfërim gradual duke kufizuar pjesën e pensioneve në 14% të PBB-së, siç propozonte qeveria para krizës shëndetësore.

E drejta për pushim

A nuk ekziston rreziku që të inkurajohen “të pasurit” që të kapitalizojnë gjatë jetës së tyre aktive për të kompensuar një rënie të shpejtë të të ardhurave në momentin e pensionimit? Mos të mashtrohemi... më të privilegjuarit tashmë kapitalizojnë në shumë mënyra: investime në bursë, plane për pensione shtesë, patundshmëri, etj. Zbutja e të ardhurave ndërmjet periudhës së punësimit dhe periudhës së pensionimit nuk është as e paligjshme dhe as problematike, derisa fondet e pensionit janë të ndaluara. Kështu kursimet do të mund të drejtoheshin drejt financimit me normë të ulët të investimeve publike, për shembull për tranzicion ekologjik, në vend që të shkojnë drejt produkteve spekulative shumë fitimprurëse, të cilat nuk plotësojnë ndonjë nevojë reale dhe të cilat për fat të keq shpesh janë të lihuara nga taksat. Ky orientim i kursimeve do të mund të bëhej me rregullore, për shembull duke imponuar një përqindje

minimale të investimeve në financimin e investimeve publike dhe ekologjike.

A mund të pranohet një propozim i tillë? Do të kishte një jehonë të favorshme te 80% e pensionistëve të ardhshëm, pensionet e të cilëve do të rriteshin krahasuar me sistemin aktual. Edhe për të tjerët, ky pension, bashkë me një shërbim publik të varësisë, do të ofronte një të drejtë të garantuar për pushim, pavarësisht nga sfidat e jetës, pa frikë nga plakja në pasiguri financiare dhe pa frikë për fëmijët, prindërit dhe të afërmit. Në këmbim të kësaj në çka do duhej të hiqet dorë? Nga mundësia për të konsumuar më shumë, në një planet me burime të kufizuara? Shumëkush, veçanërisht në mesin e të rinjve, sot është i vetëdijshëm për nevojën e shpërndarjes, në mënyrë që të përballen me krizën e madhe sociale dhe mjedisore që qëndron para nesh. Përveç kësaj, paqëndrueshmëria e sistemit aktual i bën ata ta konsiderojnë pensionin si një iluzion. Lexueshmëria dhe thjeshtësia e një pensioni unik për të gjithë do ta favorizonte kthimin e aderimit dhe besimit në fatin tonë të përbashkët.

* Inxhinieri hulumtues në ‘Électricité de France’, zëdhënëse e federatës ‘Sud-Énergie’.

KOSOVA PAS FITORES ZGJEDHORE SË JOE BIDEN

Rikthimi i diplomacisë transatlantike në Ballkan

NGA DRILON S. GASHI

Fitorja e të zgjedhurit President Biden risjell në Ballkan një udhëheqës amerikan që për shumëkë është i mirënjohur. Si ish senator dhe kryesues i Komisionit për Marrëdhënie të Jashtme në Senat, Biden ishte marrë mjaft shumë me politikën e jashtme, dhe në vitet e 90'ta, me Bosnjën, Kosovën, dhe Serbinë në veçanti. Kujtohet si mik i mirë i shqiptarëve dhe boshnjakëve, dhe kundërshtues i ashpër i politikës së Millosheviqit.

Mirëpo, ai tash do të rikthehet si President, si udhëheqës i politikave të jashtme që priten të jenë ndryshe, krahasuar me ato të paraardhësit të tij. Këto ndryshime gjithsesi do të ndikojnë në Ballkan. Por rajoni dhe sidomos Kosova duhet të gjejnë mënyrën për të vënë synimet e tyre në vijë me politikat kryesore të SHBA. Kosova duhet të zgjerojë më tepër marrëdhëniet Kosovë-SHBA, që të përfshijnë, por të mos kufizohen, me normalizimin Kosovë-Serbi.

Administrata e re pritët që të kthejë një afërsi në mes të SHBA me aleatët e saj, sidomos në Bashkim Europian. I zgjedhuri President Biden pritët që të risjellë gjithashtu një rol të fuqishëm e tradicional amerikan në udhëheqjen e nismave ndërkombëtare dhe një sfidim më të dukshëm të Rusisë dhe të fuqive të tjera globale dhe rajonale.

Presidenti Trump e ka forcuar mbrojtjen e SHBA-ve, duke ngritur kapacitetet e ushtrisë, por ka ngecur në forcimin e diplomacisë amerikane.

Një Amerikë e tillë proaktive mund të mos ofrojë vëmendjen e mjaftueshme për Ballkanin strategjikisht jo shumë të rëndësishëm. Mirëpo, Kosova do të mund të shfrytëzonte këtë angazhim më të madh amerikan, me BE-n, NATO-n, por edhe me Rusinë.

Kosova do të mund të angazhohet që pikërisht çështja e saj të jetë një nga pikat kyçe të riafrimit të SHBA-s me BE-n, dhe që të jetë poashtu një synim i përbashkët i suksesit SHBA-BE.

Administrata Biden do të mund ta mbështesë ndërmjetësimin e BE-së në

çështjen Kosovë-Serbi, si shtytës i procesit nga jashtë dhe garantues i parimeve të procesit dhe gjithsesi i rezultateve të saj.

Parimet janë të qarta: përparim i marrëdhënieve dyplashëse Kosovë-Serbi deri në njohjen e ndërsjellë, integritet territorial të plotë për Kosovën dhe jo shkëmbim terrioresh Kosovë-Serbi, dhe respektim të ndërsjellë të përfaqësimit të drejtave të komuniteteve pakicë në përputhje me Kartën Europiane të Vetëqeverisjes Lokale. Të gjitha këto do të duhet të ishin pjesë e një marrëveshjeje përfundimtare Kosovë-Serbi, të përkrahur nga Biden.

Natyrisht se edhe Serbia mund të përparojë duke u integruar më tepër në BE, dhe duke përmirësuar mëtej marrëdhëniet e saj me Amerikën nëpërmjet pranimit dhe njohjes së Kosovës së mëvetshme. Serbia ka alternativa, mund të afrohet me Rusinë apo Kinën, por në fund ajo gjendet në Europë dhe dëshiron të jetë pjesë e BE-s, dhe mbase edhe NATO-s.

Duke qenë se Presidenti Trump kishte kritikuar vetë NATO por edhe kontributin e shteteve aleate të SHBA për NATO, edhe këtu

pritët që Biden të bëjë ndryshime. Biden kishte thënë për NATO: "aleanca shkon përtej dollarëve dhe centave; zotimi amerikan [për aleatët e NATO-s] është i shëndetshëm, jotransaksional." Edhe në këto plane të administratës amerikane ekziston mundësia që Kosova të gjejë vend.

Presidenti Trump dha mbështetjen qenësore për krijimin e ushtrisë së Kosovës, edhe atëherë kur shumë aleatë të Kosovës në NATO nuk e përkrahnin. I zgjedhuri President Biden mund të çojë këtë edhe mëtej, duke realizuar anëtarësimin e Kosovës në NATO, në katër vitet e ardhshme. Nga Kosova do të nevojitet një argumentim dhe angazhim i qëllimshëm dhe i vazhdueshëm për këtë. Ky duhet të jetë synim kryesor për sigurinë shtetërore të Kosovës.

Edhe Serbia në të kaluarën ka shprehur dëshirë për anëtarësimin në NATO, por mbase këtë nuk do të bëjë për ta ruajtur afërsinë ushtarake me Rusinë. Hyrja e Kosovës në NATO pak a shumë do të eliminonte mundësinë e një konflikti të armatosur në mes Kosovës dhe Serbisë, si dhe do ta pengonte shtrirjen më të madhe të ndikimit rus në rajon.

Presidenti Trump është kritikuar më të drejtë për një afinitet dhe butësi kundrejt Presidentit Putin, edhe pse Kongresi dypartiak amerikan kishte ruajtur tërë kohës një qëndrim më të ashpër ndaj Rusisë.

Presidenti Biden gjithsesi do të jetë më i ashpër ndaj Rusisë, por mbase këtë mund ta bënte në dy shtigje. Në njerën, duke kufizuar manovrimin e Rusisë në çështjet globale më shumë sesa bëri Trump, dhe në tjetrën, duke kuptuar që një normalitet duhet në marrëdhëniet SHBA-Rusi, që të mos ketë rritje të tensioneve dhe të rreziqeve që ato shkaktojnë.

Për Ballkanin do të mund të pritët që SHBA ta kufizojë zgjerimin e mëtejshëm të ndikimit rus. Në lidhje me Kosovën dhe Serbinë, pranimi i Rusisë për normalizimin e këtyre marrëdhënieve do të mbyllte më të vërtetë këtë kapitull, dhe t'i hapte rrugë anëtarësimit të Kosovës në OKB.

Pra, nuk është se administrata e re amerikane do të duhet që në mënyrë specifike të merret me Ballkanin. Në vend të kësaj, Kosova dhe vendet e tjera mund ta vendosin vetën në agjendën amerikane për BE,

NATO, dhe Rusinë. Në të tre këto rrafshet ka përfitime për Kosovën dhe Serbinë, e sidomos për Kosovën.

Angazhimi i Kosovës në këto rrafshet mund të thellojë mëtej marrëdhëniet e veçanta me Amerikën e Presidentin Biden. Por gjithashtu, Kosova duhet t'i ripërkushtohet reformës në qeverisje që të mund të dallohet si rast suksesi në rajon e më gjerë, duke tërhequr kështu një vëmendje me të madhe pozitive.

Marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë do të jenë të rëndësishme për Administratën e re, por do të duhet të mos jenë kryefjala e marrëdhënieve SHBA-Kosovë. Për këtë nevojitet që Kosova të formësojë këto marrëdhënie më shumë, ku marrëdhënie të zgjeruara me SHBA përfshijnë Serbinë, por edhe shumë çështje të tjera të bashkëpunimit.

(Autori është profesionist në fushën e zhvillimit ndërkombëtar dhe punon në sektorin privat në Washington, D.C. Ka magjistruar në marrëdhëniet ndërkombëtare në Columbia University në New York.)



SERBIA NËN PRESIONIN E NDRYSHIMEVE DEMOKRATIKE NË FQINJËSI

Vala demokratike drejt digave të pushtetit serb

Krijohet përshtypja se regjimi në Serbi është i rrethuar me diga solide kundër valëve të demokracisë që po spërkasin nga jashtë. Kësaj gjendje mund t'i përgjigjet vetëm analogjia. Gjithçka ishte njëjtë apo ngjashëm edhe në Maqedoni, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Hungari. Por shikoni ku janë tani.

NGA DEJAN ILIQ

Serbia është e rrethuar. Rrethi i ndryshimeve demokratike po ngushtohet rreth saj. A do t'i rezistoj ndryshimeve regjimi i Vuçiqit? Situata po vështirësohet: nga brenda regjimin e gërryen korona, nga jashtë presioni i vullnetit të shprehur të popujve (të tjerë). Autokratët rreth Serbisë po bien sikur dominot. A mundet që vala e lirisë ta vërshojë edhe Serbinë? Mirë, ndoshta edhe po e teproj.

Fakti se Dodiku dhe Izetbegoviçi humbën Banjallukën dhe Sarajevën në zgjedhjet e sapopërfunduara lokale në Bosnje dhe Hercegovinë, nuk do të thotë që edhe është fillimi i fundit të tyre. E as fakti që Orbani humbi zgjedhjet lokale në Budapest, nuk nënkupton detyrimisht që nuk do ta shohim tutje si lider i Hungarisë. Para Bosnje dhe Hercegovinës, si dhe para Hungarisë, ka mbetur rrugë e gjatë për të arritur deri aty ku tanimë janë Maqedonia, Kosova dhe Mali i Zi, me lëvizjet e tyre demokratike dhe me ndërrimin paqësor të pushtetit.

Kërcënim për regjimin në Serbi nuk janë vetëm ndryshimet në fqinjësi. Ndryshim i madh ndodhi edhe në vendin i cili mund të shikohet si fqiu global i secilit shtet. Humbja e Trumpit në zgjedhjet e Shteteve të Bashkuara është gjithsesi një shenjë jo e mirë për regjimin në krye me Vuçiqin (si dhe për të gjithë radikalët djathtist në tërë globin). Ka analistë që mendojnë se Amerika është nxjerrur në momentin e fundit nga kapja e çeliktë e Trumpit. Ata besojnë se Trumpi do t'ia thyente kurrrizin institucioneve amerikane në do ta fitonte mandatin e dytë bashkërisht me administratën e dëgjuesve të verbër dhe Partinë (e nënshtruar) Republikane. Kjo megjithatë nuk ndodhi.

Regjimi në krye me Vuçiqin tani edhe mund të shikoj me simpati drejt modeleve të tij pak më të largëta, si në Poloni apo Turqi, por duket se edhe atje nuk qëndrojnë gjërat mirë për autokratët. Sikurse Orbani, Dodiku dhe Izetbegoviçi, edhe Erdogani humbi qytetin e madh dhe prestigjioz të Stambollit, në zgjedhjet e fundit lokale turke. Derisa Jarosllav Kaczynski, që tërheq fillat e shtetit, me partinë e tij 'Ligji dhe drejtësia', është ngatërruar me ligjin për ndalimin e abortit



(njësoj si Gjukanoviçi që ishte ngatërruar me ligjin mbi besimet fetare). Tani është i detyruar të përballet me valën e protestave masive të grave dhe burrave mendjehapur.

Bjellorusia e pafat, në krye me Lukashenkon, mbetet rrëfim në vete, andaj edhe po e lëjmë anash në këtë rast.

Pra, Vuçiqit nuk i shkruhen ditë të mira, nëse është për t'u gjykuar nga ngjarjet në fqinjësinë e afërt, evropiane dhe globale. Çështja është se a ka Serbia kapacitete për t'iu bashkëngjitur këtij efekti domino. Deklaratat e Bërnabiqit se Serbia është vend pa ndasi, ku në mënyrë unanime votohet në masë të madhe për liderin, nuk janë të besueshme. Këto deklarata vetëm tregojnë se regjimi është i vetëdijshëm se ç'po ndodh përrreth kufijve të Serbisë dhe se po tenton t'i përgjigjet kësaj sfide. Po ç'qëndron tek ne si e kundërta e regjimit, si opsion i pranueshëm demokratik?

Para se të themi diçka lidhur me këtë, të shohim sesi kanë qëndruar apo si po qëndrojnë gjërat në disa nga vendet e përmendura. Në Maqedoni, Mal të Zi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (edhe pse duket groteske ky pohim) kemi pasur organizime të fuqishme opozitare. Në Maqedoni dhe

në SHBA ka parti të fuqishme opozitare. Në Mal të Zi, opozita ishte Kisha Ortodokse Serbe. Në Hungari, pastaj në Bosnje dhe në Turqi, në vend të partive të fuqishme kishte koalicionet e zgjeruara opozitare. Në Mal të Zi, koalicionet e këtitilla të zgjeruara janë mbështetur nga Kisha Ortodokse Serbe. Një koalicion i ngjashëm është duke u formuar në Poloni rreth të drejtave (të gruas).

Dalja në rrugë është element tjetër shumë i rëndësishëm. Në gjithë këto vende, fitoreve opozitare në zgjedhje i kanë paraprirë protestat e qëndrueshme masive. Njerëzit kanë protestuar kundër regjimit në Mal të Zi me muaj të tërë. Me vite të tëra në Maqedoni dhe në Banjallukë. Amerikanët kanë bërë rezistencë njëherësh në rrugë, para se të votonin kundër Trumpit dhe administratës së tij. Ngjashëm ishte edhe në Turqi dhe Hungari. Para numërimit të votave, qytetarët opozitarë numëroheshin në rrugë, për të përfunduar se ndryshimi është i mundshëm.

Kundërprotesta e regjimit në Serbi si përgjigje ndaj protestës së madhe të opozitës më 2019 duhet parë si një demonstrim i qartë i fuqisë me duar bosh, por edhe i fuqisë së numrave. Regjimi nxjori në mënyrë të organizuar më shumë se

njëqind mijë përkrahës (vullnetarë të dyshuar), si përgjigje ndaj dyzet mijë protestuesve të opozitës. Përdorimi i tepruar i forcës ndaj protestuesve në qershor të 2020 do të duhej të merrej si veprim edukues ndaj banorëve të panënshtuar të Beogradit dhe Serbisë. Njëjtë veproi edhe Dodiku në Banjallukë në fund të vitit 2018, ndaj lëvizjes 'Drejtësi për Davidin', kur i shpërndau njerëzit nga rruga duke e përdorur brutalisht forcën policore. Krahas policisë, protestuesit më vonë u ndoqën edhe nga gjykata. Ishte Stanivukoviçi, prefekti i ri i Banjallukës nga radhët e opozitës, që tregoi urtësi dhe trimëri përkundër presionit, duke i zhvendosur kërkesat (e ngufatura) nga rruga në fushën institucionale të betejës politike. Gjë që i solli më vonë fitoren në zgjedhje.

Krahas organizimeve të fuqishme në rrugë dhe koalicioneve të kurdisura, në të gjitha këto vende ekzistojnë pak a shumë media të lira, kryesisht private. Diçka që e dëshmon një dozë lirie ekonomike në vendet përkatëse.

Tani mund ta tërheqim konkluzionin. Në Serbi nuk ka parti të fuqishme opozitare. Një parti e tillë mund të jetë vetëm Partia Demokratike, por ajo është rrënuar deri në themel, si nga brenda ashtu edhe nga

jashtë, sipas direktivave të regjimit. Daljet në rrugë janë sporadike dhe deri tani, ato nuk kanë sjellë krijimin e ndonjë koalicioni të zgjeruar. Në vend se opozita të del më e fuqishme nga këto dalje, opozita duket më e dobët pas çdo dalje të protestuesve në rrugë. Ky është një fenomen jo i rëndomtë. Padyshim se pjesë e kësaj loje është edhe nëntoka e mbështetur nga regjimi. Megjithatë, ka edhe një arsye, sepse çdo dalje në rrugë, nga këndi i liderëve opozitarë shikohet si mundësi për t'u promovuar si liderë të së ardhmes. Megjithatë, në Serbi, liria e mediave dhe liria relative ekonomike nga politika, duken qëllime të paarrtshme. Edhe ato pak media e mbetura të lira janë nën presionin e fuqishëm politik dhe ekonomik të regjimit.

Krijohet përshtypja se regjimi në Serbi është i rrethuar me diga solide kundër valëve të demokracisë që po spërkasin nga jashtë. Kësaj gjendje mund t'i përgjigjet vetëm analogjia. Gjithçka ishte njëjtë apo ngjashëm edhe në Maqedoni, Bosnje dhe Hercegovinë, Mal të Zi, Hungari. Por shikoni ku janë tani.

(Ky tekst është botuar në portalin "Peščanik")

KUSH DO T’I KONTROLLOJË TEKNOLOGJITË E INTERNETIT?

Beteja gjeopolitike rreth 5G

Në prag të vendosjes së saj, telefonia mobile e gjeneratës së pestë - 5G - ngre një lumë pyetjesh në lidhje me ndikimin ekologjik dhe shëndetësor dhe më thelbësisht, me zhvillimet teknologjike të dala jashtë kontrollit. Por "lufta e madhe" e 5G-s po luhet gjithashtu në fushën gjeopolitike, me në sfond përballjen gjithnjë e më të hidhur midis Shteteve të Bashkuara dhe Kinës.

NGA EVGENY MOROZOV*

Në vitin 1994, kur Huawei ishte ende vetëm një shitës i vogël i komutatorëve telefonikë, themeluesi i tij, z.Ren Zhengfei, pati një bisedë me presidentin e atëhershëm kinez z.Jiang Zemin. Ky ish-inxhinier i ushtrisë i konvertuar në elektronik për publikun e gjerë, në këtë bisedë luajti kartën patriotike: “Telekomunikacioni është çështje e sigurisë kombëtare. Për një komb, të mos ketë pajisjet e veta në këtë fushë është si të mos ketë ushtri ». Ky plan u miratua edhe nga vendet e tjera, me në krye Shtetet e Bashkuara. Ironikisht, sot janë SHBA që e shohin Huawei-in dhe kontrollin e saj mbi teknologjinë 5G, si një kërcënim për sigurinë kombëtare.

Kur ishte në pronësi të punonjësve të saj, kompania karakterizohej nga një sistem jo i zakonshëm i ndryshimeve në menaxhim, përbuzja e saj për tenderat – gjykuar si “lakmitare” nga z.Zhengfei -, kulti i saj i vlerave Maoiste dhe lidhja me idenë e inovacionit për të thyer varësinë e Kinës ndaj firmave të huaja “imperialiste”. Grupi tani menaxhon rrjetet në 170 vende dhe punëson më shumë se 194.000 njerëz. Që nga viti 2009, ai ka qenë një prej aktorëve kryesorë në zhvillimin e 5G, si nga ana industriale ashtu edhe brenda organizmave të ndryshme ndërkombëtare të standardizimit. Në verën e vitit 2020, Huawei rrëzoi Samsung-un nga fronin duke u bërë shitësi kryesor në botë i smart-phone-ve. Filiali i tij HiSilicon projekttoi chipin Kirin, i cili fuqizon disa nga aplikacionet më të përparura të inteligjencës artificiale në treg.

Ky sukses i jashtëzakonshëm mund të shpjegohet pjesërisht nga një angazhim i palëkundur për punën kërkimore dhe zhvillimin (R&D – research & development), të cilit kompania i kushton më shumë se 10% të fitimeve të saj vjetore, ose më shumë se 15 miliardë dollarë në 2019 – 20 miliardë pritet të jenë në vitin 2020 -, më shumë se Apple dhe Microsoft. Sa për krahasim, i gjithë sektori gjerman i automobilave investoi rreth 30 miliardë dollarë në R&D në 2018. Përtej këtyre shifrave, Huawei përfaqëson një standard për shoqërinë kineze: shembulli i rrallë i një kompanie që filloi ne fund të zinxhirit me produkte rudimentare dhe ultra të standardizuara, tani konkuron me Apple ose Samsung. Trajektorja e saj ilustron aspiratat e larta të qeverisë për sektorin e teknologjisë. Kina ka qenë prej kohësh e kufizuar në funksionin e një fabrike montimi për produktet e huaja, siç kujtojnë fjalët në pjesën e pasme të të gjitha pajisjeve Apple: “Designed by Apple in California. Assembled in China”. Fati i Huawei-t tregon se një epokë e re mund të nisë nën sloganin: “Designed in China. Assembled in Vietnam”.

Nëse ndërmarrjet e tjera kineze ndjekin këtë shembull, dominimi



amerikan në ekonominë botërore mund të tronditet rëndë. Padyshim, në të kaluarën, vendet e ankoruara fort në sferën e ndikimit të Shteteve të Bashkuara përjetuan një rritje të shpejtë ekonomike – Gjermania, Japonia, Tigrat Aziatikë – por procesi mbeti kryesisht i udhëhequr nga Uashingtoni. Në fillim të shekullit XXI, amerikanët e patën të vështirë të shihnin Kinën të ngrihej në majë tekta ndiqte qëllimet e saj gjeopolitike, ndërsa ata vetë duket se dremitin pas timonit.

Për këtë, sfidat e debatit aktual për 5G-n shkojnë shumë përtej çështjes së dominimit kinez mbi këtë standard të telefonisë. 5G-ja është teknologji që lejon lidhje më të shpejtë me një numër më të madh pajisjesh, këto vetë të lidhura dhe të ndërlidhura me njëra-tjetrën, ndërsa afron operacionet e punimit të të dhënave më afër burimit të tyre, përkatësisht përdoruesit përfundimtar. Por buja që e rrethon ju bën të harroni pengesat e shumta për zbatimin e tij industrial. Për shumicën e përdoruesve, ndikimi i 5G-së do të jetë i kufizuar në rritjen e shpejtësisë së shkarkimit.

Ushtria e bukë-thekseve të lidhura me 5G

Sigurisht, lëvizja në treg e rrjetëve dhe pajisjeve kërkon investime kolosale dhe beteja po zhvillohet për të pushtuar tregun. Por Huawei dhe 5G janë vetëm maja e ajsgjergut. Në sfond është një përballje shumë më e madhe ekonomike dhe gjeopolitike në të cilën kinezët përpiqen të kenë avantazh ndaj amerikanëve. Nëse 5G-ja po i vendos ata në vështirësi, kjo është për shkak se nuk kanë një kampion për ta dërguar

në vijat e frontit. Evropa është më paqësore, pasi është shtëpia e dy OEM (original equipment manufacturer-prodhues origjinalë pajisjesh)- Nokia dhe Ericsson.

Ofensiva e Uashingtonit kundër teknologjisë së lartë kineze po godet një gamë të gjerë të kompanive, nga OEM ZTE (në pronësi të Kinës dhe gjithashtu shumë aktiv në fushën 5G) te WeChat, TikTok dhe shumë të tjerë më pak të njohur. Por Huawei është padiskutim objektivi kryesor, sepse në sytë e Shtëpisë së Bardhë ajo mishëron esencën e një Kine të paskrupullt, krimet e së cilës Shtetet e Bashkuara vazhdojnë të dënojnë dhe sanksionojnë, në Hong Kong, në Xinjiang, në Detin e Kinës Jugore, etj., deri në pikën që z.Donald Trump i referohet kompanisë me një prej atyre pseudonimeve që i pëlqen: “Spiuni » (The Spyway)

Parë nga zyra ovale, Huawei simbolizon ato goditje të ulta që bota gabimisht i sheh si suksese të merituar të biznesit. Shkel të drejtat e pronësisë intelektuale, tiranizon partnerët e saj, përfiton nga ndihma bujare shtetërore për të ulur çmimet dhe për të shtypur konkurrencën. Duke ndërtuar rrjetet telekomunikuese në vendet e Jugut, i vendos ato në një marrëdhënie varësie të thellë, duke marrë pjesë kështu në “diplomacinë e borxhit” të Pekinit, të vendosur veçanërisht përmes projektit të tij “trugët e reja të mëndafshit”. Akoma më keq, Huawei do t’i pajisë produktet e saj me “dyer të pasme” (backdoors) për të lejuar regjimin kinez të zgjerojë aktivitetin e tij të mbikëqyrjes. Sipas kritikëve të saj më imagjinarë, firma së shpejti do të jetë në gjendje të kthejë kundra nesh frigoriferët dhe bukë-thekset e lidhura me

5G.

Në mbështetje të këtyre kritikave, shpesh citohet ligji kombëtar mbi informimin, i vendosur nga Pekini në 2017, i cili kërkon që bizneset (dhe qytetarët) të bashkëpunojnë me autoritetet duke u dhënë atyre informacione kur kërkohen. Një arsye tjetër për shqetësim: përshpejtimi i “shkrirjes civile-ushtarake”, një përpjekje për të shkrirë marrëdhëniet midis sektorit të teknologjisë dhe ushtrisë ... që është frymëzuar nga shembulli amerikan. Huawei, nga ana e tij, mohon kategorikisht akuzat e spiunazhit, duke theksuar se qeveria kineze nuk do të rrezikonte të prishte reputacionin dhe kredibilitetin e saj ndërkombëtar.

Siç është zakoni, pretendimet e administratës Trump bazohen në shumë pak prova, ose ne prova inekzistente. Kjo nuk e pengoi atë të kërkonte të bashkonte disa vende në « kryqëzatën » e saj, veçanërisht Mbretërinë e Bashkuar, Francën, Italinë dhe shumë shtete të Evropës Lindore, duke i “nxitur” ata të ndalojnë Huaweiin në rrjetet e tyre 5G – një eufemizëm, aq të forta janë presionet ekonomike dhe diplomatike të ushtruara nga Departamenti i Shtetit përmes ambasadave. Dhe është e njëjta gjë në të gjitha kontinentet. Pas lobimit intensiv nga Sekretari i Shtetit Mike Pompeo, qeverisë kiliane iu desh të vendoste të përjashtonte Huawei-n nga projekti i saj kabllor nënutor. Në Indi, ku Huawei ka prani të madhe, Kryeministri Narendra Modi po mendohet nëse do të zgjedhë ose jo furnizuesin kinez si një instrument hakmarrjeje ndaj Pekinit pas përplasjeve të dhunshme të kufirit. Megjithatë ende nuk është njoftuar asnjë ndalim zyrtar, New Delhi thuhet se po

konsideron të përdorë një kompani kombëtare, Reliance Industries.

Mbretëria e Bashkuar, megjithëse disi e mpirë në këto kohë të Brexit-it, lëshoi një goditje korrikun e kaluar duke kërkuar që operatorët e saj celularë të hiqnin të gjitha pajisjet ekzistuese Huawei nga rrjeti deri në vitin 2027. Vendimi befasoi shumë duke qenë ky vend është një nga pikat kryesore të strategjisë evropiane të grupit. Gjithashtu pikërisht në Mbretërinë e Bashkuar, Huawei hapi, në 2010, në partneritet me shërbimet e inteligjencës Britanike, një Qendër të Vlerësimit të Sigurisë Kibernetike (HCSEC) përgjegjëse për analizimin dhe korrigjimin e dobësimit të sigurisë të identifikuar në rrjetet e saj. Por këto marrëdhënie të mira nuk peshuan mjaftueshëm përpara « frikësimit » nga Uashingtoni dhe kritikave nga Partia Konservatore, në radhët e së cilës u formua një grup parlamentar armiqësor ndaj Kinës – moda e tanishme.

Bashkimi Evropian nuk ka arritur të përcaktojë një politikë të përbashkët për 5G, kryesisht sepse çështja është adresuar në drejtim të sigurisë kombëtare, një zonë në të cilën shtetet anëtare janë sovranë. Do të kishte qenë më e arsyeshme ta shihnim atë nga këndi i politikës industriale dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Një gjigant unik evropian i 5G, pasardhësi i Nokia dhe Ericsson, mund të ishte krijuar, subvencionuar bujarisht dhe me një mision për të barazuar përpjekjet e R&D së Huawei-it. Ne mund të dyshojmë se gjërat po lëvizin në këtë drejtim, edhe nëse Komisioni Evropian, nën presionin e francezëve dhe gjermanëve, kohët e fundit ka treguar ndonjë prirje për të braktisur hobin e tij – konkurrencën – për të marrë parasysh kontekstin gjeo-ekonomik.

Gjermania, i vetmi vend i madh evropian që ende nuk ka zbuluar planin e saj 5G, është zotuar të vendosë në vjeshtë të vitit 2020. Politikanët janë të ndarë në këtë çështje, madje edhe partia e Angela Merkel është copëzuar. Nga ana tjetër, diplomatët amerikanë të vendosur në Berlin, nuk humbin asnjë rast për t’i kujtuar bashkëbiseduesit se çfarë mund t’u kushtojë preferenca e tyre ndaj Huawei-t.

Diplomacia e borxhit

Nëse, në legjendën e shkruar nga z.Trump, firma Shenzhen mishëron “komunizmin sekret” kinez, fenomeni Huawei bën thirrje për studime të mëtejshme. Një nga më tërheqëset është ajo e propozuar nga ekonomisti Yun Wen. Pas mburrjes, shijes për aforizmat Maoiste dhe prirjet e tij nacionaliste, z.Zhengfei, presidenti aktual i firmës, duket se është një njohës i mirë i ndërlkimeve të gjeopolitikës. Nën udhëheqjen e tij, Huawei u vendos në rajone të vështira – në fshatrat

kineze qysh në vitet 1990, më pas disa vende të Jugut ku perspektivat e fitimit ishin të pakta – dhe i bëri ato urë për të sulmuar tregje më premtuese. Ndërsa Kina shtriu tentakulat e saj në Afrikë dhe Amerikën Latine, Huawei dhe bashkatdhetari i saj ZTE u bashkuan me lëvizjen për të ardhur dhe për të ndërtuar rrjetet e tyre, duke përfituar nga huatë e dhëna nga Pekini për qeveritë lokale për t’i ndihmuar ata të financojnë projektet e infrastrukturës. Sipas Yun Wen, në rastin e Huawei, kjo diplomaci borxhi nuk do të kishte pasur vetëm efekte negative. Jo vetëm që të ardhurat e gjeneruara nga kompania në vendet e jugut janë relativisht të vogla në krahasim me tregjet e tjera, por vendosja e saj në këto rajone, pjesërisht e nxitur nga fryma e “internacionalizmit të botës së tretë” e dashur për Mao-n, e ka bërë atë të trajnojë një numër të konsiderueshëm inxhinierësh dhe teknikësh të kualifikuar në terren.

Shtetet e Bashkuara kanë qenë gjithmonë një zonë me rrezik të lartë për Huawei, shumë kohë para presidencës së z.Trump dhe madje edhe asaj të z.Barack Obama. Në vitin 2003, furnizuesi kinez u padit nga konkurrenca në treg kryesor amerikan, Cisco, për shkelje të patentës. Kjo pengesë e parë do të pasohet nga shumë më tepër. Pasi u ndalua të merrte ndonjë aksion ose kontroll aksionesh në kompanitë amerikane, Huawei tani mund të humbasë aftësinë për t’u shërbyer klientëve të saj dhe për të hedhur në treg produkte të reja në Shtetet e Bashkuara. Që nga fillimi, një akuzë ka dalë si një refren: Huawei po punon krah për krah me ushtrinë kineze. Në 2011, një zbulim i Wall Street Journal (27 tetor) ku thuhet se kompania tregtonte me Iranin, në kundërshtim me sanksionet e SHBA-së kundër këtij vendi, ngarkoi akoma me shumë akuzat. Qysh në vitin 2013, Huawei njoftoi tërheqjen e saj nga territori Amerikan dhe prania e tij në Uashington tani kufizohet vetëm nga një ushtri lobistësh.

Dikush mund të pyesë me arsye se pse duke qenë se fillimet i ka pasur shtatëmbëdhjetë vjet më parë, fushata amerikane anti-Huawei është intensifikuar vetëm kohët e fundit. Në fund të vitit 2018, qeveria amerikane urdhëroi arrestimin e vajzës së z.Zhengfei, znj. Meng Wanzhou, drejtoresha e financave të Huaweiit, gjatë një tranziti në Kanada. Që atëherë, Uashingtoni ka marrë përsipër të shkatërrojë grupin duke miratuar sanksione gjithnjë e më të ashpra. Z.Trump i ka kërkuar fondit zyrtar të pensionit të qeverisë që të mos investojë në kompanitë kineze. Kontraktorët e qeverisë federale duhet të provojnë se nuk kanë asnjë lidhje tregtare me Huawei. Sa për kompanitë kineze të listuara në Shtetet e Bashkuara, ato urdhërohen të publikojnë llogaritë e tyre dhe të deklarojnë çdo kontakt me qeverinë e Pekinit. Disa faktorë ekonomikë dhe gjeopolitikë bashkohen për të shpjeguar ofensivën e Uashingtonit.

Në nivelin gjeopolitik, zbulimet e z.Edward Snowden në vitin 2013 mbi aktivitetet e Agjencisë Amerikane të Sigurisë Kombëtare (National Security Agency, NSA) japin një pistë interesante, siç kujton Yun Wen. Në vitin 2010, nën emrin e koduar “Operacioni Shotgun”, NSA pushtoi serverat e Huawei me një qëllim të dyfishtë: për të gjetur gjurmët e lidhjeve të mundshme të kompanisë me ushtrinë kineze – peshkimi nuk ishte aq i suksesshëm, duke qenë se asnjë dokument nuk ka rrjedhur në media – dhe për të identifikuar defektet e sigurisë në pajisjet e saj në mënyrë që të lejojë

shërbimet e inteligjencës amerikane të spiunojnë disa nga shtetet e saj klientë, të tilla si Irani dhe Pakistani. Në dokumentet e dhëna nga Snowden, NSA nuk e fsheh qëllimin e saj: “Shumica e targeteve tona komunikojnë duke përdorur pajisje të bëra nga Huawei. Ne duam të sigurohemi që jemi njohur me këto produkte në mënyrë që t’i përdorim lehtësisht dhe të kemi akses në ato linja. Z. Guo Ping, kryetari i Huawei, atëherë kishte këtë koment mjaft të arsyeshëm, “[Huawei] është një gjemb në këmbë për Uashingtonin, sepse e ndalon atë të spiunojë këdo që ai e gjykon të arsyeshme”. “

Në të vërtetë, nëse Huawei do të fitonte garën 5G, epërsia e inteligjencës amerikane do të komprometohej ashpër, qoftë vetëm për shkak se firma kineze ka të ngjarë të jetë më pak e gatshme të bashkëpunojë informalisht me agjensitë amerikane sesa, për shembull, konkurrentët e saj evropianë.

Nga një perspektivë ekonomike, përtej infrastrukturës materiale të kërkuar nga 5G, ne duhet të jemi të interesuar në rrjetet e të drejtave të pronësisë intelektuale që përmban. E para dhe më e rëndësishmja, 5G është normë. Çdo rrjet ose pajisje që synon ta operojë atë duhet të plotësojë kushtet e tij teknike, të cilat domosdoshmërisht përfshijnë përdorimin e teknologjive të patentuara. Një smartphone modern me Wi-Fi, ekran me prekje, procesor, etj., mbrohet të paktën nga 250,000 patenta (kjo shifër e vitit 2015 ka të ngjarë të jetë më e lartë sot). Sipas një vlerësimi të vitit 2013, 130,000 prej këtyre patentave janë “Patenta Standarde-Thelbësore” ose SEP (Standard-Esenciale Patentat, SEP), siç janë ato që lejojnë pajtueshmërinë me një standard teknik siç është 5G.

Në fushën e teknologjive mobile, numri dhe shpërndarja gjeografike e mbajtësve të SEP kanë evoluar në kurriz të Amerikës dhe Evropës Perëndimore dhe në përfitim të vendeve aziatike. Kush thotë patenta, thotë honorare. American Qualcomm, fituesi i madh i 2G dhe disa standardeve të tjera të rëndësishme, nxjerr dy të tretat e xhiros së tij nga Kina, kryesisht nga Huawei. Vetëm kjo e fundit ka shpenzuar më shumë se 6 miliardë dollarë në honorare që nga viti 2001, 80% e të cilave u ka shkruar kompanive amerikane. Këto shuma joproportionale përfundimisht e bënë Pekinin të reagojë. Pasi gjobiti Qualcomm me 975 milion dollarë për abuzim me një pozitë dominuese në 2015, ajo arriti, tre vjet më vonë, të bllokonte përpjekjen e saj për marrjen e Hollandezit NXP, duke argumentuar se transaksioni do të ulte më tej marzhin e manovrimeve të kompanive të saj.

“Ne jemi në luftë”

Gjërat kanë ndryshuar. Huawei tani është ndër mbajtësit më të mëdhenj të SEPs që lidhen me 5G. Kjo nuk e ndalon atë të mbetet shumë kritike ndaj sistemit global të pronës intelektuale – z. Ping bëri thirrje për një rishikim të rregullave të këtij “klubi ndërkombëtar” në një kuptim më të drejtë dhe të dobishëm për të gjithë, duke krahasuar akuzat me “një të drejtë kalimi të vendosur nga autostradat”. Sigurisht, natyra “thelbësore” e patentave të mbajtura nga firma është e diskutueshme. Siç theksoi një analist, nëse smartphone do të ishte një aeroplan, patentat e Nokia dhe Ericsson do të mbulonin motorin dhe sistemin e navigimit, ndërsa Huawei do të mbulonte vetëm vendet dhe karrocet e ushqimit ... Por,

çfarëdo që të jetë fuqia e patentave të tij, Huawei ka arritur të nxjerrë veten nga situata e varësisë.

Për Kinën, kërkesa për t’u bërë një huadhnës patente (në vend të një huamarrësi) ka kuptim ekonomik. Kjo është mënyra se si ajo arriti të kapërcejë hendekun e madh midis saj dhe Shteteve të Bashkuara për sa i përket të drejtave neto të mbledhura: nëse, në vitin 1998, kompanitë amerikane morën 26.8 herë më shumë honorare sesa homologët e tyre kinezë, në vitin 2019 raporti ishte vetëm 1.7. Logjikisht, Pekini gjithashtu ka filluar të ketë më shumë peshë në organet e standardeve botërore. Komisioni Ndërkombëtar Elektroteknik (International Electrotechnical Commission) dhe Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit, ose ITU (International Telecommunications Union) drejtohen nga Kinezët, dhe mandati tre-vjeçar i presidentit të parë kinez të Organizatës Ndërkombëtare të Standardizimit, ose ISO (International Organization for Standardization), përfundoi në 2018.

Në Organizatën e Kombeve e Bashkuara (OKB), ajo ka qenë shumë aktive në vendosjen e standardeve për teknologjitë e njohjes së fytyrës. Në ISO, mori një interes të veçantë për qytetet e lidhura, terreni i preferuari i Alibabës, e cila shqetësoonte shumë Japoninë. Më në fund, përmes programit të tij ambicioz China Standards 2035, i lançuar me shumë bujë në vitin 2020, ajo synon të përmirësojë bashkëpunimin midis kompanive të teknologjisë dhe agjencive qeveritare për të inkurajuar zhvillimin e standardeve ndërkombëtare të favorshme për interesat e saj.

Po tani, çfarë do të bëjnë Shtetet e Bashkuara? Disa vëzhgues bëjnë një paralele midis fushatës aktuale anti-kineze dhe periudhës së viteve 1980, kur Uashingtoni po përpiqej të zbushte gjigandët industrialë japonezë. Në 1986, shumë anëtarë të administratës së Reaganit dhe anëtare të industrisë menduan se po mbyteshin kur Fujitsu njoftoi qëllimin e tij për të blerë prodhuesin legjendar të gjysmëpërçuesve amerikanë Fairchild Computing. Një ekzekutiv i industrisë përmbledhi ndjesinë e përgjithshme: “Ne jemi në luftë me Japoninë – jo një betejë me armë dhe plumba, por një luftë ekonomike në të cilën municionet janë teknologji, produktivitet dhe cilësi. (Los Angeles Times, 30 nëntor 1987). Disa vjet më parë, sanksionet tregtare të inkurajuara nga Shtëpia e Bardhë kishin patur sukses në parandalimin e Toshiba, një tjetër gjigand japonez, nga shitja e kompjuterëve të saj në tregun amerikan.

“Ne jemi në luftë”: parulla nuk ka ndryshuar në fakt. Mosmarrëveshja tregtare SHBA-Japoni ka ardhur në një fund paqësor; shumë në Kinë dëshirojnë të besonin se e njëjta gjë do të ishte e vërtetë dhe se një marrëveshje e qëndrueshme përfundimisht do të dilte me koston e disa koncesioneve. Por ky rezultat duket gjithnjë e më i pamundur. Në këtë drejtim, administrata Trump është e ndarë në tre kampe. E para është ajo e vetë presidentit. Gjithçka sugjeron që sulmet e tij ndaj Huawei janë pjesë e një strategjie më të madhe për të siguruar një avantazh tregtar ndaj Pekinit. Në fakt, nëse qëllimi do të ishte me të vërtetë për ta parandaluar hegjemoninë e Kinës mbi 5G, ZTE, pronë e shtetit do të bënte një thes boksi shumë më të mirë se Huawei – dhe aktualisht ja hedh pa shumë dëm, vetëm me një gjobë prej 1 miliard dollarësh. Për z.Trump, Huawei është një monedhë në negociatat tregtare – dhe

gjithashtu një parullë fushate.

Kampi i dytë është ai i fajkojve, i udhëhequr nga Peter Navarro, Këshilltar i Presidentit mbi tregtinë dhe Robert Lighthizer, Përfaqësues i Tregtisë së SHBA. Në sytë e tyre, ndalimi i ngritjes së Kinës është një domosdoshmëri jetike dhe ata nuk do të hezitojnë të godasin Huawei edhe më shumë sesa është bërë. Ata janë pas të gjitha propozimeve që synojnë ta zgjerojnë gamën e kompanive kineze të prekura nga sanksionet. Më në fund, është kampi i tretë, ai i kompleksit ushtarako-industrial, i cili preferon të luajë pëllumbat. Dhe për një arsye të mirë: për të Kina përfaqëson një treg fitimprurës. Në vitin 2019, vetëm Huawei bleu 19 miliardë dollarë pajisje elektronike nga prodhuesit amerikanë. Pengimi i prodhuesve kombëtarë për të tregtuar me Kinën do të thotë favorizim i konkurrentëve të tyre të huaj.

Për sa kohë që kishte shpresë për një zbatim të plotë të marrëveshjes tregtare kinezo-amerikane të nënshkruar janarin e kaluar, kampi i pëllumbave, i cili përfshin veçanërisht sekretarin e thesarit Steven Mnuchin, arriti të zbushte zjarrin anti-kinez të Navaros dhe Lighthizerkit. Me përkeqësimin e situatës gjeopolitike dhe krizën e Covid-19 – për të cilën Z. Trump fajëson Kinën – kjo perspektivë po dobësohet. Kështu që Huawei rrezikon të mbetet një mjet negocimi në shkëmbimet që nuk do të ndodhin kurrë.

Ndërkohë, masat hakmarrëse janë duke u shtuar. Në fillim të gushtit, z.Pompeo njoftoi forcimin e programit të Rrjetit të Pastër (Clean Network), i cili synon të pastrojë internetin nga “ndikimi negativ” i Partisë Komuniste Kineze. Disa ditë më vonë, Uashingtoni privoi Huawei nga çdo mundësi e përdorimit të teknologjive direkt ose indirekt me kompanitë amerikane, e cila çon drejt mungesës së prodhimit të produkteve të saj. Sepse pavarësisht shumave kolosale të investuara në punë kërkimore, batalioneve të inxhinierëve dhe apologjive për inovacionin “brenda shtëpisë”, ka komponentë që Huawei nuk mund t’i prodhojë vetë, as t’i marrë në Kinë.

I tillë është rasti me Kirin ultra-modern, të dizajnuar në Kinë, por të gdhendur jashtë vendit, thelbësor në funksionalitetin e bazuar në inteligjencën artificiale (AI). E angazhuar në një garë me Silicon Valley për pesëmbëdhjetë vitet e fundit, Kina ka bërë përparim të konsiderueshëm në këtë fushë, deri në pikën e dominimit të qartë të teknologjive të caktuara, siç është njohja e fytyrës. Sidoqoftë, aseti kryesor i saj deri më tani ka qenë aftësia për të mbledhur masa gjigante të të dhënave për të ushqyer dhe trajnuar algoritmet – një koleksion i kryer nga gjigandët e saj dixhitalë, por gjithashtu i bërë i mundur nga shfrytëzimi i punë së paguar pak, e bërë nga studentët. Por ky model u krijua për botën e mëparshme, një botë ku Kina mund të mbështetej në dërgesat e pandërprera të pajisjeve me performancë të lartë të bëra në Tajvan ose Shtetet e Bashkuara. Sot, përçarja e këtyre zinxhirëve të furnizimit vë në rrezik AI-në kineze si një e tërë. Duke i shpallur luftë Huawei, amerikanët ndoshta po kërkojnë aq shumë për ta parandaluar atë që të ketë gjysmëpërçuesit e vet përmes filialit HiSilicon sesa të frenojë përparimin në 5G.

Edhe në politikën industriale, ka ardhur koha për ofensivën amerikane. Parlamentarët vendosën të rezervojnë fonde për ndërtimin e rrjeteve të cilat mund, në planin afatgjatë,

të zëvendësojnë ato të Huawei dhe konkurrentëve të tij. Në të njëjtën kohë, buxheti i alokuar për prodhuesit amerikanë nën ligjin “CHIPS for America”, aktualisht në diskutim në Kongres, është rritur në 10 miliardë dollarë. Uashingtoni duket se e ka kuptuar që kjo periudhë e tensionit gjeopolitik nuk është koha ideale për të dobësuar lajmëtarët e saj dixhitalë. Përfitimet e Silicon Valley: prej këshillës së shefit të Facebook z.Trump vendosi të sulmonte aplikacionin TikTok.

Në përgjithësi, reagimi i Pekinit ka qenë më pak agresiv. Duhet thënë se Kina nuk e pritë sulmin amerikan për të forcuar sovranitetin e saj teknologjik me miliarda dollarë para publike, edhe nëse, ndërkohë, kriza shëndetësore ka monopolizuar një pjesë të këtyre fondeve (vendosja e 5G, në veçanti, është vonuar). Në maj, menjëherë pasi administrata Trump njoftoi kufizime të reja për Huawei dhe furnizuesit e saj, z.Jinping zbuloi një plan 1.4 trilion dollarë për të siguruar udhëheqjen kineze në disa teknologji kryesore deri në 2025. Dy frazat më të nxehta në Kinë tani janë “de-amerikanizimi” – i zinxhirit të furnizimit dhe infrastrukturës teknologjike – dhe “ekonomia me qarkullim të dyfishtë” – një drejtim i ri i politikës që synon të artikulojë ri-fokusimin në treg vendas dhe zhvillimin e teknologjive të përparuara të përshtatshme për eksport.

Ndërsa diskutimet janë të hapura rreth shitjes së ardhshme nga TikTok të aktiviteteve të tij në SHBA, Pekini ka zgjeruar listën e teknologjive që synon të kontrollojë eksportin, duke përfshirë algoritmet e rekomandimeve të përmbajtjes, njohjen e zërit dhe shumë më tepër aplikacione të tjera të inteligjencës artificiale. Në reagim të programit të Rrjetit të Pastër Amerikan, ai sapo ka njoftuar fillimin e rrjetit të tij ndërkombëtar Global Data Security Initiative, e krijuar për të kundërshtuar mbikëqyrjen dhe spiunazhin Amerikan.

Tani për tani, Huawei po e mban veten. Sapo znj. Wanzhou u arrestua, duke parashikuar sanksione më të ashpra, kompania kishte filluar grumbullimin e stock-ut, i cili mund të zgjasë nga dhjetë muaj deri në dy vjet – por disa pjesë do të jenë të vjetruara deri atëherë. Ajo gjithashtu ka në çantën e saj një varg kontratash të rrjetit 5G. Më në fund, e vetëdijshme që pajisjet e saj së shpejti nuk do të kenë më qasje në azhurnimet e Android, ajo ka vendosur të zhvillojë sistemin e saj operativ: Harmony OS.

Cilido qoftë fati i Huawei në një të ardhme të afërt, mesazhi është marrë plotësisht nga Pekini, Moska dhe kryeqytetet e tjera: Sovraniteti teknologjik është i domosdoshëm. Kina e kuptoi këtë shumë kohë përpara deklaratës së z.Trump për luftë, e cila vetëm rriti më tej ndjenjën e urgjencës. Në mënyrë paradoksale, ishte Uashingtoni që e shtyu Pekinin të vinte në praktikë një nga maksimat e shumta të z.Zhengfei: “Pa pavarësi [teknologjike], nuk ka pavarësi kombëtare. » Ironi do të ishte nëse beteja e Amerikës kundër Huawei do të rezultojë në një Kinë shumë më të përparuar teknologjikisht dhe të vetëmjaftueshme, e cila do të eleminonte plotësisht furnizuesit Amerikanë nga zinxhirët e saj të furnizimit.

* Themelues dhe redaktor i portalit Syllabus (the-cillabus.com). Autori i ‘Për të zgjidhur gjithçka klikoni këtu. Gabimi i zgjidhjeve teknologjike’, botimet FYP, Limoges, 2014.

KOSOVA E SHQIPËRIA MIDIS LIRISË SË SHPREHJES DHE LIRISË SË BESIMIT

Midis identitarizimit të fesë dhe fetarizimit të identitetit

Shoqëritë shqiptare në rajon janë pjesë përbërëse e debateve globale mbi marrëdhënien e religjioneve me shtetin, laicitetin dhe liritë e shprehjes dhe besimit. Si gjetiu, edhe në Kosovë dhe Shqipëri, në inxhinieringun identitar dhe instrumentalizimin politik lidhur me këto tema, stisja vjen në shprehje sa herë që diskutohet për elementin Islam.

NGA SHKODRAN HOTI

Reagimet e shumta kundër Ambasadorit të Republikës së Kosovës në Francë pasi që shpërndau në Twitter një artikull gazete që satirizon profetin Muhamed, prejardhja shqiptare e njërit nga protagonistët e sulmit terrorist në Vjenë, apo edhe debati që ngjalli deklarata e z.Jakup Krasniqit se nuk është “as mysliman as katolik, por shqiptar”, kanë rishfaqur diskutime të shumta në Kosovë dhe Shqipëri, jo rrallëherë edhe jotolerante, mbi marrëdhënien e religjioneve me shtetin, kombin dhe shoqërinë. E tëra në një shoqëri shumëfetare që mburret me një traditë të tolerancës ndërfetare dhe me një histori të mbivendosjes së rëndësishë të përkatësisë kombëtare ndaj atyre fetare. Se çfarë nënkuptojnë sot këto zhvillime të sotme shoqërore, bashkëbiseduam me studiuesin nga Shqipëria, Besnik Sinani; si dhe me sociologun nga Kosova, Ardian Gola.

– Shpërndarja e një artikulli satirizues të profetit Muhamed nga ambasadori i Kosovës në Francë, z.Qëndrim Gashi, pas vrasjes makabre të një mësuesi francez për shkak të një ligjërimi mbi lirinë së shprehjes duke iu referuar karikaturave të botuara nga revista “Charlie Hebdo”, ka ngjallur reagime të shumta ndaj tij deri në kërcënim fizik, duke e ringjallur debatin e njohur midis lirisë së shprehjes dhe “ofendimit të ndjenjave fetare”. Ç’do të thotë për ju reagimi i shoqërisë në Kosovë dhe Shqipëri ndaj postimit të z.Gashi?

Besnik Sinani : Ripostimi prej z. Gashi i karikaturave në fjalë përbën një akt të promovimit të intolerancës dhe paragjytimeve edhe ndaj muslimanëve të vendit të tij, të cilët përbëjnë shumicën e popullsisë. Ai pra ka shkelur mbi funksionin e tij primar, të qenit përfaqësues i denjë i popullit të vet. Në këtë kontekst, reagimi i Bashkësisë Islame të Kosovës, e cila kërkoi që Ministria e Jashtme të distancohej, është korrekt. Fatkeqësisht, kërcënimet online për dhunë fizike ndaj z. Gashi përbëjnë jo vetëm sulme ndaj tij, por edhe polarizojnë debatin publik. Ato vërshtirësojnë ekzistencën e një hapësire të ndërmjetme ku mund të jesh njëkohësisht kundër vrasjes së mësuesit në Francë apo kërcënimeve ndaj z. Gashi, si dhe kundër urrejtjes që përfaqësojnë karikaturat që ata kanë promovuar.



ARDIAN GOLA



Ardian Gola: Unë i kam dilemat e mia lidhur me satirizimin e Charlie Hebdo dhe mungesën brutale të ndjeshmërisë që ajo ka ndaj rrethanave të reja globale ku shoqëri e kultura radikalisht të ndryshme detyrohen të bashkëjetojnë në hapësira gjithnjë e më të ngushta pa kufij. Por, në rastin e ambasadorit Gashi nuk shoh probleme të kësaj natyre. Ai nuk ka shpërndarë satirë, e cila pra është e diskutueshme nga këndvështrimi i ndjeshmërisë multikulturore, por një ngjarje që ka të bëjë me diskutimin e lirisë së shprehjes, pjesë e së cilës madje ka qenë edhe vetë satira e Charlie Hebdo.

Liria e shprehjes sot në Perëndim, për Kosovë mos të flasim, është shndërruar në fetish. Një liri e fetishizuar e humb forcën kritike dhe transformuese të saj. Ajo kthehet kundër vetvetes me pasoja fatale për vetë atë. Prodhon inflacion fjalësh. E fjala e humb peshën e saj, duke u fundosur në valët gjigande të inflacionit që i prodhon

qarkullimi i furishëm i saj. Në këtë mënyrë, liria e fjalës nuk mund t’i qëndrojë besnik rrënjëve historike të saj dhe nuk mund të qëndrojë mbi premtimet iluministe, të cilat e kanë mundësuar atë.

Ç’truallizimi

– Në vazhden e këtij debati, ndodhi edhe sulmi i fundit terrorist në Vjenë, ku pati protagonist me prejardhje nga hapësirat shqiptolëse në Ballkan. Kjo ritkheu edhe diskutimet mbi atë që quhet “radikalizimin islamist” të shoqërive tona i cili sipas kritikëve po e rrezikon imazhin e shqiptarëve në botë. Sa qëndron ky argument?

Besnik Sinani : Në raportet mediatike të gjerëtanishme nuk identifikohet asnjë lidhje operationale apo ideologjike mes autorit të sulmit, Kujtim Fejzullahut, dhe ndonjë grupi apo bashkësie në trevat shqiptare në Ballkan. Siç është e mirënjohur, ai ishte lindur e rritur në Austri. Duke e tepruar në ‘shqiptarizimin’ e problemit, shqiptarët po marrin mbi vete telashe që vende si Austria kanë me qytetarët e vet. Debatet mbi dëmtimin e “imazhit” janë tregues të retorikave të politikave identitare të shqiptarëve, retorika që janë shpesh në natyrën e tyre provinciale. Në të kundërt, sociologë si Olivier Roy ngulin këmbë se bazuar në studimin e rasteve individuale të militantëve në Europë, shohim një profil të spikatur që është esencialisht i dekulturnuar, larg religjiozitetit të familjeve të tyre – kur vinë nga prindër muslimanë – me njohuri të pakta fetare, që përqafojnë forma tipike të kulturës rinore globale. Të dhëna të tilla i bëjnë irrelevant debatet për “turpe kombëtare”.

Ardian Gola: Është e kuptueshme që një imazh ndërkombëtar i Kosovës që asocion me ekstremizma të dhunshëm fetar është i dëmshëm. Megjithatë, dëshmitë rreth historikut jetësor të këtyre terroristëve flasin se ata, përpos emrit që bartin dhe lidhjeve familjare potenciale, asgjë tjetër nuk i lidhë me Kosovën. Ngase janë lindur dhe edukuar në shtetet përkatëse. Ne duhet ta kuptojmë se jeta sociale sot zhvillohet në trajta tërësisht të ç’truallëzuara të komunikimit. Komunikimi i ç’truallëzuar mundësohet përmes teknologjisë, e cila i ka zhbërë të gjitha barrierat hapësinore dhe kohore të komunikimit ndërmjet njerëzve përgjatë globit. Të keni një smartfon në dorën tuaj do të thotë që në dorë ta keni globin me tërë atë çfarë ndodh aty; pra edhe predikimet radikale dhe esktrmiste, qofshin ato të natyrës fetare, sikurse ato islame, qofshin sekulare, sikurse ato të djathtës ekstreme, neonaziste etj. Prandaj, në kuptim të ruajtjes së imazhit të Kosovës, kjo do të thotë që lufta duhet zhvendosur më shumë në planin diplomatik. Ndërsa në kuptim afatgjatë të neutralizimit të efekteve të këtyre ndikimeve digjitale duhet investuar në edukimin etik, estetik, medial dhe kulturor. E kjo duhet të fillohet me reformimin e arsimit.

– Lufta në Siri rekrutoi edhe shtetas të Kosovës, Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë të kombësisë shqiptare, duke ngjallur një debat mbi shkallën e sotme të ekstremizmit me motive fetare në mesin e shqiptarëve. Megjithatë, pas përfundimit të luftërave atje, sikur pati një rënie të ndikimit të rrymave ekstremiste me motive fetare?

Besnik Sinani : Është normale që ngjarje të reja të tërheqin vëmendjen e publikut. Megjithatë, ka aspekte të pjesëmarrjes së

shqiptarëve në luftën në Siri që kërkojnë vëmendjen e mëtejshme të autoriteteve përkatëse, siç është aktiviteti i të kthyerve nga lufta, re-integrimi i tyre në shoqëri, radikalizimi online etj. Por ka edhe problematika të tjera që duhen investiguar mëtej nga mediat dhe shoqëria civile. Për shembull, ka disa indikues që sugjerojnë se autoritetet shtetërore në Kosovë dhe Shqipëri mund të kenë ditur që individë të caktuar ishin nisur për në Siri, dhe i kanë lejuar. Kjo duhet investiguar dhe nëse është e vërtetë, duhet zbuluar arsyet dhe përgjegjësit. Gjithashtu, në Kosovë pati arrestime të disa imamëve të akuzuar se kishin nxitur rekrutimin e luftëtarëve shqiptarë për në Siri. Megjithatë, në statuset e veta në FB apo edhe në një intervistë me të përditshmen Dita në Tiranë, luftëtarë famëkeq i ISIS, Lavdërim Muhaxheri, akuzoi disa prej këtyre imamëve sepse, sipas tij, ata po e pengonin vajtjen e luftëtarëve në Siri. Shumë nga këta imamë u liruan më vonë pa dënim dhe nuk pati asnjë debat publik nëse ishin të pafajshëm, pse u arrestuan, e nëse ishin fajtorë, pse u liruan; ku kishin gabuar organet e sigurisë; a ishte arrestimi një akt i paligjshëm që kërkonte të promovonte artificialisht punën e qeverisë dhe a u shkelën të drejtat ligjore të imamëve? Në Shqipëri u bënë një sërë arrestimesh të bujshme të disa të rinjve muslimanë akuzuar për vendosje bombe në një stadium në një ndeshje me ekipin e Izraelit. Një vit më vonë ata u liruan dhe nuk pati asnjë debat se pse ishin mbajtur një vit të burgosur pa prova inkriminuese kundër tyre?

– Së fundi, reagime pati edhe ndaj deklaratës së z.Jakup Krasniqit në paraqitjen e tij në Dhomat e Specializuara, kur deklaroi se nuk është “as mysliman dhe as katolik, por

shqiptar”, sipas formulës së Pashko Vasës “Feja e shqiptarit është shqiptaria”. Jo pak njerëz e kundërshtuan këtë deklaratë duke thënë se përpos shqiptar, ata ndjehen edhe musliman ose katolik. Si e komentoni?

“Diskutimi për ‘tolerancën fetare’ në ligjërimin publik shqiptar mbart konotacion negativ dhe mirëfilli intolerant” – Besnik Sinani

Besnik Sinani : Z. Krasniqi është akuzuar se gjatë luftës ka kryer krime me motive fetare. Duhet theksuar se, gjatë luftës çlirimtare të popullit multiftetar të Kosovës, roli i tij nuk ishte i përcaktuar në bazë të përkatësisë së tij fetare, por asaj etnike, si shqiptar. Deklarata e tij duhet parë më shumë e lidhur me kundërshtimin e akuzës, sesa si kumtim rreth religjiozitetit të tij. Është tërësisht normale që qytetarë të Kosovës të ndihen njëkohësisht shqiptarë, muslimanë, katolikë, ateistë apo çfarëdolloj varieteti identitar.

Ardian Gola : Çështja e identitetit tek shqiptarët është diskutim shumë i ngarkuar dhe deri diku madje edhe i stisur. E ngarkesa vjen pikërisht për shkak të elementit fetar, i cili pashmangshëm ka qenë pjesë e historikut identitar të shqiptarëve, qoftë si forme proaktive, qoftë si reaksion. Ndërsa stisja vjen në shprehje sa herë që diskutohet për elementin Islam. Në argumentet më të zëshme që e dominojnë debatin aktual rreth identitetit, i cili kryesisht zhvillohet rreth çështjes së sekularizmit, elementi islam në mënyrë implicite shtrohet si i huaj, i cili nuk mund të bashkekzistojë me elementet tjera në të njëjtin shtat identitar të shqiptarëve. Për më tepër, Islami në masë të madhe sot e konstituon “tjetrin”, me të cilin sendërtohet imazhi për shtetin e Kosovës si perëndimor dhe evropian. Nga ana tjetër, maksimumat rilindase për identitetin shqiptar si ajo e Pashko Vasës, më shumë janë përdorur si forma të militantizmit nacionalist antifetar sesa nisma të mira për debat më të zgjeruar shoqëror e politik rreth mbijetesës historike të popullit shqiptar. Kjo ka bërë që sa herë të përmendet Pashko Vasa, ngjallet irritim tek masa muslimane veçanërisht. Ndërkohë që rilindasi në fjalë, në këndvështrimin tim, ka një poentë të fuqishme sociologjike veçse të shprehur me gjuhë poetike. Historikisht, shoqëritë njerëzore, kanë mbijetuar duke krijuar shënjeshtë përbashkët identitare. Kur është në pyetje mbijetesa si kolektiv, njerëzit bashkohen rreth të përbashkëtave duke ia nënëndritur atyre të veçantat. Identiteti nuk është vetëm çështje sentimentit, sado që ky i fundit është resurs shumë i vyeshëm i përdorimit politik të identitetit. Pashko Vasa nuk flet nga sentimentit identitar, ani pse edhe kjo mund të jetë çështja, sa nga brennga e tij për kanosjen që popullit shqiptar i vjen nga mbivendosja e identitetit fetar, cilido qoftë ai, identitetit kombëtar. Pashko Vasa nuk kërkon që të ndihemi më pak si muslimanë ose të krishterë sesa si shqiptarë – pyetje kjo që aq shumë është bërë përgjatë këtyre tri dekadave, e që si e tillë është sa banale aq edhe e pakuptimtë. Ai ka qenë intelektual shumë më i ngritur sesa ta banalizonte çështjen e intensitetit të sentimentit, qoftë atij fetar, qoftë kombëtar. Se si ndihen njerëzit në brendësinë e tyre, është çështje krejtësisht private dhe subjektive. Ai flet për shqiptarinë si një shënjeshtë i përbashkët i një populli që e banon një hemisferë. Vetëm falë këtij shënjeshtë të përbashkët shqiptarët kanë mundur, dhe mund ta parandalojnë, shpërbërjen dhe ta sigurojnë mbijetesën kolektive (cilësimet popull, komb etj. këtu pezullohen) në një mjedis fqinjësh me armiqtë si të hapura.

– Sikurse ndërtimi i Katedrales “Nënë Tereza” në Prishtinë që interpretohej si përpjekje e politikës së kohës për ta krijuar një imazh të rremë “pro-katolik evropian” të Kosovës, edhe ndërtimi i Xhamisë së Madhe në Prishtinë me arkitekturën e përzgjedhur, po komentohet si ndikim i “frymës islamo-erdoganiste” në Kosovë që po e shpërftyron identitetin shqiptar duke i dhënë karakter islamik. Çfarë thonë për ju këto dy debate nga perspektiva sociologjike dhe kulturore?

“Para se ta kritikojmë përzjerjen e fesë në politikë, duhet ta kritikojmë përzjerjen e politikës në fe. Kjo e fundit është duke e mundësuar të parën. Duhet mbrojtur fenë nga politika nëse duam ta ruajmë politikën nga feja” – Ardian Gola

Ardian Gola : Kosova pas luftës ka qenë arenë përplasjesh e agjenturave të ndryshme, si dhe fushëbetëj e lojërave politike e gjeostrategjike, të cilat shquhen edhe për krijimin, sforcimin dhe instrumentalizimin e realiteteve identitare. Arkitekturimi fetar i mjedisve të ekspozueshme të hapësirës publike përmes tempujve të shenjtë është shndërruar në garë të çmendur identitare, e cila i ka pezulluar fesë misionin shpirtëror duke ia theksuar fuqishëm komponentën identitare. Mirëpo, ky identitarizim i fesë është pasuar pashmangshëm me fetarizimin e identitetit. E kjo paraqet vetëm një rën prej shumë elementeve të shfjtyrimit identitar në Kosovë, krahas forcave sekulariste e liberale, të cilat janë në garë për t’i dhënë fizionominë identitare shoqërisë kosovare sipas standardeve të tyre ideologjike. Nga ana tjetër konsumerizmi kulturor, i cili karakterizohet me indiferencë identitare, është po ashtu pjesë e pashkëputshme e këtij mozaiku. Të gjitha këto kanë prodhuar një realitet të tendosur identitar, në raport me të cilin edhe diskursi kombëtar shqiptar e ndien presionin diskursiv të forcave të tjera në lojë. Deshtëm ose nuk deshtëm, triada konfesionale musliman – katolik – ortodokos është në zemrën e identitetit kombëtar shqiptar. Identiteti kombëtar është ky që është fal dinamikave historike dhe rrugëtimit historik të shqiptarëve. Identiteti është histori. E historia e shqiptarëve është edhe histori e bashkekzistencës, herë paqësore e here konfliktuoze, së këtyre feve. Ekuilibri i kësaj bashkekzistence nuk kanoset nga vetë fetë dhe logjikat e tyre teologjikisht përjashtuese, sa nga mënyra e përdorimit politik të tyre. Dhe kur po flas për përdorim politik, nuk po flas për përdorim të fesë për të ndërtuar dhe përligjur kauza ideopolitike, por për përdorim elektorat dhe për eksportim ndërkombëtar të imazhit të Kosovës si vend (pro)perëndimor. Ky inxhiniering identitar nga politika fillon me ish-presidentin Rugova, i cili e përdorte foton e Papës gjatë paraqitjeve të tij publike në zyrat e tij. Një praktikë e tillë ishte indikativ i pastër se leadershipi politik i Kosovës operonte në një klimë të fuqishme (vetë) shantazhi, pasi që Serbia e ka përdorur vazhdimisht kartën e ngjyrosjes islamike të rezistencës shqiptare. Por, ky veprim, sado taktik të ketë qenë, ka prodhuar fustrim tek komuniteti musliman, pasi që Rugova në pozitën presidenciale përfaqësonte edhe ata. Ajo çfarë shohim sot në politizimin e fesë përmes lojërave arkitektonike me tempuj fetarë është vazhdimësi e të njëjtës logjikë politike të trashëguar nga ish-presidenti Rugova. E kjo logjikë e ngulfatë fenë dhe e rrezikon politikën. Prandaj, para se

ta kritikojmë përzjerjen e fesë në politikë, duhet ta kritikojmë përzjerjen e politikës në fe. Kjo e fundit është duke e mundësuar të parën. Duhet mbrojtur fenë nga politika nëse duam ta ruajmë politikën nga feja.

Mungesa e debatit

– Si e komentoni që këto përplasje dhe debate të ashpëra shoqërore me motive fetare, shpesh edhe jotolerante, po ndodhin paralelisht në një shoqëri që vëthemburret me traditë të “tolerancës ndërfetare”?

Besnik Sinani : Diskutimi për “tolerancën fetare” në ligjërimin publik shqiptar mbart konotacion negativ dhe mirëfilli intolerant. Përgjithësisht ai nënkupton se toleranca gjendet tek shprehja e dobët, apo inekzistente e religjiozitetit, apo kur identifikimi me një religjion është dytësor ndaj një identiteti tjetër – mundësisht atij kombëtar. Sipas këtij botëkuptimi, një identitet i fortë fetar nuk mund të jetë kurrë tolerant, edhe pse ka tregues të shumtë historikë për të kundërtën. Debatet mbi fenë mbushin gazetat e televizionet, por ky debat është i cekët, pompuar me dezinformim, i mungon opinioni i mirinformuar, dhe më shumë kërkon të ushqejnë retorikën politike dhe identitare, sesa të edukojë apo informojë publikun. Kjo është shqetësuese, pasi vetëm një publik i mirinformuar mund të përfshihet dhe të mbrojë vlerat demokratike. Tek e fundit, cektësia e debatit mbi fenë është tregues edhe i cektësisë së debatit rreth sekularizmit.

Ardian Gola : Ka një mori arsyesh për këtë. Së pari, vetë shoqëria kosovare sot është mjaftueshëm e polarizuar. Ajo po përshkohet me vlime, tendosje dhe mosdurim të theksuar. Në këtë mjedis, feja nuk mund të bëjë ndonjë përjashtim. Së dyti, ajo që diskutohet për fenë e kam të vështirë ta quaj debat. Ai është improvizim i debatit, sikurse të gjitha debatet tjera dhe sikurse të gjithë sektorët tjerë të shoqërisë. E përbashkëta e Kosovës së pasluftës është improvizimi. E kur është improvizim, aty diskutimi nuk udhëhiqet nga imperativat e arsyes dhe argumentit, por të sipërfaqësishë dhe cektësisë, spektaklit dhe sensacionit. E nuk ka temë më të gatshme për të shpërthyer në mosdurim se feja kur për të diskutohet syfaqësisht dhe nuk diskutohet arsyeshëm dhe me argumente. Syfaqësia ngrit fanatizmin ndërsa spektakli ndez pasionin. Shumë spektakël është bërë duke i dhënë publicitet momenteve nga predikimet e imamëve ultrakonzervatorë. Madje portale të ndryshme kanë siguruar mbijetesë në treg, e disa të tjera janë bërë faktor me ndikim në publik, duke e rritur klikueshmërinë përmes kësaj strategjie të spektaklit. Me këtë qasje pjesëtarë të komunitetit musliman janë ndier si kategori, me të cilën shoqëria ironizon dhe kjo ka prodhuar frustrim. Së treti, ka pasur një të kuptuar të gabuar të sekularizmit, qoftë nga sekularistët qoftë nga politikanët. Në vend se ai të kuptohet thjesht si parim i rregullimit institucional e politik, ku rendi kushtetues nuk përligjet nga feja ndërsa politika është e pavarur nga imperativat religjioze, ai është kontrabanduar si botëkuptim i vetëm legjitimp për jetën shoqërore. Mbrojtësit e sekularizmit institucional e politik shndërrohen në mbrojtës të sekularizmit si botëkuptim duke harruar se sekularizmi si parim nënkupton neutralitetin botëkuptimor të shtetit. Sipas këtij parimi shteti nuk është bartësi të vërtetave botëkuptimore e as nuk duhet të mbajë anë në raport me ndonjë rën prej tyre. Ai duhet ta garantojë drejtën e ekzistencës së botëkuptimeve të ndryshme si dhe konkurrencën e lirë dhe paqësore discursive të tyre në hapësirën publike.

T’thuash se hapësira publike duhet të jetë sekulare është njëjtë si t’thuash hapësira publike duhet të jetë fetare. Pse u dashka të jetë sekulare? Ose pse u dashka të jetë fetare? Pra, është kundërshti polare qe nuk prodhon hapësirë paqësore por hapësirë të



BESNIK SINANI

tensionuar publike. Mveshja e cilësimeve “sekulare” dhe “fetare” që dikush dëshiron t’i bëjë hapësirës publike është e pakuptimtë. Hapësira publike thjesht është. Ajo duhet të jetë! Ajo merr kuptim dhe gjallëri përmes përballjes, diskutimit, negociimit etj. Ndërmjet individëve dhe grupeve të ndryshme shoqërore, te cilat bartin dhe kultivojnë botëkuptime të ndryshme, e nganjëherë edhe diametralisht të kundërta, nga ato botëkuptime që bartin individë dhe grupe tjera shoqërore.

– Sa e kanë ndikuar globalizmi, zhvillimi i teknologjisë, pluralizmi dhe demokratizimi raportin e religjionit dhe kombit/shtetit, në Kosovë dhe Shqipëri?

Besnik Sinani : Teknologjia dhe globalizmi kanë transformuar njëkohësisht politikën dhe fenë, e shqiptarët nuk mund të ishin imunë ndaj këtyre zhvillimeve. Para pak vitesh mendohej se globalizmi dhe teknologjia do shuanin diferencat dalluese të kulturave, ndërkohë që ato sot janë bërë vegla të rëndësishme të një rryme ironikisht anti-globaliste, që kërkon të theksojë dallimet kulturore të rrezikuara nga rendi liberal, globalist!!! Personalisht do shpresoja që fokusimi i diskursit dhe aktivitetit fetar të kishte më shumë karakter lokal, dhe më shumë të adresonte shqetësimet e njerëzve realë në bashkësishtë përkatëse, sesa audiencat dhe kauzat virtuale. Do shpresoja të shihja gjithashtu në diskursin fetar skepticism ndaj overdozës së informacionit online, të cilit shpesh nuk i dihet origjina.

– Atentatet e ndryshme që ndodhin nëpër botë rihapin vazhdimisht debatet mbi demokracitë, laicitetet/shekullarizmat, neutralitetin e shtetit, raportit të religjionit me privaten dhe publikun/shtetëroren, liritë e besimit dhe shprehjes etj. Diskutime që mungojnë në Kosovë dhe Shqipëri, të cilat duken komode me këto zhvillime shoqërore?

Besnik Sinani : Fatkeqësisht, atentatet përdoren për të nxitur mbështetje popullore për agenda politike, të cilat sipas gjithë studimeve të besueshme kanë pak gjasa të parandalojnë atentate të tilla. Vërehet qoftë në Francë apo Austri një fushatë së fundmi për të atakuar shoqata muslimane apo xhami që nuk kanë fare të bëjnë me atentatet në fjalë, dhe për të nxitur mbështetje populiste për retorika përjashtuese të ekstremit të djathtë. Lufta e deklaruar në Austri dhe në Francë kundër “Islamit Politik”, apo ndaj “islamistëve”, është një ogur i keq. Kjo sepse këto terma nuk janë të përcaktuar dhe përdoren në mënyrë abuzuese për të vënë në shenjestër grupe e individë me profile shumë të ndryshme. Për shembull, damkosja si “islamist” është përdorur në ShBA kundër kongresistes amerikane Ilhan Omar, apo dhe kundër ish-asistentes së Hillary Clinton, Uma Abedin. Në Afrikën e Jugut, origjina të Islamit Politik identifikohen me trende aktiviste që kanë nxitur rezistencën ndaj apartheidit, por edhe në përpjekjen për të promovuar një islam që toleron homoseksualizmin. Po këto ditë në Arabinë Saudite u deklarua një gjueti shtrigash kundër këtij “Islami Politik”, me të cilin në Saudi identifikohen figura të opozitës politike që kanë kërkuar kthimin e vendit nga monarki

absolute në monarki parlamentare, pavarësi për gjykatat, dhe pjesëmarrje të publikut në vendimarrje. Shkurt, pra, të qenit “islamist” apo identifikimi me “Islamin Politik” kthehet në një “empty signifier”, apo një shenjeshtë bosh, që mund të përdoret në mënyrë abuzive për të atakuar grupe, bashkësi, apo individë nga më të ndryshmit. Nuk është për t’u habitur se një nga shenjestrat e para të kësaj fushate në Francë ishte një organizatë e shoqërisë civile muslimane që meret me dokumentimin e rasteve të islamofobisë. Duhet thënë, gjithashtu, se vetë qëllimi i deklaruar i grupeve ekstremiste me akte terroriste si ai i Vjenës është pikërisht të shkaktojnë armiqësim dhe marginalizim të muslimanëve në vendet e perëndimit, me shpresë se kjo do shtojë rekrutët për ta. Duke qenë se këto ligjëtime politike në Perëndim shpesh nxiten – në kundërshtim të opinionit dominant të ekspertëve – nga politika elektorale, është në interesin e shoqërive shqiptare që të jenë të kthjellët dhe mos përqafojnë diskurse të tilla toksike dhe irrelevante për kontekstin shqiptar.

Ardian Gola : Debatin publik në Kosovë e dominon në tërësi tematika e aktualitetit politik. Kjo është duke ndodh për një mori arsyesh. Por këtu po e përmendi vetëm një rën. Kjo temë vazhdon të prodhojë gjendje ekstazie tek popullata më shumë se çdo gjë temë tjetër. Televizionet e sapohapura garojnë se kush arrin ta fitojë vëmendjen e shikuesve në “prime time” përmes serive të pafundme të debateve me këto tema. Në to edhe panelistët e ftuar duket se përzgjidhen më shumë për talentin për të prodhuar sensacion e spektakël, sesa mendime racionalisht të argumentuara. Televizionet janë shndërruar në arenat e dikurshme të gladiatorëve, të cilët argëtonin masat me përleshjet fizike duke e kulminuar argëtimin me gjakun e derdhur të tyre. Dhuna fizike e gladiatorëve sot është sublimuar në dhunë verbale të panelistëve, ndonëse edhe ajo fizike nuk përjashtohet, ndërsa kulminimi i ekstazisë arrihet kur përplasia verbalisht e dhunshme degjeneron në banalitet dhe ofendim reciprok. E nuk ka asnjë temë më të përshtatshme për këso spektaklesh sesa aktualiteti politik, protagonistë të së cilës janë politikanët, me të cilët në rrethana normale nuk do të merrej askush. Temat për demokracinë, sekularizmin, lirinë e shprehjes, ideologjinë, ndikimet sociologjike në shoqëri etj. nuk zgjojnë të njëjtin interesim publik.

Unë jam i vetëdijshëm që ekzistojnë platforma të ndryshme diskutimi nëpër media, portale, forume të shoqërisë civile etj. ku autorë, ekspertë, profesionistë etj. përmes shkrimit shprehin qëndrime dhe argumentojnë pikëpamje të ndryshme për çështje të caktuara. Problemi është se ato janë në marginat e ndikimit të opinionit dhe vetëdijes së përgjithshme pasi që jemi duke jetuar në një mjedis shoqëror ku kultura e imazhit audio-vizuel dominon në mënyrë absolute kulturën e leximit. E në kulturën e imazhit nuk ka mendim as qëndrim, por ka vetëm informacion dhe afekcion. E aty ku nuk ka mendim as qëndrim, por vetëm informacion dhe afekcion, nuk ka debat, por improvizim dhe spektakël. Nuk ka mundim intelektual, por ekstazi.

NJË GRINDJE E GJATË INTELEKTUALE

Të nxirret nga hija gruaja parahistorike

Po sikur paraardhëset tona femërore ta kishin pikturuar Lascaux, të kishin gjuajtur buajë, të kishin gdhendur vegla pune... Duke e kopjuar modelin patriarkal të shekullit XIX dhe rendin e tij hyjnor në objektin e tyre studimor, parahistorianët e parë ndërtuan mite që inferiorizuan gratë. Qasja shkencore shpie në distancime nga këto presupozime, ashtu që të rishikohet roli i "seksit të dytë" në evolucionin njerëzor.

NGA MARYLÈNE PATOU-MATHIS

A snjë argument arkeologjik nuk e vërteton hipotezën se gratë kishin një status shoqëror më të ulët se burrat gjatë periudhës paleolitike. Duke u mbështetur në bollëkun e imazheve femërore, arkeologët madje sugjerojnë se duke qenë në qendër të besimeve, ato e kishin një pozitë të lartë në këto shoqëri. Ky mendim duket se vërtetohet për të paktën disa prej tyre, por a ishte kjo e vetmja arsye? Studiuesit e tjerë argumentojnë se në ato kohëra të largëta, shoqëritë ishin matrilineale, madje edhe matriarkale.

Ekziston shpesh një konfuzion midis një shoqërie matriarkale, në të cilën gratë mbajnë autoritetin shoqëror e ligjor dhe një shoqërie matrilineale, si sistem farefisnor i bazuar në lidhjen familjare përmes nënës. Termi “matriarkat” nënkupton dominimin femëror, siç tregon etimologjia e saj (nga greqishtja “*ἄρχειν*”: “të udhëheqesh”, “të komandosht”). Nëse një hierarki e bazuar në femëroren dominuese dhe pasardhësit e saj janë vërejtur te disa specie shtazore, veçanërisht te kushërinjtë tanë të afërt bonobosa dhe nëse Na-të, popull me origjinë tibetiane nga luginat e largëta të Yunnan-it në Kinë, ishin ende shoqëri matriarkale në vitet 1990, matriarkati tanimë është zhdukur.

Nga ana tjetër, shumë shoqëri, në të gjitha kontinentet, kanë qenë matrilineale dhe disa janë ende të tilla. Duke konstatuar se që nga laskhtësia, burrat kanë në shumicën e civilizimeve një fuqi ekonomike dhe shoqërore më të lartë se ato të grave, shumë autorë pohojnë se ishte e njëjta gjë qysh nga origjina e njerëzimit. Ata e hedhin poshtë tezën, të mbrojtur nga disa shkencëtarë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, të ekzistencës së një matriarkati para patriarkatit. Prania e saj në shoqëritë parahistorike, temë debati për më shumë se një shekull e gjysmë, është ende ashpër pjesë debati. Për shumë autorë, “matriarkati nga origjinat e njerëzimit” është vetëm mit, për të tjerët do të kishte ekzistuar deri në shfaqjen e patriarkatit gjatë Neolitit.

Matriarkati fillestar

Për shkak të jetës brenda klanit, duke mos qenë në gjendje të dinte me siguri se kush ishte babai i një fëmije, transmetimi i farefisnisë mund të bëhej vetëm përmes nënës. Për antropologun polak Bronisław Malinowski (1884-1942) dhe juristin zviceran Johann Bachofen (1815-1887), ky filiacion matrilineal ishte i pranishëm në shoqëritë para-njerëzore. Qysh në vitin 1861, Bachofen, duke u mbështetur në mitet antike dhe në tregimet e udhëtimeve, në veçanti ato të Atit Jezuit Joseph François Lafitau (1681-1746), një misionar në Nouvelle-France (Kanada), sugjeronte se “epoka primitive” është epoka e “gjinokracisë” përmes të drejtës amnore. Juristi pohon se gratë kanë përdorur “misterin” e amësisë për ta organizuar fisin, rreth kultit të “Hyjneshës së Madhe” dhe transmetimit të pushtetit nga nëna tek vajza.

Ekzistenca e një matriarkati primitiv, ose të paktën e një barazie shoqërore midis burrave dhe grave, u mbështet nga disa

antropologë dhe filozof të fundshekullit XIX. Sipas tyre burrat morën pushtetin dhe vendosen patrilinealitetin dhe më pas patriarkatin në momentin e kalimit nga ekonomia e grabitjes (gjahtambledhësit) në atë të prodhimit (agropastoralistët). Kjo tezë, e cila vazhdoi në fillim të shekullit XX midis disa antropologëve, u rimor në vitet 1930. Strukturat shoqërore të shoqërive parahistorike do të kishin ndryshuar me kalimin e kohës

E bazuar në disa pasaktësi, kjo skemë lineare evolucionare e propozuar nga arkeologu rus Piotr Efimenko tani është krejtësisht e braktisur. Pothuajse tridhjetë vjet më vonë, Marija Gimbutas, specialiste e kohës së bronzit (-2200 deri në -800) i përshkruan shoqëritë para-indo-evropiane si “matristike” (matrilineale). Ato do të kishin zgjatur për rreth 27000 vjet para se të zëvendësoheshin gradualisht me ardhjen (3000 vjet para kohës sonë) të fiseve nomade nga stepat e Azisë Qendrore. Qytetërimet mesdhetare të njohura si “hipogumë”, të karakterizuar nga varrosja e të vdekurve në shpella artificiale të hapura në shkëmb, do të kishin pasur gjithashtu këtë lloj organizimi matrilineale dhe do ta kishin pësuar të njëjtin fat rreth 3500 vjet para kohës sonë. Fiset e kalorësve do t’u kishin imponuar popullatave autoktone matrilineale një sistem patriarkal dhe luftarak. Kjo tezë kontestohet në veçanti për shkak se janë gjetur armë dhe gjurmë të fortifikimeve, të cilat datojnë shumë para ardhjes së këtyre fiseve dhe zgjerimi i tyre do të kishte qenë kryesisht paqësor.

Në vitet 1980-1990, disa historianë amerikanë pohojnë gjithashtu se kulturat parahistorike ishin matrilineale, por edhe më barazitare, më paqësore dhe më pak hierarkike se shoqëritë patriarkale, gjë që disa studiues e hedhin poshtë. Për shumicën prej tyre, përshkrimet e shoqërive matriarkale nuk do të ishin asgjë më shumë se “ndërtime mitologjike shkencore” që i përkasin romantizmit të një “kohe të artë” të zhdukur, ku nuk ekzistonte dominimi i një seksi mbi tjetrin. “Gjinokracia” e Bachofen ishte “fantazi” sipas Emmanuel Todd, për të cilin “statusi i grave është në fakt më i lartë në sistemet farefisnore të padiferencuara, se në shoqëritë matrilineare”. Matriarkati fillestar do të ishte pra vetëm një mit!

Mbrojtësit e saj mbështeten në argumente etnografike, sikurse kundërshtarët e saj, të cilët citojnë disa shembuj të shoqërive tradicionale të cilat ishin për barazi ekonomike dhe sociale, por jo edhe për barazi në marrëdhëniet gjinore. Sidoqoftë, megjithëse ishin dukshëm më pak të shumta, nuk mund të mohohet që kishte shoqëri në të cilat marrëdhëniet gjinore ishin të ekuilibruara (midis San-ve të Afrikës së Jugut, për shembull).

“Matriarkati nuk ka ekzistuar kurrë!”. E lexuar në numrin e nëntorit 1992 të revistës “L’Histoire”, kjo formulë koncize vë në pikëpyetje arsyet e refuzimit të shumë studiuesve për ta konsideruar hipotezën se dominimi i mashkullit, sistemi patriarkal, nuk është fillestar, porse ai ishte vendosur gradualisht pas ndryshimeve, ndoshta të një natyre ekonomike, që ndryshoi strukturën shoqërore të bashkësive



nomade të gjuetarë-mbledhësve. Akumulimi i të mirave – pothuajse inekzistent në shoqëritë paleolitike – i favorizuar nga jeta sedentare dhe zbutja e bimëve dhe kafshëve, kishte çuar në shfaqjen e një aktiviteti të ri, atë të mbrojtjes së tyre, detyrë që do t’i binte njerëzve, gjoja fizikisht më të fortë. Të bërë ngadalë mbajtës të të korrave dhe tufave, thuhet se burrat kanë krijuar filiacionin patrilineal në mënyrë që ta sigurojnë transmetimin e tij tek fëmijët e tyre. “Marrja dhe kontrolli i fëmijëve i fituar nga përgjithësimi i të drejtës atërore do të ketë lindur në shoqëritë e organizuara në mënyrë sociale”, sipas tezës së Claude Lévi-Strauss mbi Strukturat elementare të prindërimit (1949). Ky zëvendësim i filiacionit do të ketë çuar, në planin afatgjatë, në shfaqjen e sistemit patriarkal. Prandaj është shumë e mundshme që ndryshimet ekonomike dhe sociale, të vëzhguara në periudhën neolitike modifikuan thellësisht marrëdhëniet midis burrave dhe grave. Ata padyshim do ta shënonin fillimin e kohës patriarkale, siç shkruan filozofja Olivia Gazalé: “I pari që e ka përmbytur rendin seksual nuk është gruaja, por burri, kur ai i dha fund botës së përzier – ku të drejtat dhe liritë e grave ishin shumë më të gjera dhe ku gruaja respektohej dhe hyjnizohej – për ta ndërtuar një botë të re, botën viriarkale [bazuar në virilitetin], në të cilën gruaja do të ishte inferiore dhe mbyllur dhe ku do t’i humbte të gjitha fuqitë e saj. Në agimin e këtij civilizimi të ri fillon rrëfimi i madh i epërsisë mashkullore i cili do të vinte për të konsoliduar, shekull pas shekulli, mitologjinë (me imazh dhe simbol), metafizikën (me koncept), fenë (nga ligji hyjnor) dhe shkencën (nga fiziologjia)”.

Shfaqja e elitës luftëtare

Qysh në vitin 1884, Friedrich Engels identifikoi zëvendësimin gradual të lidhjes farefisnore nga nëna me atë të babait, si një nga shkaqet e nënshtrimit të grave. Për të, përmbysjë e të drejtës amnore ishte “humbja e madhe historike e seksit femëror”. Më shumë se 120 vjet më vonë, Emmanuel Todd nënvizon po ashtu se nëse parimi patrilineal favorizonte

zhvillimin e formave komplekse familjare që do të ishin përhapur më pas në pothuajse gjithë Euroazinë (që nënkupton se atje më parë do të kishte një parim tjetër), kishte në anën tjetër ulje të statusit të grave, dhe si pasojë një rol më i vogël për nënat në transmetimin kulturor. Kështu, regjimet matriarkale duke qenë të rralla – si matrilineale ashtu edhe matrilokale (në të cilën “burri” vjen për të jetuar në familjen e “gruas” së tij) – mund të shpjegohen nga dominimi universal të burrit. Nënshtrimi i grave, që është një formë e dhunës, thuhet se është pasojë e ndarjes gjinore të punës.

Në shoqëritë paleolitike, duke bërë dhe duke rritur fëmijët e tyre të vegjël, gratë kishin një funksion kryesor në qëndrueshmërinë e klanit. Meqenëse ishte e pamundur të njihje me siguri babai i vërtetë i të porsalindurit, prejardhja matrilineale duket më shumë se e mundshme. Duke marrë pjesë në një numër të madh aktiviteteve, ata kishin një rol të vërtetë ekonomik dhe kishin një status shoqëror ndoshta të barasvlefshëm me atë të burrave, ose madje, ndoshta, më të lartë brenda sferës së brendshme dhe simbolike, në funksion të vendit qendror që zënë përfaqësime femërore në artin paleolitik. Përderisa ishte e arsyeshme të besojmë se në këto shoqëri, marrëdhëniet midis gjinive ishin të ekuilibruara, ne aktualisht nuk kemi asnjë të dhënë që do të na lejonte të konkludonim ekzistencën e shoqërive matriarkale, të dominuara në mënyrë implicite nga gratë... ose patriarkale. Është e mundur që zëvendësimi gradual i lidhjes farefisnore nga nëna në lidhjen farefisnore e babait të ketë ndodhur gjatë neolitit, por jo kudo, pasi shoqëritë matrilineale ende ekzistojnë në rajone të caktuara të botës.

Krejt në fillim të neolitit, organizimi socio-ekonomik i shoqërive të para bujqësore duket se zhvillohet me gratë. Si fermere, thuhet se ato kanë zbutur bimët dhe veglat bujqësore, duke përfshirë shatat dhe rrotat bluarëse. Një ndryshim në organizimin shoqëror shfaqet rreth 6000 vjet para erës sonë, një periudhë e shënuar nga një shpërthim demografik lokal i lidhur me një bollëk ushqimësh

(dëshmuar nga prania e depove të shumta të drithërave) dhe një zgjerim i sedentarizimit (pamja të fshatrave të parë). Me zhvillimin e blegtorisë dhe zotërimin e teknikave të reja bujqësore, burrat gradualisht kanë zëvendësuar gratë në punën që lidhet me bujqësinë.

Shfrytëzimi i kafshëve për lesh ose qumësht ka nxitur më shumë mbylljen e grave në hapësirën shtëpiake. Me rritjen e të mirave (arrë e kullotë, blegtori, rezerva ushqimore), ato kanë marrë një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në komunitete. Këto ndryshime do të kishin riformuar marrëdhëniet shoqërore, duke i shfaqur elitat dhe kastat, përfshirë atë të luftëtarëve dhe do të rezultonin në një ndarje më të theksuar gjinore të detyrave, si dhe një përgjithësim të vendbanimit patrilokal [gruaja jeton në familjen e “burrit” të saj. »] dhe lidhja familjare patrilineale.

Këto transformime, të cilat tronditin vendin e grave në shoqëri, vërehen prej 5000 vjet para kohës sonë në përbërjen e mobiljeve funerare (më gjinore dhe më pak të larmishme në varret femërore) dhe gjendjen e skeleteve femërore të zbuluar. Shihet një rritje jo vetëm e patologjive të lidhura me punët e rënda, bartjen e peshave të rënda dhe shtatzënitë e përsëritura, por edhe me mungesa vitaminash për shkak të ushqimit më pak proteina (bazuar kryesisht në ushqime me bazë niseshte dhe bimë, të vërtetuara nga një numër më i lartë i kariesit) dhe traumave për shkak të dhunës. Por ky nuk është rasti për të gjitha gratë. Në disa varre, të vdekurat janë zbuluar dhe paraqesin pak patologji dhe trauma. Situata e grave gjatë kësaj periudhe duket se ndryshon varësisht nga pozicioni i tyre shoqëror.

Për më shumë se një shekull e gjysmë, interpretimet që janë bërë për mbetjet arkeologjike kanë kontribuar shumë për t’i bërë gratë prarahistorike të padukshme, veçanërisht duke ia ulur rëndësinë e tyre në ekonomi. Zbulimet e reja hedhin një vështrim të ri, atë që roli i grave në evolucion është po aq i rëndësishëm sa i burrave.

NË LIBAN, NË VENDIN E KOMUNITARIZMIT, KLIENTALIZMIT DHE PABARAZIVE

Libani, prej dy shekujsh në kërkim të kombit

E sprovuar nga kriza e Covid-19 dhe nga vështirësitë ekonomike, popullsia libaneze po vuan varfërim të përkeqësuar nga zhvlerësimi i paundit. Të varur nga ruajtja e një shteti të dobët për t'i siguruar privilegjet e tyre, udhëheqësit politikë nuk kanë qenë në gjendje ta reformojnë vendin, pavarësisht zemërimit për shpërthimin e dyfishtë të portit të Bejrutit më 4 gusht.

NGA GEORGES CORM*

Që nga shekulli XIX, Libani nuk ka pushuar së ballafaquari me ndërrhyrjen nga fuqitë e mëdha, duke i dhënë sovranitetit zyrtar statusin tragjik të një “zone tampon” (zonë ose shtet i vendosur midis dy ose me shumë superfuqish riale). Në 1833, vendi u pushtua nga trupat e Ibrahim Pashait, birit të Mohamed Aliut të fuqishëm (ose Mehmet Ali), nënmbret i Egjiptit, i shpallur kundërshtar i sulltanit Osman. Por britanikët bënë një sy qorr dhe përfunduan duke e detyruar Francën, të cilën sovranin egjiptian e admironte dhe e kishte aleate, të ushtronte presion mbi të, që të urdhëronte djalin e tij të tërhiqte trupat nga malet libaneze në 1840. Grupimi i pesë fuqive koloniale (Franca, Italia, Prusia, Austria, Anglia) atëherë konsideroi se ambiciet e Mohammed Aliut për të përmbysur monarkinë osmane dhe për ta zëvendësuar atë nuk ishin të pranueshme.

Në këtë kontekst lufimesh për influencë midis fuqive të mëdha evropiane mbi të ardhmen e Perandorisë Osmane, të përshkruar si një “njeri i sëmurë” nga diplomacia ruse, shpërthyen shumë telashe të përgjakshme midis fshatarëve maronitë dhe druzë, për herë të parë në historinë e malit libanez. Këto përplasje janë vetëm pasoja e drejtpërdrejtë e rivalitetit franko-britanik imperialist i cili përqendrohet në këtë territor duke shkatërruar, me manovrat dhe manipulimet e tij, simbiozën e madhe shekullore që ekzistonte në rajonin Chouf midis dy komuniteteve Druze dhe Maronite. Nga kjo « bashkëjetesë » kishte dalë në të kaluarën figura e madhe e Fakhreddine II i cili mbretëroi mbi Emiratin e Malit nga 1590 deri në 1635. Duke kërkuar të emancipohet nga tutela osmane, në veçanti thurja e marrëdhënieve me Toscanën italiane, emirit iu desh të përballej me disa fushata ushtarake të udhëhequra nga trupat e Portës së Lartë. I kapur nga osmanët, ai u ekzekutua duke i'u prerë koka në Kostandinopojë (Stambolli i sotëm).

Në 1860, përplasjet midis Druzëve, të mbështetur nga ushtria osmane, dhe të krishterëve u përkeqësuan dhe u përhapën në fushën e Békaa-s. Franca, atëherë nën sundimin e Napoleonit III, vendosi të ndërhyjë dhe trupat e saj zbarkojnë në bregdetin libanez. Pesë fuqitë evropiane dhe Perandoria Osmane bien dakord për të zvogëluar sipërfaqen e Libanit. Për të kundërshtuar këtë “Liban të Vogël” autoritetet franceze shpallën “Libanin e Madh” në 1 Shtator 1920. Duke mbuluar një sipërfaqe prej 10,452 km², ky vend nuk do të pushojë së parë fatin e tij të lidhur me rivalitetet evropiane imperialiste apo edhe “perëndimore” nëse përfshijmë Shtetet e Bashkuara, të cilat u bënë fuqia dominuese në “botën e lirë” pas Luftës së Dytë Botërore, e cila në mënyrë efektive mobilizoi tre fetë monoteiste për t'u përballur me fuqinë e Bashkimit Sovjetik.

Duhet të rikujtojmë, kalimthi, se ishte gjatë periudhës së mandatit francez (1920-1943) kur një dekret i Komisionerit të Lartë më 1936 themeloi komunitarizmin institucional. Ai vendos në rendin publik libanez komunitetet fetare, duke shtuar se do të krijohet një komunitet i ligjit të përbashkët për ata libanezë që nuk e identifikonin veten me komunitetet tashmë presente. Ky status civil ende nuk është krijuar. Kjo gjë po detyron shumë libaneze dhe libanezë të shkojnë në Qipro, Turqi ose Francë sot për t'u martuar jashtë komunitetit të tyre.

Si një shtet tampon, i ekspozuar ndaj ndikimeve shpesh antagoniste, Libani gjithmonë e ka pasur të vështirë të përcaktojë vetveten dhe

të kapërcejë kontradiktat. Në 1949, Georges Naccache (1904-1972), një nga gazetarët më të njohur libanezë dhe themelues, më 1925, i së përditshmes L'Orient (tani L'Orient-le jour) botoi një editorial kumbues që e çoi në burg. “As Perëndimi as Arabizimi”: me një refuzim të dyfishtë u bë e mundur që krishterimi dhe Islami të përfundonin aleancën e tyre [për të miratuar paktin kombëtar të nëntorit 1943, i cili shërbeu si një kompromis i pashkruar midis komuniteteve]. Çfarë lloj uniteti mund të nxirret nga një formulë e tillë? pyeste ai i çuditur. Atë që nuk e duan gjysma e libanezëve, mund ta shohim shumë mirë. Atë që gjysma tjetër nuk dëshiron, mund ta shohim shumë mirë. Por ajo që duan të dy gjysmat e përbashkëta është ajo që ne nuk shohim. (...) Një shtet nuk është shuma e dy impotencave – dhe dy mome hime nuk do të bëjnë kurrë një komb.”

“Gjenocidi arkitektuaror”

Më vonë, Georges Naccache do të bëhej një admirues i madh i Gjeneralit Fouad Chéhab (1902-1973), Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë Libaneze, atëherë President i Republikës Libaneze midis 1958 dhe 1964. Ai ishte themeluesi i vërtetë i Shtetit Liban, duke ndërmarrë një numër mbreslënës të reformave me këshillat e Louis-Joseph Lebret (1897–1966), prifti dominikan, ekonomist dhe themelues i Institutit Ndërkombëtar për Kërkim dhe Trajnim, Edukim dhe Zhvillim (Irfed). Person të cilit ai kërkoji të drejtojë, mes 1960 dhe 1964, një studim socio-ekonomik mbi standardet e jetesës në rajone të ndryshme në Liban. Rezultati ishte një sondazh shumë shterues që demonstroi një nivel të pabarazive sociale shumë të madh, një përqendrim masiv të pasurive midis një pakice të vogël libaneze, në kontrast me ekzistencën e xhepave bosh në rajonet periferike rurale të vendit.

Në një konferencë me titull “Libani në kthesë”, mbajtur në 1962, ekonomisti nxiti libanezët duke bërë thirrje për këmbëngulje kundër pabarazive të tilla që mund të bënin që vendi i tyre të shkatërohet. Kjo zhvendosje ndodhi në të vërtetë nga viti 1975 brenda kornizës së një ndezjeje të përgjithësuar të dhunës midis partive politike “të krishtera”, veçanërisht partia Phalangist e krijuar nga Pierre Gemayel dhe “Lëvizja Kombëtare Libaneze”, një grupim i partive jo-komunitare me në krye Kamal Joumblatt (1917-1977), udhëheqës i komunitetit Druze. Ai kërkoji barazi më të madhe midis të krishterëve dhe myslimanëve, këto të fundit mbështeteshin nga lëvizjet e armatosura palestineze në Liban.

Fouad Chéhab shpesh u referohej atyre që ai i quante “prodhuesit e djathit” – me fjalë të tjera, politikanët e paskrupull që po përpiqeshin të vendosnin rregull në shtet. Në planin ndërkombëtar, presidenti ndërton politikën e tij të jashtme duke vendosur marrëdhënie të mira me Presidentin egjiptian Gamel Abdel Nasser. Kjo vetëm mundi të përkeqësonte zemërimin e borgjezisë biznesmene të krishterë, e cila shihte në kryetarin pan-arabist dhe socialist, mishërimin e djallit. Përballë vrullit të reformave dhe dëshirës presidenciale për të ndërtuar një shtet të fortë, mendimi i qarqeve konservatore të krishtera u përmbledh në një parullë shumë të pandjeshme, sipas së cilës “forca e Libanit qëndron në dobësinë e tij”. Nga ana e saj, borgjezia muslimane kërkoi më shumë të drejta në republikën e re të pavarur dhe në përgjithësi mbështeti lëvizjet e armatosura palestineze për të bërë presion ndaj borgjezisë së

krishterë. Kjo e fundit ishte zhvilluar në Liban falë kësaj dobësie, por edhe për faktin se një pjesë e konsiderueshme e këtyre “fedainëve” ishin dëbuar nga Jordania në shtator 1970.

Një tjetër bashkëkohës i Fouad Chéhab meriton të përmendet për saktësinë e pikëpamjeve të tij. Ky është Michel Chiha (1891-1954), i cili ishte një bankier dhe kampion i liberalizmit ekonomik. Por ai ishte një mbrojtës i vendosur i diversitetit të komunitetit dhe paralajmëroi herët në lidhje me rreziqet që kishte Libani si rezultat i politikave izraelite si ndaj vendit të tij ashtu edhe ndaj palestinezëve. Koleksioni i tij i artikujve mbi Palestinën mbetet një kryevepër e kthjelltësisë. Chiha në fakt do ta ketë perceptuar shumë mirë konfliktin ekzistencial midis Izraelit të ndërtuar mbi ekskluzivitetin komunitar dhe Libanit, përkundrazi, të ndërtuar mbi menaxhimin e pluralizmit të butë.

Megjithatë, në disa qarqe mjaft marginale maronite, lindi ideja që nëse hebrejtë në Palestinë kishin shtetin e tyre, pse të krishterët të mos kishin të tyrin? Të krishterët dhe hebrejtë, duke qenë në pakicë, pse nuk duhet të bashkohen kundër shumicës myslimane? Një këndvështrim i tillë i bëri jehonë, pa e ditur as vetë, një literature të tërë izraelite që mbronte destabilizimin e Libanit dhe nevojën për të sjellë një ndarje të vendit midis të krishterëve dhe myslimanëve. Ne e dimë se çfarë ndodhi më pas, së pari dorëvënja e Izraelit mbi një pjesë të Libanit jugor në 1978, pastaj pushtimi i verës së vitit 1982 i cili solli ushtrinë izraelite në Bejrut ku u kryen masakrat e civilëve palestinezë në kampet Sabra dhe Chatila nga milicët Phalangistë nën syrin e bashkëpunëtorëve të ushtarëve izraelitë. Bashir Gemayel, djali i liderit të partisë Phalangiste Pierre Gemayel, u zgjodh president nga parlamenti libanez i rrethuar nga tanket izraelite. Ai u vra disa ditë më vonë në shpërthimin misterioz që shkatërroi selinë e partisë së tij. Do të ishte vëllai i tij Amin Gemayel ai që do ta pasojë atë dhe do të kryejë bombardimet në rrethinat jugore të Bejrutit, të dominuara nga Shiitët. Pikërisht në këtë kontekst kaotik evakuimi i luftëtarëve palestinezë do të kryhet nën kontrollin e një force ndërhyrjeje shumëkombëshe. Kjo e fundit do të jetë viktimitë e disa sulmeve terroriste.

Fundi i ciklit të luftimeve ndërkomunitare në 1990 nuk do ta shërojë Libanin nga dobësitë e tij fillestare dhe nga paafërsia për të ndërtuar një shtet të denjë për këtë emër. Më keq, ardhja në pushtet e Kryeministrit Rafic Hariri në 1992, një biznesmen i mbështetur nga Mbreti i Arabisë Saudite – në detyrë deri në disa muaj para vdekjes së tij në një sulm në 2005 – do ta sjellë vendin në një regjim ekonomik më rentier, sikur të kishte burime kryesore.

Marrëveshjet e tregtisë së lirë u nënshkruan me një numër të madh vendesh duke shkaktuar pasoja negative në prodhimin, aftësitë industriale dhe bujqësore të vendit. Një regjim fiks i kursit të këmbimit që lidh paundin libanez me dollarin dhe nivele anormalisht të larta të normave të interesit në bonot e thesarit të monedhës vendase çuan shpejt në një ndërtim jo të shëndetshëm të borxhit në atë monedhë. Mbi të gjitha, kjo lehtësoi pasurimin e shpejtë të klasës së pasur të vendit, e cila hyri në borxhe në dollarë duke përfutur nga normat e ulëta të interesit dhe më pas duke bërë investime me rendimente shumë të larta në paund libanezë.

Gjatë kësaj periudhe, banorët e pjesëve më të bukura të kryeqytetit u zhvendosën nga shtëpitë e tyre për përfitimin e ndërmarrjes



MANSOUR EL HABRE. — « REPUBLICAÉ », 2012 LIBAN

Solidere, e cila shndërroi qendrën e qytetit në një kopje vulgare të qyteteve prej qelqi dhe çeliku të Gjirit. Në pesëmbëdhjetë vjet, Bejrut, tashmë i shkatërruar nga kaq vite luftë, pësoi një gjenocid të vërtetë arkitektuaror, siç dëshmohej nga ndërtimi i një xhamie të madhe në stilin turk duke prishur bukurinë arkitekturore të ish-Place des Martyrs, i njohur gjithashtu si Sheshi i Topave.

Një elitë e mbyllur në fluskën e saj

Menaxhimi “Haririan” i ekonomisë libaneze ishte drejtpërdrejtë përgjegjës për dobësimin e saj. Megjithatë mesatarisht 6-7%, rritja kurrë nuk ka arritur nivele në përputhje me një periudhë të rindërtimit të pasluftës. Dhe qeveria i kushtoi pak vëmendje drejtësisë tatimore, normat e tatimit mbi të ardhurat u ulën në mënyrë tronditëse në një maksimum prej 10%, pavarësisht nga situata që kërkonte një taksë të veçantë për pasuritë e mëdha të bëra gjatë luftës. Ndërsa sektori i pronësisë përparoi, ai shumë shpejt u përball me vështirësi financiare, me kursimet e libanezëve që nxiteshin nga normat e larta të interesit në depozitat bankare ose letrat me vlerë të borxhit publik. Gjatë periudhës Hariri shumë të rinj të aftë u larguan nga vendi, ndërsa të tjerët ishin në gjendje të ndiqnin arsimin e lartë në Evropë ose Shtetet e Bashkuara në sajë të një programi me mijëra bursa për studentët. Një e papritur e cila shpjegon pse Rafic Hariri dhe djali i tij Saad mbeten të njohur nga një pjesë e popullsisë.

Megjithatë, sot, ekonomia libaneze rrezikon të copëtohet. Ngrija de facto e depozitave bankare, një masë krejtësisht antikushetuese, dëshmon për ekzistencën e një regjimi “bankokracie” unike në botë dhe plotësisht në kundërshtim me të drejtat e njeriut. Ishte rezultat i një menaxhimi të zymtë të sektorit bankar dhe të bankës qendrore libaneze të drejtuar nga i njëjti guvernator për gati 30 vjet, z. Riad Salame që ishte emëruar në 1 gusht 1993, me vendim të Rafiq Hariri, për të cilin ai menaxhoi pasurinë në bankën tregtare Merrill Lynch. Sot, zhvlerësimi i paundit libanez dhe shtimi i kurseve të këmbimit kanë shkatërruar një pjesë

të madhe të klasës së mesme dhe kanë shtyrë në shkallën e varfërisë mbi 50% të popullsisë. Ekzistojnë rreziqe të mëdha të uljes së jetëgjatësisë në Liban.

Sa i përket kastës politike që administron vendin, përfshihet pa ndërprerje në manovrat komunitare. Ajo jeton e mbyllur në një fluskë sikur ekonomia vazhdon të funksionojë normalisht, duke harruar ekzistencën e një populli të vuajtur. Nga ana tjetër, me siguri nuk janë kërkesat e reformës së Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) që do të jenë në gjendje të pastrojnë dhe rigjallërojnë aktivitetin ekonomik. Një seri privatizimesh të ndërmarrjeve shtetërore dhe shitjeve të pasurive të tokës shtetërore janë planifikuar tashmë. Të gjitha këtyre fatkeqësive iu shtua shpërthimi gjigand i dyfishtë i 4 gushtit të kaluar, i cili shkatërroi rrethet lindore të kryeqytetit. Asnjëherë Libani nuk ka pësuar një katastrofë të një madhësie të tillë.

Në këtë kontekst, vendi ka nevojë për reforme, më urgjentja prej të cilave sot ka të bëjë me nevojën për të racionalizuar shpenzimet buxhetore, të fryra artificialisht nga subvencione të shumta, për të menaxhuar më mirë pasuritë e tokës të shtetit dhe bashkësive lokale, të vendosë një taksë të unifikuar të të ardhurave në vend të taksave të ndryshme, si dhe një taksë mbi pasuritë e mëdha, për të ruajtur fuqinë blerëse të pensione. Por gjithashtu dhe mbi të gjitha për të mbështetur sektorët prodhues të ekonomisë, për t'i dhënë fund inflacionit galopant dhe për të mbështetur klasat më të varfra të popullsisë duke rritur ndihmën sociale. Së fundmi, një masë e konsiderueshme kursimesh do të konsistonte në mbylljen e fondeve të ndryshme të pavarura të kompensimit që nuk kanë më një arsye për të ekzistuar, siç është ajo për personat e zhvendosur nga lufta 1975-1990 ose ajo kushtuar personave të zhvendosur nga Libani i Jugut pas pushtimit izraelit të vitit 1982.

* Profesor universiteti, ish-ministër i financave në Liban, autor i librit ‘Libani Bashkohor. Historia dhe shoqëria’, La Découverte, Paris, 2012.

NË LIBAN, NË VENDIN E KOMUNITARIZMIT, KLIENTALIZMIT DHE PABARAZIVE

« Le të rrëzohet regjimi i bankave »

NGA E DËRGUARA JONË SPECIALE DOHA CHAMS*

Një turmë e vogël u mbledh në trotuarin përballë Spitalit Universitar Amerikan (AUB). Fytyrat janë të ngrysur, të zverdhura ose të shqetësuara. Një ditë më parë, ose më herët në mëngjes, 1500 punonjës të AUB mësuan për largimin e tyre nga puna “për shkak të krizës ekonomike”, siç u tha atyre. Në total, 20-25% e fuqisë punëtore të institucionit është e prekur. Sindikatat denoncojnë “një masakër”.

Një grua në rreth të pesëdhjetat del nga ndërtesa dhe bërtet “revolucion! revolucion! revolucion! “. E ngarkuar me një kuti me sendet e saj personale, ajo ende arrin të ngrejë grushtin, por klithma e saj i ngjason më shumë një thirrje për ndihmë sesa një nxitje për revoltë. Në lot, ajo përfundon duke rënë në gjunjë, gjërat e saj u shpërdahen në mes të rrugës. Disa të tjerë që ndanin të njëjtën fatkeqësi nxitojnë për tek ajo, por ajo nuk pranon të ngrihet. “Zoti im, me kë je? » thërret teksa mbytet në lot. Një ushtar kthen shpinën dhe fshin një lot. Me një pagë ekuivalente me 70 dollarë, si pasojë e rënies së paundit libanez, situata e tij financiare nuk është shumë më e mirë se saj, por ai dhe kolegët e tij po u binden urdhrave. Për të shmangur çdo tejmbushje, universiteti bëri thirrje për një sistem të fortë sigurie që mobilizon ushtrinë dhe forcat e rendit. “Ishte e nevojshme të ruheshe nga kërcënimet e jashtme”, justifikoi z.Fadlo Khouri, presidenti i institucionit, ndërsa pranoi se pushimet nga puna “mund dhe duhej të ishin menaxhuar më mirë”.

Një krizë serioze ekonomike, papunësia duke u ngritur në qiell, ushtria e vendosur për të parandaluar protestën, një popullsi që përballet me shtimin e rasteve të Covid-19 ... Pra, Libani po shkonte tashmë drejt 4 gushtit dhe shpërthimit të dyfishtë aksidental në portin e Bejrutit, me shifra katastrofike: gati 200 të vdekur, 7000 të plagosur, një pjesë e mirë e kapitalit e shkatërruar, 300.000 banorë pa strehim, ndërsa 70.000 humbën punën. Shpresat e lindura nga lëvizja popullore e 17 tetorit 2019 shfaqen tani shume të largëta. Në më pak se një vit, situata ka ndryshuar plotësisht. Sistemi politik i urryer, që demonstruesit e rinj u munduan të shpërbëjnë duke brohoritur “të gjithë, kjo do të thotë [që] të gjithë [duhet të zhduken]” është ende në fuqi. Dhe çdo ditë, ose pothuajse çdo ditë, sjell lajmet e veta të këqija ose shenjë e një situatë përkeqësuese: rikonfinimi i pjesshëm i popullsisë me efikasitet të pasigurt në shëndetin publik, tejmbushja e spitaleve, mungesa e ushqimit, sulme të tmerrshme për një copë bukë, zjarr në port në shtator dhe negociata të pafundme politike pavarësisht “ultimatumi” të presidentit francez Emmanuel Macron që kërkon formimin, pa vonesë, të një “qeverie misioni” për kryerjen e reformave.

Larg nga këto konsiderata politike, një nga shqetësimet kryesore të libanezëve mbeten paratë. Në rrugën Hamra në Bejrut, tregtarët dëgjojnë të njëjtën pyetje gjatë gjithë ditës: “Sa është paundi sot?” Si simbol i rënies së një zone të lavdëruar dikur për jetën

kulturore, arteria e famshme e cila ishte zemra e gjallë e kryeqytetit, me kinematë, teatrot dhe kafenetë e saj, pushtohet nga dyqanet me rroba të përdorura që shiten me 1 dollar.

Në mënyrë paradoksale, i vetmi vend në rrugë që rilidhet me një të kaluar angazhimesh është selia e bankës qendrore ose Banque du Liban (BDL). Drejt kësaj ndërtese, tani e mbrojtur nga pengesa betoni, demonstruesit i bashkohen pjesmarrësve të sit-in për denoncimin e ndikimit të bankave mbi vendin dhe bashkëpunimin e tyre, të toleruar nga BDL.”Le të rrëzohet regjimi bankar”, proklamoi një parullë në të cilën është pikturuar portreti i z.Riad Salamé, guvernatori i BDL, i veshur me tiparet e djallit.

Që nga Dhjetori 2019, institucionet financiare kanë aplikuar një ngrirje de facto të aktiveve të individëve, këta të fundit janë në gjendje të tërheqin vetëm shuma të kufizuara nga llogaritë e tyre . Kufizimet janë forcuar qëkur qeveria njoftoi në 7 Mars një pamundësi për ripagimin e një pjesë të borxhit të jashtëm (1.2 miliardë dollarë, nga gjithsej 90 miliardë dollarë). Rezultati ; vendi punon me tre monedha në treg. Përveç paundit libanez, ekziston dollari i kuotuar me kursin zyrtar dhe disponueshmëria e të cilit mbetet shumë e ulët, banka qendrore kujdeset për të kursyer rezervat valutore. Ekziston edhe paraja e fituar në tregun e zi pas një çmimi të luhatur, por gjithmonë më e shtrenjtë se norma zyrtare (1 dollar për 8000 paund mesatarisht). Në këtë kontekst, mbledhja e dollarëve është çështje durimi dhe sakrifice. Kështu, zonja Hala Zaidan, 54 vjeç, ndryshon në të zeze një pjesë të pagës së saj të marrë në paund libanezë. “Unë arrita të lë mënjanë tre muaj kursime për djalin tim, i cili po studion në Moskë,” shpjegon ajo. Nuk e lejova atë të vinte në shtëpi këtë verë për shkak të epidemisë Covid-19, por edhe në mënyrë që të mos paguaja çmimin shumë të lartë të biletës së avionit. Për shumë libanezë, ky kërkim i kartëmonedhave jeshile është tregues i statusit të tyre shoqëror. Marrja e pagës në valutë të huaj është garancia e pasurimit ose, të paktën, e mirëmbajtjes së stilit të jetës. Anasjelltas, të paguhesh në paund libanezë, siç është rasti me shumë nëpunës civilë dhe punonjës të shërbimit publik, do të thotë t’i kesh sytë drejt humnerës në të cilën zhytet monedha kombëtare.

Vetëm një vit më parë, Habib F., një profesor në Bejrut, fitonte ekuivalentin e 3000 dollarëve në muaj. Sot, paga e tij vlen vetëm 450 dollarë, një rast emblemik i erozionit të ardhurave të klasës së mesme. Më 19 gusht, Komisioni Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara për Azinë Perëndimore (ESCWA), me seli në Bejrut, publikoi një studim që tregon se numri i përgjithshëm i libanezëve të varfër ka lloji nga 28% në 2019 në 55% në maj 2020 (2.7 milion individë), pra para katastrofës së portit. Akoma sipas të njëjtut dokument, Libani ka gjithashtu një nga nivelet më të larta të pabarazisë në botë, me 10% të më të pasurve që përfaqësojnë 70% të pasurisë atje.



I goditur nga shpërthimi më 4 gushti, z.Emmanuel Alkek tregon për degradimin. “Paga ime ka humbur 80% të vlerës së saj, por kam frikë nga mbyllja e biznesit tim. Pa djalin tim, i cili jeton jashtë, nuk mund të paguaja as ilaçet e mia. Dhe përsëri, tani jam i detyruar të racionoj veten. Në vend të një pilule ditore, unë e marr pilulën vetëm një herë në dy ditë. Ai u pyet nëse ka parë një mjek për këtë gjë. “Unë në vend të kësaj kërkova këshilla nga portofoli im,” përgjigjet ai. Të njëjtin ton sarkastik e gjejmë te zonja Dalal F., e cila ka dy punë por fiton më pak se 100 dollarë në muaj – “shuma e dy gjysmë-pagave”, thotë ajo. Për të, nuk ka më asnjë diskutim që dy djemtë e saj duhet të dalin nga shkolla private të cilën e paguajnë 8000\$ në vit dhe të shohin mundësinë e regjistrimit të tyre në shkollë publike.

“Biznesi i burrit tim falimentoi. Dhe zgjidhja e arsimit në distancë është e pamundur të zbatohet. Do të duhet të investoheet në një kompjuter, të paguhet interneti, dhe edhe nëse do të ishte e mundur, ekziston çështja e energjisë elektrike. Tridhjetë vjet pas përfundimit të luftës civile, për shkak të mungesës së termocentraleve të reja, Libani ende vuan nga energji elektrike kaotike, me disa ndërprerje në ditë. “Ne jemi duke paguar dy fatura për energji elektrike. Njëra për të na lidhur me rrjetin publik, dhe tjetra për t’u lidhur me një gjenerator privat.

Në gusht, me tetëmbëdhjetë orë ndërprerje ditore mesatarisht, gjysma e pagës sime iu kushtua pagimit të faturës së gjeneratorit. “Mafia “e pronarëve – private – nga këto pajisje denoncohet rregullisht në Liban. Sipas një raporti nga viti 2016, fitimet e tyre vjetore do të arrijnë 2 miliardë dollarë. Një fakt që do të shpjegonte pse vendi nuk është në gjendje të modernizojë rrjetin e tij elektrik dhe pse ka përfunduar me ndërprerje të përsëritura.

Varfërimi i libanezëve mund të përkeqësohet nëse autoritetet braktisin

subvencionet e importit, siç pohojnë bindshëm thashethemet. Që nga tetori i vitit 2019, kur paundi filloi të dobësohej, banka qendrore ka zbatuar një kurs të veçantë këmbimi në mënyrë që importuesit e produkteve strategjike të mund të marrin dollarë ose me kursin zyrtar ose me një kurs të ndërmjetëm (3900 paund për 1 dollarë) për të paguar për porositë e tyre për karburant, grurë, ilaçe, pajisje mjekësore dhe artikuj bazë ushqimorë. Sipas llogaritjeve në qarkullim, rezervat valutore të BDL (20 miliardë dollarë), e cila është e detyruar të mbajë një rezervë të detyrueshme prej 17.5 miliardë dollarë, nuk do ta lejonin atë të ruajë këto subvencione pas fundvitit. Përveç se për të marrë një hua nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), i cili, natyrisht, nuk dëshiron të dëgjojë për mirëmbajtjen e këtyre subvencioneve. Në një vend i cili shpenzon 6% të prodhimit të brendshëm bruto në importet e ushqimit – një nga nivelet më të larta të varësisë në botë – braktisja e një mbështetjeje të tillë do të gjeneronte mungesa dhe një rritje të inflacionit, e cila tashmë arrin 100% për produkte të caktuara ushqimore.

Siç ishte rasti në periudha të tensionuara në historinë e vendit, shumë libanezë zgjedhën të emigronin jashtë, veçanërisht në Kanada. Të tjerët mjaftohen të largohen nga Bejrut, i cili është bërë e papërballeshëm. “Unë u ktheva në fshatin tim sepse qiraja në kryeqytet është rritur katër herë për shkak të rënies së paundit “, thotë z. Hanna D., shofer taksie. Ky 60-vjeçar punonte si llogaritar në një hotel të madh para se të pushohej nga puna pas lëvizjes popullore të tetorit 2019. “Drejtorja ka filluar duke na paguar gjysmën e pagës, pastaj na dëbuan. Pa turistë, s’ka para. Nuk mund t’i fajësoj “, vazhdon ai që, i ballafaquar me mungesën e klientëve në fshatin e tij, shkon çdo ditë në Bejrut për të mbledhur disa ushqime. I pazhvilluar, me pak infrastrukturë, madje edhe më i penalizuar nga mungesa e energjisë elektrike dhe vështirësia e aksesit në internet, Libani i brendshëm

nuk mund të jetë, megjithatë, një alternativë e pranueshme për të rinjtë e vendit. E vetmja rrugëdalje për të është të zgjedhë emigracionin e paligjshëm. Rezultoni se shumë nga të zhdukurit të identifikuar pas tragjedisë së 4 gushtit nuk u vranë nga shpërthimi i dyfishtë. “Ata ‘rrëshqitën’ drejt Evropës, ndoshta pak para katastrofës,” tha prindi i njërit prej tyre.

Të gjitha dëshmitë për nisjet jashtë vendit theksojnë një pikë kryesore. Ai që emigron nuk e bën vetëm për vete. Mbërriti i sigurt, ai do të ndihmojë ata që do të qëndrojnë. Kjo vlen për refugjatët palestinezë, të cilët vazhdojnë të vuajnë nga stigmatizimi, shtatëdhjetë kategori punësimi i kanë të ndaluar. Në kampin Mar Elias, në jugperëndim të Bejrut, është mbjellur fatalizmi. “Për momentin, klasat popullore libaneze vuajnë shumë më tepër se ne, thotë z. Abou Ibrahim, kasap. Varfërinë, ne e njohim për shumë më gjatë se ata, por përparësia jonë është që organizatat tona dhe institucionet që kujdesen për ne të paguajnë në dollarë dhe jo në paund libanezë. Por mbi të gjitha, nuk ka një familje këtu që nuk merr para nga një i huaj, edhe nëse janë disa dhjetra dollarë “. Shenjë e kohës dhe e mungesës së besimit në institucione, këto dërgime fondesh nuk kalojnë më nëpër kanalet e zakonshme, por “përmes çantës”, nga dora në dorë.

A do t’i shtyjë varfërimi i përgjithshëm libanezët që të rimarrin rrugët edhe një herë pas epidemisë Covid-19? Shkrimtari Hassan Ezzein, që mori pjesë në protestat më të njohura gjatë njëzet viteve të fundit është i bindur për këtë. Por prognoza e tij është larg të qenit optimiste. Për të, protesta do të dalë kundër ndërhyrjes së huaj, e cila synon të mbajë sistemin politik libanez ashtu siç është, edhe nëse do të thotë ta pastrojë pak. Mbi të gjitha, ai tha, “vendi nuk do të shpëtojë nëse libanezët nuk ndërtojnë një kundërshtim të qartë ndaj regjimit, me një program të vërtetë politik. Përndryshe, do të jetë kaos”.

KONTESTOHET RIZGJEDHJA E PRESIDENTIT LUKASHENKO

Në Bjellorusi, rinia urbane në vijën e parë

I shtyer nga rruga për t'u larguar nga pushteti, presidenti bjellorus është dorëzuar para kërkesave të Moskës që kërkon organizimin e reformës kushtetuese. Disa javë më parë, protestuesit, të frymëzuar nga precedenti ukrainas, refuzuan çdo ndërhyrje, duke shpresuar se numri i tyre do të ishte i mjaftueshëm për ta shkarkuar udhëheqësin.

NGA I DËRGUARI YNË SPECIAL LOÏC RAMIREZ*

Mesi i muajit gusht 2020. Në televizion, imazhet e demonstratave po shfaqen pandërprerë. “Do të mbarojë shpejtë”, thotë z. Stas L., madje pa e shikuar ekranin. Me shpinë e kthyer nga lajmet, të ulur në një lokal në Braginë, në Bjellorusinë Jugore, ai dhe miqtë e tij, të gjithë rreth të tridhjetave, bisedojnë duke pirë një shishe vodka. Që pesë ditë, një valë proteste me shkallë të paparë po përfshin vendin.

Por ngjarjet që pasuan treguan se kishte gabuar: protestat vazhdonin ende në mes të shtatorit, veçanërisht në universitetet e kryeqytetit bjellorus dhe në marshet ku mbledheshin qindra mijëra njerëz, në Minsk dhe në qytetet e tjera të mëdha të vendit.

Rizgjedhja e z.Alexander Lukashenko më 9 Gusht 2020 dhe protestat që pasuan e vendosen Bjellorusinë në qendër të vëmendjes së mediave ndërkombëtare. Presidenti e filloi mandatin e tij të gjashtë me radhë që nga viti 1994, pasi që siguroi 80.23% të votave në zgjedhje të manipuluar. Ai e mundi rivalën e tij kryesore, znj. Svetlana

Tikhanovskaya, e cila si kandidat e zëvendësoi në momentin e fundit burrin e saj, i cili ishte arrestuar në muajin maj për “prishje të rendit publik”. Prapa znj.Tikhanovskaya u rreshtuan ekipet e dy kandidatëve të tjerë, z.Valery Tsepkalo dhe z.Viktor Babariko, të përfaqësuar nga gruaja e të parit Veronika dhe menaxherja e fushatës të së dytit, znj.Maria Kolesnikova, pas ikjes në Moskë të të parit dhe pas arrestimit të të dytit.

Ukraina, një gogol

Pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve, përplasjet midis protestuesve të rinj dhe forcave të rendit kapluan kryeqytetin gjatë natën. Interneti u ndërpre për tri ditë me radhë. Mijëra arrestime dhe dëshmi të shumta të rrahjeve të kryera në stacionet e policisë dëshmojnë refuzimin që i bëhet Presidentit, i cili kurrë nuk kishte përdorur metoda frikësimi në një shkallë të tillë. Pas zgjedhjeve presidenciale të vitit 2010, pati qindra arrestime dhe opozitës iu ndal hovi në mënyrë diskrete në sallat e gjyqit përgjatë muajve në vijim.

Edhe këtu, në këtë qytet të vogël, ndihet gjendja e tendosur e autoriteteve. Në mbrëmje, një numër i vogël i oficerëve të policisë fillojnë të patrullojnë në sheshin kryesor të fshatit, ndërsa njëra nga makinat e tyre vendoset në rrugë për vëzhgim. Një organizim disproporcional për këtë qytet të populluar nga rreth 3000 banorë. A është për shkak të afërsisë së kufirit ukrainas? Apo nga frika se do të zhvendoseshin demonstratat që zhvillohen edhe në Gomel, kryeqyteti rajonal që gjindet njëqind kilometra larg. Stasi, punëtor në kantier rrugësh, e ka njohur vetëm z. Lukashenko si President. “Unë e kam votuar Tikhanovskaya-në,” thotë ai, “por nuk do të dal në protestë! Për ne bjellorusët gjëja më e rëndësishme është qetësia, askush nuk e dëshiron një ‘Maidan’ “. I riu i referohet kryengritjes ukrainase e cila, gjatë dimrit të vitit 2013-2014, rezultoi në përmbysjen e Presidentit Viktor Janukoviç, përpara se ta çonte vendin në një luftë civile. Gogoli i trazuar nga pushteti ushqehet nga frika reale në popullatë. Pastaj, edhe miqtë e Stasit zbulojnë sesi kanë votuar në zgjedhje. Shumë thonë se e kanë votuar zonjën Tikhanovskaya. Të tjerët kanë preferuar fletën e votimit të bardhë. “Unë e votova Lukashenko-në,” u përgjigj një nga të pranishmit. Një pohim që e befaso i pjesën

tjetër të grupit. “A po? A e votove atë?”. “Po, sigurisht”. Pa shpjegime dhe debat të tjerë, gotat u zbrazen dhe bisedat e kota rifilluan.

Është vështirë të analizohet vota në favor të udhëheqësit. Ky rezultat fryhet nga mashtrimet elektorale apo reduktohet në pothuajse asgjë, siç e potencojnë ndonjëherë në mënyrë karikaturale, disa kundërshtarë (të cilët kanë mbrojtur, gjatë fushatës, tezën e Lukashenko të kredituar me 3%). “Studimet sociologjike e vlerësonin rezultatin e tij në rreth 60%, sigurisht shumë më pak në kryeqytet, ku opozita ka pasur gjithmonë një bërthamë të fortë”, shpjegon Bruno Dwreski, historian dhe ligjërues në Institutin Kombëtar të Gjuhëve dhe Qytetërimeve Orientale (INALCO). Për studiuesit Stephen White dhe Elena Korosteleva, profili tipik i votuesve të z.Lukashenkos është “shumica me moshë mbi 60 vjeçare, mesatarisht me nivel arsimor mjaft të ulët “ dhe kryesisht nga zonat rurale. Në anën tjetër, kundërshtarët e tij janë “të rinj”, “punëtorë në sektorin privat”, “me nivel të lartë arsimor” dhe “me banim në qytetet e mëdha”. Prandaj, një opozitë e gjeneratëve e shoqëruar me thyerje gjeografike. Për Aleksei Dzermant, një politolog i afërt me qeverinë, “elektorati i presidentit përbëhet nga zyrtarët, nga personat që punojnë për shtetin dhe nga klasa punëtore.”

“Vendi ka ndryshuar, por jo ai”

Megjithatë, duket se ka ndodhur një tcurrje në përkrahjen e Lukashenko edhe në shtetas tradicionalisht të favorshme ndaj tij. Një studim mbi numërimin manual të rezultateve të publikuara në 900 qendra të votimit (një e katërta e votuesve), të korrigjuar nga norma e pjesëmarrjes dhe të votimit me postë jashtëzakonisht e lartë, sugjeron një rezultat prej 45% për znj.Tikhanovskaya, kundrejt 43% për z. Lukashenko. Janë dhënë edhe vlerësime të tjera, të gjithë përkohë në një rezultat shumë më të ngushtë se rezultati i njoftuar nga komisioni qendror i zgjedhjeve. “Po, në të kaluarën kam votuar për të, por kjo nuk është më e mundur”, thotë Viktori, afërsisht pesëdhjetë vjeçar, mësues i frëngjishtes në një shkollë në Gomel. “Nuk guxojmë të themi asgjë kundër qeverisë, sepse mund të kemi probleme në vendin e punës... është ngulftatëse; jo që mohoj gjithçka që ka bërë, por vendi ka ndryshuar dhe ai ka mbetur i njëjtë”. Një njeri i rreptë i cili, gjatë vizitave të paparalajmëruara në fabrika ose në ferma, shkarkonte dhe zëvendësonte aty për aty drejtorin e paafët ose ministrin që konsiderohej shumë i butë, z. Lukashenko ka kultivuar një imazh paternalist që e ka tërhequr prej kohësh shoqërinë bjelloruse. Por, kjo retorikë me kohë është bërë e bezdisshme. Gjatë fushatës, deklaratat e tij ndaj paafetësisë së një gruaje për ta qeverisur vendin dhe ofendimet e kërcënimit e tij kundër kundërshtarëve u kthyen kundër tij dhe u tallen gjatë protestave.

Nga e kuqja dhe e gjelbërta tek e kuqja dhe e bardha

Rritja e pakënaqësisë ndërlihdet me degradimin ekonomik të viteve të fundit. I zgjedhur bindshëm me 80% të votave në vitin 1994, Lukashenko i kishte dhënë fund privatizimeve masive që kundërshtoheshin në popull. Nxitja e përfshirjes së shtetit në ekonominë kishte pasur sukses. Derisa në republikat e tjera ish-sovjetike, industritë po mbylleshin dhe pabarazitë po rriteshin, në Bjellorusi ka pasur rritje qysh në vitin 1996 dhe kanë ekzistuar disa sektorë të avancuar, siç është

prodhimi i traktorëve dhe të makinerisë së punës. Ishte shpëtuar gjithashtu bujqësia e vendit falë investimeve të konsiderueshme publike në fermat kolektive, të cilat siguronin gati 80% të prodhimit, 90% e të cilit eksportohet në Rusi. Në vitet 2000, vendi përfitoi nga çmimet e larta të hidrokarbureve. Moskë e lejoi Minskun ta rafinonte lëndën bruto të blerë me çmime të ulta dhe ta riekportonte me çmimin e tregut botëror derisa e furnizonte atë me gaz me çmime miqësore.

Por kriza e vitit 2008 dhe rënia e kurseve, e cila automatikisht e ul nivelin e subvencioneve, e ka gërryer këtë shportë. Ndërsa vendi regjistron mesatarisht norma vjetore të rritjes prej 7.2% gjatë dekadës paraprake, produkti i brendshëm bruto (PBB) i tij është rritur vetëm me 1.6% në vit që nga rëzimi i bursës. Në retrospektivë ,demonstratat e vitit 2017 kundër gjobës për të papunët – rreth 460 rubla (225 euro) për personat pa punë të deklaruar për më shumë se gjashtë muaj – duken si paralajmëruese të krizës aktuale. Arrestimi i kandidatëve gjatë fushatës, shkalla e manipulimeve dhe më pas, shpërndarja nëpër rrjetet sociale, pas riaktivizimit të internetit në vend, të imazheve të personave të lënduara, u shtuan në listën e zemërimeve.

Për momentin, protesta nuk shoqërohet nga një program i saktë politik dhe ekonomik. Protestuesit, në përgjithësi, po bashkohen rreth disa kërkesave të thjeshta – lirimi i të burgosurve politikë, organizimi i zgjedhjeve të reja – dhe, kryesorja, largimi i z.Lukashenko. Emri i kundërshtarës në ekzil, zonja Svetlana Tikhanovskaya, rrallë shihet nëpër pllakat. Në mes të gushtit, ajo themeloi nga Lituania një këshill koordinues që synon dialogun me Minskun me qëllim të transferimit të pushtetit për të organizuar zgjedhje të reja, por ajo nuk luan ndonjë rol të madh në organizimin e protestave në terren. Në mesin e shtatë anëtarëve të kryesisë të këtij këshilli, ku bashkëprojetojnë një udhëheqës grevist dhe një bashkëkryetare e një partie të vogël tradicionale të krishterë në favor të braktisjes së rusishtes si gjuhë zyrtare, vetëm Svetlana Aleksiëviç, fituese e çmimit Nobel për letërsi, nuk ka qenë e shqetësuar nga autoritetet në mes të shtatorit. Të tjerët janë larguar nga vendi ose janë prapa grilave.

Në parakalime, vetëm flamuri bardhë-kuq-bardhë valëvitet si një simbol unanim i refuzimit të udhëheqësit. Ky flamur është flamuri i Republikës së parë Popullore të Bjellorussisë të vitit1918 i cili filloi të përdoret përsëri kur vendi fitoi pavarësinë në vitin1991. Çdo banderolë tjetër ose mesazh shihet me dyshim, sepse mund të jetë ndarës: flamurit e rrallë evropianë u ripaketuan shpejt dhe asnjë parullë armiqësore ndaj Rusisë nuk dëgjohet në radhët e demonstruesve. Për ta diskredituar lëvizjen dhe për ta nxitur Moskën që t'i vjen në ndihmë, z.Lukashenko përsërit vazhdimisht se flamuri kuq e bardhë kishte shërbyer si një flamur për nacionalistët bjelloruse që kishin bashkëpunuar me nazistët prej vitit 1941. Në fakt të tillë ishin shumë të paktë dhe praktikisht nuk kanë lërë pothuajse asnjë traditë politike. Një kontrast i madh me vendet tjerë fqinje të ish-perandorisë cariste – vendet Balltike, Ukraina, Polonia – ku që nga



fillimi i shekullit të 19-të, lëvizjet nacionaliste ishin mbështetur në partië politike, shkollat , universitetet dhe qendrat kulturore dhe kishin nxitur luftën e armatosur anti-ruse dhe më pas anti-sovjetike, ndonjëherë në bashkëpunim me nazistët.

Kjo nuk ndodhi në Bjellorusi që njihet më shumë për lëvizjen e partizanëve sovjetikë prapa frontit të Gjermanisë Lindore. Në këtë kontekst, e kuqja dhe e bardha tregojnë më pak ringjallje nacionaliste se refuzim ndaj një presidenti që kishte kthyer, me referendum, ngjyrat kuqe dhe gjelbërt të flamurit sovjetik, në vitin 1996.

Kur, rreth 11 gushtit, shpërthyen grevat në qarqet më të zhvilluara të industrisë bjelloruse- (në MAZ, fabrikë automobilash; Belaz, kompani e inxhinierisë dhe prodhues e pajisjeve industriale; MZKT, prodhues i kamionëve të rëndë, të gjitha këto në pronësi të shtetit) Z.Lukashenko e kuptoi se fuqia e tij po lëkundej. Pakënaqësitë po kulmojnë në vendet e punës. Megjithatë, në mëngjesin e 17 gushtit, përpjekja për ta ndaluar punën në fabrikën Atlant në Minsk ishte e pasuksesshme. “Kush punon këtu?“, pyeti një grua e moshuar që kishte ardhur të bashkohej me rreth tridhjetë njerëz që ishin mbledhur në hyrje të ndërtesës kryesore për të mbështetur mobilizimin. Vetëm njëri e ngriti dorën. Të tjerët ishin studentë, për shumicën, ose pensionistë dhe njerëz të tjerë që kishin ardhur për t'u solidarizuar. “Unë jam ndoshta i vetmi,” shpjegon punëtori, “kolegët e tjerë kanë frikë dhe askush nuk po na ndihmon”.

Besnikëria e ushtrisë dhe policisë

Që nga dekreti presidencial nr. 29, i ratifikuar në vitin 1999, shumica e punësimeve kanë qenë me kontrata me afat të caktuar, një deri pesë vjet. Kjo reformë liberale i ka dobësuar sindikatat e pakta kundërshtuese në vend. Në vitin 2018, një studim i Federatës së sindikatave bjelloruse që mbulonte 1.6 milion kontrata zbuloi se 30% e punonjësve të vendit punojnë me kontrata me afat të caktuar njëvjeçar. Frikës së largimit nga puna i është shtuar arrestimi i disa liderëve grevist dhe, së fundmi, frika, te punonjësit shtetëror, nga privatizimet masive që do të shkaktonin zhdukjen e vendeve të punës ose të fabrikave. Sipas pretendimeve të z.Lukashenko kjo do të ndodh nëse opozita vjen në pushtet. Gjatë fushatës, konkurrentët e tij, ish-bankieri Viktor Babariko dhe ish-ambasadori dhe drejtori i një parku teknologjik z.Valëry Tsepkalo, nuk i fshehën qëllimet e tyre për ta “modernizuar” vendin. Sektori publik – shërbimet publike

dhe kompanitë shumica e të cileve në pronësi të shtetit – punëson gati 40% të punonjësve të vendit. Kompanitë në të cilat pjesëmarrja e shtetit në kapital është mbi 50% përfaqësojnë rreth 30% të prodhimit vjetor dhe të punësimit.

Sidoqoftë, një sektor duket se është në krye të protestës: sektori i teknologjisë së lartë. Ky sektor u formua në vitet 2000. Atij “iu dhanë lehtësime të konsiderueshme tatimore, disi në kundërshtim me modelin mbizotërues të” socializmit të tregut“, kujton studiuesja Youlia Shoukan në llogarinë e saj Facebook. Kjo thekson se “ky devijim nga modeli dominues, i cili i kishte mundur regjimit të mbrohej për shumë vite kundër çdo nisme proteste të iniciuar ose të financuar nga sektori privat, duket se e ka mashtruar atë”. Ludmila V., e cila punon për një kompani të dizajnit të aplikacioneve në Minsk, dëshmon për këtë angazhim qysh në fillimin e lëvizjes, përfshirë edhe nga menaxhmenti: “Që nga demonstratat, punonjësit kanë të drejtë të mos vijnë në punë ose të punojnë nga shtëpia në rast të një tubimi; kështu, kompania jonë është zotuar jozyrtarisht që të paguajë gjokat e punonjësëve të saj nëse ata kapen në protesta të padeklaruara “.

Në anën tjetër, mobilizimi i vështirë i mbështetësve të qeverisë ekziston në pjesë të madhe vetëm përmes mbështetjes së burimeve shtetërore (autobusa për të sjellë njerëz, helikoptera për të vlerësuar flamurin). Regjimi – hiper-presidencial- i cili kurrë nuk ka shpallur një ideologji të qartë, – vështirë se mund të llogarisë në një bazë militante për ta mbrojtur atë. Por duke gëzuar ende besnikërinë e ushtrisë dhe policisë,

Lukashenko ende mban frenat e pushtetit. Megjithatë, ai vazhdon të përballet me një krizë të madhe të legjitimitetit. Ftesa për një reformë kushtetuese që forcon prerogativat e qeverisë dhe të parlamentit në dëm të atyre të presidencës, e propozuar me zgjuarsia nga z.Lukashenko si një parakusht për mbajtjen e zgjedhjeve të reja në 2022, ndan opozitën dhe i mundëson atij të fitojë kohë. Një maskaradë për të mbetur në pushtet, apo një rrugëdalje që paralajmëron një rikonfigurim të thellë politik? Dalja nga kriza do të luhet kryesisht në Moskë. Dhe nga qendrueshmëria e protestuesve ndaj represionit, lodhjes në kohë apo ndarjeve.

*Gazetar

KARL KRAUS, ROSA LUKSEMBURGU DHE KATASTROFA E LUFTËS SË MADHE

Ç'do të thotë t'i trajtosh kafshët me mirësi?

Satiristi vjenetz Karl Kraus (1874-1936) bëri një reflektim mbi trajtimin e kafshëve gjatë Luftës së Parë Botërore, gjatë përplasjeve të luftës së tij kundër veleritetit gazetaresk, kapitullimeve socialdemokrate dhe militarizmit. Një shekull më vonë, jehona e tij plotëson zërat që ngrihen kundër keqtrajtit të kafshëve, që ka arritur një fazë industriale në kohë paqeje.

NGA JACQUES BOUVERESSE



@BENJAMIN BONDONNEAU

Më 1 gusht 1914, satiristi vjenetz Karl Kraus shkruante në revistën e tij Die Fackel (Pishtari) : Dëgjova një britmë: "Le të shkojmë drejt lavdisë, gjithmonë!". Unë kisha turp të ankohe, sepse tashmë e dija shumë mirë se koha do të vinte gjithsesi së shpejti: "Do të doja t'dilja nga kjo!" Përveç se isha në të njëjtën kohë një optimist i tillë saqë caktova datën për shprehjen e kësaj dëshire, e cila nuk mund të mos ishte ndjerë që më 1 gusht 1915, më 1 gusht 1916, dhe jo më 1 gusht 1917. Sidoqoftë në këto lloj rastesh nuk mund të punosh me saktësi matematikore, por vetëm me saktësi apokaliptike".

Kraus shpreh këtu bindjen e tij se vetëm një përpjekje e jashtëzakonshme e imagjinatës, siç përbën shembull mënyra apokaliptike e të menduarit, është në gjendje ta kompensojë mungesën totale të imagjinatës që e bëri të mundur katastrofën duke na mundësuar të kuptonim se ç'ka ndodhur dhe ç'rjedh prej saj, edhe nëse nuk do të ishim në gjendje ta parandalonim atë.

Kjo është gjuha e apokalipsit dhe madje nganjëherë vetë teksti i Apokalipsit, të cilin Kraus e miraton natyrshëm

për të folur jo vetëm për humbjen e jetërave njerëzore dhe vuajtjeve të paimagjinueshme që shkakton lufta, por edhe për shkatërrimin që kombinimi i progresit teknik me fuqinë e tepruar të parasë dhe kërkimi për përfitim me çdo kusht, ka filluar të shkatërrojë mjedisin dhe natyrën. Të dyjat, plotfuqia vrasëse e teknikës dhe tirania e parasë-mbret, janë për më tepër në sytë e tij më shumë se kurrë të lidhura me njëra-tjetrën, pasi që siç thotë ai, në fillim tregjet u shndërruan në fusha betejë, dhe më pas fushat e betejës në tregje, për t'u pushuar dhe shfrytëzuar nga industrialistët dhe tregtarët e armëve. Një ndërlidhje e këtij lloji mund të duket në shikim të parë jo shumë e qartë, por Kraus, nga këndvështrimi i tij, nuk ka dyshim për "ekzistencën e një lidhje shkakore midis gjakut dhe profitit", e cila për pasojë ka që mijëra qenie njerëzore përdoren deri në vdekje, në dobi të përfitimit dhe të prosperitetit të disave.

Sulmet ndaj dinjitetit, të drejtave dhe jetës së qenies njerëzore, vlera dhe çmimi i të cilave janë ulur në mënyrë dramatike nga lufta, në asnjë mënyrë nuk mund të ndahen me të vërtetë nga përbuzja me të cilën njerëzimi modern është mësuar ta trajtojë mjedisin në

përgjithësi dhe kafshët në veçanti. Në të vërtetë ekzistojnë vetëm dy aspekte të ndryshëm të të njëjtit proces të dehumanizimit dhe për pasojë të vetëshkatërrimit ku ka hyrë njerëzimi.

« Askush nuk ka mëshirë për ne »

Pra, nuk është rastësi që në monologun e fundit të 'Râleur' (Ditët e Fundit të Njerëzimit) ekziston një çështje të një problemi që dikush mund të ndodhet ta konsideroj shumë dytësor, por që për Kraus është përkundrazi me rëndësi thelbësore: ajo e shkatërrimit, që sasi të gjithnjë e më të konsiderueshme të letrës të cilat nevojiten për prodhimin e gazetave, po shkaktojnë në pyje. Ky bashkim, që mbart një domethënie ogurzezë, midis rritjes disproporcionale të shtypit, që asgjë nuk duket se mund ta përmbajë më gjatë dhe pakësimit të pyjeve gjithmonë ka pasur për të një karakter simbolik në pikën më të lartë përfaqësuese të kësaj që po ndodh, me pëlqimin dhe madje për fajin e tij, për njerëzimin.

Episodi i cili përmendet në monologun e 'Râleur' i përket përsëri kategorisë

të së pabesueshmes, të cilën madhësia e tij nuk e parandaloj të ndodhte me të vërtetë: "Duke pasur dëshirën për ta zbuluar kohën e saktë të nevojshme që duhet për një pemë që qëndronte në pyll të kthehet në një gazetë, shefi i një librarie në Harz pati idenë e një eksperimenti shumë interesant. Në ora 7.35 të mëngjesit, ai preu tre pemë në pyllin pranë dhe pas zbarkimit i transportoi në fabrikën e letrës" (Ditët e Fundit të Njerëzimit). Përgjigja e pyetjes që duhej zgjidhur ishte si në vijim: vazhdimi i operacioneve që ishin të nevojshme për të kaluar nga pema në gazetën e shtypur mund të kryhej aq shpejt saqë ajo shitej në rrugë nga ora 11.00. "Prandaj u desh, përfundon njoftimi i Râleur, vetëm tre orë e njëzet e pesë minuta për t'ia mundësuar publikut t'i lexojë lajmet e fundit mbi një material që vjen nga pemët në degët e të cilave zogjtë ishin ende duke cicëruar në mëngjes ».

Kur i afrohemi çështjes së marrëdhënies së ngushtë që ekziston, në sytë e satiristit, midis dehumanizimit të qenies njerëzore dhe reduktimit të natyrës në statusin e një instrumenti të thjeshtë që njeriu ka të drejtë ta përdorë siç dëshiron, është pothuajse e pamundur të mos përmenden gjithashtu

afinitetet e shquara që ekzistojnë, në këtë pikë, midis qëndrimit të tij dhe atij të Rosa Luksemburgut. Siç e shpjegon vet, Kraus kishte hasur në një nga letrat që ajo shkroi në 1917 nga Breslau ku ishte në burg drejtuar Sonia Liebknecht, një letër që ishte botuar tre vjet më vonë. Ajo që vlerësoi dhe admiroi në këtë letër ishte padyshim jo vetëm cilësia e jashtëzakonshme letrare që zbulohet atje, rëndësia e së cilës nuk është për t'u habitur, por edhe dashuria e thellë e natyrës që shprehet dhe dhembshuria për vuajtjet që qenia njerëzore është në gjendje të shkaktojë me ndërgjegje të plotë për disa nga banorët e tjerë që jetojnë, në veçanti për kafshët që i ka detyruar t'i shërbejnë dhe madje ndonjëherë i redukton plotësisht edhe në skllavëri.

Si për Luksemburgun, ashtu edhe për Kraus, lidhja midis asaj që ajo përshkruan në letrën e saj dhe asaj që ka sjellë lufta – ose ndoshta thjesht ajo që ka bërë të dukshme – është pothuajse e vetëkuptueshme. Kur mbikëqyerësja e indinjuar pyet ushtarin, i cili po brutalizon me egërsi një kafshë të rraskapitur së cilës i është kërkuar ta bartë një ngarkesë shumë të rëndë për të, nëse ai

ndjen keqardhje për kafshët, përgjigja flet vetë: “Askush nuk ka mëshirë për ne njerëzit”, u përgjigj ai me një buzëqeshje të ligë duke e goditur sërish kafshën. Këtu shprehet prija që mund ta kenë lehtë viktimat për të ushtruar një formë hakmarrje ndaj viktimave të tjera më të dobëta dhe më të paafta për ta mbrojtur veten.

Për kafshët që trajtohen në këtë mënyrë (buaj që janë sjellë nga Rumania), Luksemburgu thotë në letrën e saj : “Ata rrihen në mënyrë të tmerrshme, para se t’ju aplikohet thënia” *Vae victis*”. (...) Vetëm në Breslau, ka rreth njëqind kafshë të tilla; për më tepër, ata janë mësuar me livadhet e pasura rumune, por tani marrin vetëm ushqim të varfër dhe të mjerueshëm. Shfrytëzohen paturpësisht, bartin çdo ngarkesë dhe shpesh ngordhin prej këtyre punëve». Janë humbësit e luftës, që harrohen shumë lehtë, që meritojnë shumë më pak se të tjerët keqardhje. Dhe është thjesht në oborrin e një burgu që Luksemburgu shih fytyrën e vetë luftës duke përkuluar prapa ngjarjeve dhe sjelljes që ajo përshkruan si në vijim: “Ndërkohë, të burgosurit ishin të zënë rreth karrocës, duke shkarkuar tufat e rënda para se t’i fusnin brenda. Nga ana e tij, ushtari ishte duke ecur nëpër oborr me dy duar në xhepa, duke buzëqeshur dhe duke fshikëllyer një melodi. Pashë përsëri tërë luftën madhështore që marshonte para meje”.

Ajo që, në letër, përmendet në një mënyrë po aq mbresëlënëse është lloji i solidaritetit spontan i cili vendoset midis të burgosurës, ce cila është gjithashtu, në një kuptim të caktuar, viktime e luftës, pasi është për një pjesë thelbësore kundërshtimi i saj , radikal dhe luftarak, ndaj kësaj që e bëri atë të burgosej, dhe viktimia tjetër e përfaqësuar nga kafsha e martirizuar. Ekziston diçka vërtet preke në përshkrimin e dhënë se si bëhet, si të thuash, njeri dhe si shndërronhet ai në një lloj vëllai në vuajtje dhe në fatkeqësi: “Ai [kafsha] që po gjakoste po vështronte, me një shprehje të atillë në fytyrën e tij – dhe sytë e zinj e të butë si ata të një fëmije që sapo ka qarë. Ishte vërtet shprehja e një fëmije që ishte ndëshkuar ashpër dhe pa e ditur pse, që nuk di si t’i shpëtojë këtij mundimi dhe dhune brutale. (...) Isha aty duke qëndruar në këmbë dhe kafsha më shikoi. Ndjeva se lotët më rrjedhin – ato ishin lotët e tij dhe nuk mund të dridhemi me më shumë dhimbje për këtë vëlla të dashur, sa që unë u drithërova në pamundësinë time për ta lehtësuar mundimin e tij të heshtur”.

Edward Timms, në biografinë e tij për Kraus, thekson me vend se “paralet midis Kraus dhe Luksemburgut janë të jashtëzakonshme. Të dy autorët i bëjnë thirrje një vizionit të harmonisë unike për ta sfiduar idenë e një natyre me dhëmbë dhe thonj të kuqërremtë, e cila aq shpesh është shfrytëzuar për ta justifikuar konfliktin ushtarak dhe dominimin racor. Kraus e përsëriti pozicionin e tij edhe me forcë kur e mori një letër nga një aristokratike mendjehollë që përqeshi Luksemburgun si një nga ato “gratë hysterike” që janë të dënuara të marrin një fund të pakëndshëm nëse vazhdojnë të mbjellin telashe”.

“Mendjeholla” në fjalë ishte një aristokrat hungareze, e cila u prezantua si ish-lexuese e Fackel dhe tha se ajo rastësisht gjeti një artikull në të cilin Kraus kishte riprodhuar dhe komentuar letrën e Luksemburgut.

Në numrin 462-471 të kësaj reviste, Kraus vë në dyshim mënyrën se si qentë jetuan “luftën e tyre” dhe arritën ta durojnë mungesën pothuajse totale të ushqimit dhe kujdesit, që indiferenca e

të ashtuquajturave specie “superiore” i kishin dënuar ata, duke i privuar nga çdo lloj të drejte të imponuar: “Tanimë në shumë mënyra, veçanërisht në gazetatat e ditës së dielë, qentë sulmohen sepse “vjedhin” ushqimin e njerëzve. Këto kritika janë të pabazuara. Përpos që jam shumë më i gatshëm t’i jap ushqim qenit se çdo gazetar, një gjë që di është se shumica e njerëzve kanë gjithmonë më shumë ushqim se shumica e qenve, të cilët megjithëkëtë nuk bëjnë luftë kundër njëri-tjetrit dhe nuk janë përgjegjës për çështjet faji i të cilëve është i njerëzve. Ndonëse mund të ndodh në raste të rralla që një qen ta vjedh ushqimin e një njeriut, në shumë raste njeriu hakmerret duke e gllabëruar qenin. E kundërta nuk ka ndodhur ende deri më sot (...) Ndoshta edhe për shkak se mi-shi për të cilin speciet e ndryshme luftojnë njëri-tjetrin me gazra toksike mund të duket më i shijshëm”.

Kraus ishte i mendimit se “dëshmia unike në llojin e saj të njerëzimit dhe poezisë” që përbën letra e Luksemburgut duhet të mirëpritet në të gjithë librat shkollorë midis Goethe dhe Claudius, dhe lexuesit e rinj të informuar nga fakti se “trupi që mbështjell një shpirt me një lartësi të tillë u prit me shkopin e pushkës “. Me sa duket, mund të thuhet se disa pasazhe të përgjigjes së Kraus në letrën e “Zonjës von X-Y”, do të meritonin të përfshiheshin në librat e shkollës : “Njerëzimi që konsideron kafshën si një qenie të dashur ka më shumë vlerë se kafshorja që tallet nga përqeshja dhe shakaja e idesë se një bual nuk është” veçanërisht” i habitur që duhet ta tërheq një karrocë deri në Breslau dhe të marrë goditje me dorezën e një kamxhiku. Këtu është lloji i frymës së neveritshme që i thotë këtyre zotërinjve të Krijimit dhe zonjave të tyre, se “që nga rinia e tyre e hershme”, nuk ndodh asgjë tek kafsha, aq pa ndjesi sa pronari i saj, për arsyen e thjeshtë se nuk është pajisur me të njëjtën pjesë të morgut dhe nuk është në gjendje t’i shprehë vuajtjet e tij me lehtësinë që ka në dispozicion”.

Protesta e Luksemburgut dhe Kraus i kundërvihet drejtpërdrejt një vizionit të botës shtazore e cila në fakt ka pak konsideratë për të, përveç nxitjes së specieve njerëzore për t’u frymëzuar nga shembulli për ta mësuar ashpërsinë, pamëshirshmërinë dhe mizorinë, si diçka që supozohet se është ligj themelor i jetës. Në kuptim të pranimit më të lehtë të idesë se natyra imponon si rregull luftën e përhershme të të gjitha qenieve të gjalla, nënshtrimin e inferioreve dhe eliminimin e të papërshtatshmit. Siç do të thotë Adolf Hitleri, bota e kafshëve nuk e ka mundësinë dhe mjetet sikur bota njerëzore, për t’u përpjekur t’i kundërvihet veprimit të ligjeve të natyrës, të cilat në çdo rast përfundojnë duke ngadhënjyer herët a vonë: “Në natyrë, ajo që nuk ka forcë jetësore zhduket vetvetiu; vetëm njeriu kultivon atë që preket nga dobësia jetësore ».

Prandaj është thelbësore dhe urgjente, për specien tonë, të biem më në fund dakord ta zëvendësojmë njerëzimin e dobët dhe sentimental që përpiket kryesisht në mbrojtjen artificiale dhe në promovimin e të dobët nga një formë tjetër e njerëzimit, më e virgjër dhe më shumë në përputhje me mënyrën se si bëhen gjërat në botën e qenieve të gjalla në përgjithësi, e cila quhet « humaniteti i natyrës » në ‘Mein Kampf’ : “Njeriu mund, për një kohë të caktuar, t’i sfidojë ligjet e përrjetshme të vullnetit të konservimit të vazhdueshëm; por hakmarrja vjen herët a vonë. Një specie më e fortë do ta dëbojë të dobëtën, pasi impulsi i jetës në formën e saj përfundimtare do t’i thyejë gjithnjë lidhjet qesharake të një të ashtuquajtur humanizëm të formave njëjës, në mënyrë që të sjellë në

vend të saj njerëzimin e natyrës i cili asgjëson dobësinë për t’i hapur rrugë forcës”.

Këtu shprehet një transpozim në botën kafshore të disa prej karakteristikeve më të neveritshme, por shpesh edhe më specifike, të vetë botës njerëzore. Të paktën përpjekja për të mos qenë më kafshëror ose më mizor se kafshët, në këto kushte, do të përbënte një përparim të konsiderueshëm për njeriun. Mund të ketë më shumë për të mësuar prej tyre se pashpirtësia dhe mizoria. Një njerëzim që mbetet në gjendje të sillet në mënyrë njerëzore ndaj kafshëve dhe t’i trajtojë ata si të barabartë i shërben njerëzimit më shumë sesa një që i trajton ato pak a shumë si material për përdorim.

Pyetja që u formulua këtu ishte në sytë e Kraus-it aq e rëndësishme sa që rikthehej tek ajo pa pushim. Në « Hunde, Menschen, Journalisten » (Qentë, njerëzit, gazetarët), ai riprodhon ekstrakte të shumta të marra nga autorët e ndryshëm që janë shprehur në mënyrë pozitive dhe miqësore ose, përkundrazi, që janë haptas armiqësor dhe plotësisht negativ ndaj çështjes së të drejtave të kafshëve dhe detyrimit njerëzor që ua kemi borxh. Siç mund të pritej, ai i jep një vend shumë të privilegjuar Arthur Schopenhauer, për nderin që ka treguar në këtë pikë, lidhur me shembullin që duhet ndjekur...Dhe është Baruch Spinoza, qëndrimet e të cilit i kishte kundërshtuar Schopenhauer, i cili luan rolin e të keqit në këtë histori.

Konceptimi i mbrojtur nga autori « Etika » është në fakt se statusi i kafshëve nuk është aspak ai i qenies së gjallë dhe madje ndoshta i shoqëruesve me të cilët ne mund të mbajmë marrëdhënie të një natyre shoqërore, por përkundrazi atë të instrumenteve që kemi të drejtë t’i përdorim pak a shumë siç duam, sipas nevojave dhe interesave tona: « Përveç njerëzve, ne nuk njohim në natyrë asgjë të veçantë që mund të na japë kënaqësi përmes shpirtit dhe me të cilën mund të lidhim një miqësi ose një lloj marrëdhënie shoqërore. Rrjedhimisht, norma e dobisë sonë nuk kërkon të ruajmë çfarëdo që është në natyrë, përveç njerëzve, por na këshillon ta ruajmë atë për përdorime të ndryshme, ta shkatërrojmë atë ose ta përshtatim me të gjitha mjetet për përdorimin tonë ».

Prandaj nuk mund të ketë asnjë detyrim për ne si të tillë, për ta siguruar mirëqenien dhe ruajtjen e kafshëve dhe qenieve të gjalla në përgjithësi, për aq sa varen nga ne, drejtpërdrejt ose indirekt, për ekzistencën e tyre, meqenëse pyetja nëse duhet apo jo të përpiqemi t’i ruajmë ato, varet vetëm nga përdorimi, i dobishëm ose jo, që do të jemi në gjendje t’i bëjmë, nëse vendosim t’i mbajmë gjallë.

Schopenhauer ia atribuon konceptimin, në sytë e tij të pakuptueshëm dhe devijues, që Spinoza mbron me këmbëngulje, ndikimit të Biblës, veçanërisht tregimit të Gjenezës – “Zoti tha: ‘Ta krijojmë njeriun si imazhin dhe shëmbëlltyrën jonë dhe si mbizotëruese mbi peshqit e detit, zogitë e qiellit, bagëtittë, të gjitha kafshët e egra dhe zvarranikët’” (1, 26) – dhe traditës hebraike ose judeo-kristiane. Kjo është pikërisht ajo që diskutohet në faqet e fundit të Le Monde, si vullnet dhe si përfaqësim: “Spinoza nuk mund t’i shpëtonë të qenit hebre: quo semel t’i est imbuta recens servabit odorem [argjila do ta ruajë për një kohë të gjatë parfumin që dikur kishte mbajtur] (Horace, Letra, I, 2, v. 69). Ajo që është plotësisht hebraike tek ai dhe e cila, së bashku me panteizmin, është absurde dhe në njëjtën kohë e tmerrshme, është përbuzja e tij ndaj kafshëve, të cilat ai i sheh vetëm

si objekte të destinuara për përdorimin tonë dhe për të cilat ai nuk pranon të kenë të drejta.”

Kur “llumi” sillet vërdallë me paturpësi

Në një suplement të shtuar pas asaj që ai kishte shkruar në Parerga dhe Paralipomena, në lidhje me botën e kafshëve dhe marrëdhënien tonë me to, Schopenhauer i kthehet kësaj pyetjeje dhe argumenton më thellësisht pikën: “Kafsha në thelb është krejtësisht e njëjtë me atë çka ne jemi: ndryshimi qëndron vetëm tek aksidenti, intelekti dhe jo tek substanca, e cila është vullneti. Bota nuk është një vepër jo cilësore dhe kafshët nuk janë produkt i prodhuar për përdorimin tonë. (...) Nuk është vetëm e vërteta, por edhe morali që është në anën tonë. (...) Përfitimi më i madh nga hekurudhat është se kursejnë miliona kuaj nga ekzistenca e tyre të mjerueshme. »

Fjala e fundit lidh mbërritjen e mbretërimit universal të makinerive me gjendjen e mjerueshme në të cilën një numër i konsiderueshëm i kafshëve janë gjendur të reduktuara për faj të njeriut, por duke theksuar pikërisht një nga aspektet e rralla pozitive të së parës. Kjo është gjithashtu një pikë në të cilën Kraus mund të ndihet relativisht afër Schopenhauer-it, pasi edhe ai është i bindur se mënyra se si njeriu është shndërruar në një adhurues dhe një skllav i makinerive ka të bëjë me konsideratën e paktë që ka për speciet e tjera dhe për jetën në përgjithësi, si dhe me llojin e tiranisë së pamëshirshme që ai, nga ana e tij, bën të mbretërojë mbi një pjesë të botës shtazore.

Padyshim që mund të duket paksa e çuditshme që Kraus këmbëngul mbi çështjen e konsideratës për kafshët dhe të dhunës e mizorive që lufta i detyron të durojnë, në verën e vitit 1916 kur lufta që vazhdohte për gati dy vjet arriti shkallën ekstreme në intensitetin e luftimeve dhe vdekjeve të panumërta. Por ai mundohet t’i bindë lexuesit e tij se njerëzimi do të ishte gabim të mendonte se mund ta trajtojë problemin si pothuajse të papërfillshëm.

Kur kërkohet arsyeja që e bëri të mundur katastrofën si ajo e Luftës së Parë Botërore, nuk duhet harruar të merret parasysh një numër i caktuar karakteristikash konstitutive dhe faktorësh thelbësor, kundër të cilave demokracia sociale nuk gjen më shumë arsye për t’u rebeluar sesa kundërshtarët e saj të borgjezisë.

Kraus reflekton për gjëra me të cilat do të ishte më mirë të përpiqesh t’i përfundosh, në vend që të propozosh t’i fillosh përsëri, duke i amplifikuar dhe përshepuar. Me fjalë të tjera, ne përfundojmë duke e bërë problematike dhe përfundimisht të pamundur mbrojtjen e jetës së tjerëve dhe të jetës në përgjithësi, në gjithçka që ka të bëjë me produktivizmin dhe konsumizmin e shfrenuar, me shfrytëzimin pa kriter dhe të papërmbajtur të burimeve natyrore, me indiferencën ndaj mjedisit dhe degradimin që aktivitetet njerëzore, me vullnetin për pushtet dhe lakminë e tij e pakufinjte që e bëjnë të vuajë gjithnjë e më shumë, mungesa e vëmendjes për kafshët dhe injoranca e vullnetshme dhe kokëfortë e rrezikut që me pretekstin e përmirësimit të mëtejshëm të kushteve të jetesës së species tonë.

Pikërisht për pyetje të këtij lloji një parti që pretendon të jetë revolucionare duhet patjetër, argumenton Kraus, të sillet në një mënyrë që është shumë më revolucionare sesa ç’është demokracia sociale. Por ajo që e pengon atë të jetë

e tillë është gjithashtu për fat të keq, për një pjesë të madhe, interesi që kanë vetë njerëzit që ajo mbron në vazhdimin e procesit i cili duhet të gjykohet, nëse është e mundur, të ngadalësohet dhe ndoshta edhe të ndërprehet.

Ne nuk duhet ta kërkojmë diku tjetër arsyen pse edhe ata që në parim duhet të jenë më të vendosur për ta dëshiruar ndryshimin mund të ndalohen në të njëjtën kohë ta dëshirojnë atë me të vërtetë dhe madje të jenë të vendosur të luftojnë kundër atyre që mund të tundohen të provojnë t’i kundërshtojnë. Kur dikush reflekton, siç kishte bërë tashmë Kraus, për këtë lloj situatë, vështirë se mund të mendohet për ngrohjen globale, për shembull, urgjenca e së cilës po bëhet me të vërtetë ekstreme, njerëzimi sot ndoshta dënohet deri në fund, nëse arrin të shkojë deri aty, të përpiket të krijojë bashkëjetesë midis proklamitës se katastrofa po bëhet pothuajse e sigurt dhe se ndryshimet rrënjësore janë absolutisht të domosdoshme me kërkimin e çdo mjeti të mundshëm dhe të imagjinueshëm për të shmangur dhe të kënaqurit me masat që mbeten, në pjesën më të madhe, pothuajse simbolike dhe ndonjëherë madje edhe tallëse.

Kjo, natyrisht, nuk mund të jetë në asnjë mënyrë një arsye për të konsideruar që, krahasuar me një problem si ky, çështjet e drejtësisë dhe barazisë sociale nuk janë primare dhe madje po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme, ose më pak sekondare. Padyshim se kjo nuk është aspak ajo që Kraus mendonte; dhe ajo çka ai do të donte dhe shpresonte nga demokracia sociale ishte pikërisht të tregonte veten e saj, në dy llojet e pyetjeve, të cilat me siguri nuk mund të trajtohen në mënyrë krejtësisht të pavarur, njëra nga tjetra. Kërcënimi i vërtetë për njerëzimin që paraqitet nga rritja shqetësuese e padrejtësisë dhe e pabarazisë është ende një temë jashtëzakonisht aktuale dhe për të cilën Kraus kishte parë shumë më larg se shumica e bashkëkohësve të tij.

Në përgjigjen ndaj zonjës von X-Y, Kraus bën një lidhje të drejtpërdrejtë midis mënyrës se si zonja shprehet për Luksemburgun dhe miratimit absolut që kanë për luftën njerëzitet si ajo. Krahas letrës së Luksemburgut, do të ishte e nevojshme të botohej edhe në libra “letra e mendjehollës, në mënyrë që të nguliste të të rinjtë jo vetëm respekt për madhësinë e natyrës njerëzore, por edhe neveri përpara poshtëresisë së saj”. Kjo është një nga arsyet pse Kraus shpreh hapur dëshirën që komunizmi të ketë ende një jetë mjaftueshëm të gjatë, qoftë vetëm aq sa për ta parandaluar gjeneratën për të cilën thotë se shijon avantazhet që ka fituar dhe fle qetësisht: “Zoti e mbajtë atë si një kërcënim të vazhdueshëm mbi ata që kanë prona dhe që, për t’i mbrojtur, do t’i dërgonin të gjithë të tjerët në vijën e parë të urisë dhe nderit patriotik duke i ngushëlluar se të mirat materiale nuk janë kryesore. Zoti na ruajtë që ky llum që tashmë po sillet vërdallë me paturpësi të mos bëhet edhe më i paturpshëm, në mënyrë që ata që janë të vetmit që do të kenë qasje në kënaqësi dhe të mendojnë se njerëzimi ka patur mjaft dashuri pasi ta kenë infektuar atë me sifilis të kenë të paktën një gjumë të pushtuar nga makthet “.

“Llumi” për të cilin ai flet ka tani arsye më të mira se kurrë për të besuar se fitoi luftën kundër të varfërve. Ai mund të sillet përsëri me paturpësi dhe të tregojë të njëjtën prije për t’u dhënë leksion viktimave të saj, për t’u dhënë atyre mësim qetësie dhe mençurie, si dhe për t’i shpërguar atyre se nuk kanë asnjë arsye për të ndërjer urrejtje dhe për të ngritur krye kundër atyre që janë përgjegjës për fatkeqësinë e tyre.

FILMI

Moda sipas James Bondit

Model i përsosur i njeriut të bardhë perëndimor me performanca kulmore dhe mbrojtës i pathyeshëm i botës së lirë: kjo është ajo që e simbolizon Agjentin 007, pa ju zbehur asnjëherë imazhi i tij. Sidoqoftë, për gjashtëdhjetë vjet dhe njëzet e pesë filma, spiuni shumë "british" shpesh ikë nga këto klishe dhe kalon kufijtë e papritur:

NGA ALIOCHA WALDLASOWSKI*

Ikonë pop dhe glamuroze e kulturës moderne, personazhi i James Bond-it u krijua nga Ian Fleming në vitin 1953, në Goldeneye, rezidenca e tij xhamajkane. Gazetar i agjencisë së lajmeve Reuters, pastaj ndërmjetës bankash investimesh, Flemingu, lindur në 1908 u rekrutua nga shërbimet e inteligjencës britanike gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ai nisi më vonë të shkruajë romane spiunazhe duke u frymëzuar nga përvoja e tij si agjent ndërlidhës. I shkruar për dy muaj dhe i botuar nga një botues në Londër, Casino Royale, episodi i parë letrar i sagës, u adaptua më 1954 për televizionin amerikanë 'CBS', me aktorin Bary Nelson; e më pas në kinema, më 1967, në një parodi e nënshkruar nga John Huston me dyshen David Niven – Peter Sellers, dhe në fund në filmin e njëzet e një të sagës, më 2006, i cili rinis serinë me Daniel Craig, aktori i fundit për rolin kryesor.

Romani Casino Royale vë në skenë personazhin e 007, agjentin sekret të MI6 dhe shërbimet e inteligjencës britanike. Disa vjet më vonë, John Le Carré do t'i vendosë gjithashtu spiunët e tij, por në një stil krejtësisht të ndryshëm... Për ta krijuar heroin e tij, Fleming frymëzohet nga dy zhanre tradicionale.

Nga njëra anë, hetimi policor amerikan i mes-dy-luftërave, historia hard-boiled e hetuesit privat "të sertë", prej cilëve 'The Maltese Falcon' i Dashiell Hammett është modeli i parë. Nga ana tjetër, romani aventuresk gjeopolitik anglez, i cili ashtu sikur 'Thirty-Nine Steps' e John Buchan, evokon kërcënimin që i kanoset vendit nga komplotet e shoqërive sekrete të rrezikshme. Në dymbëdhjetë romane dhe dy përmbledhje tregime, Fleming do të imponojë (super)heroin e tij, aventurierin e patrembur dhe joshësin plotë sharm.

James Bond ka gjithçka për ta luajtur simbolin e përsosur të Albionit të Madh, të parë nga ana e upper class ("klasa superiore"). Një ish-student i kolegjit të Eton, një shkollë elite e themeluar nga Mbreti Henriku VI, që mban gradën e commander të Marinës dhe mban titullin e Kalorësit të Urdhrit Ushtarak të Saint Michael dhe Saint George. Filmi On her Majesty's Secret service zbulon stemën e tij: ai rrjedh nga Baroneti i Peckham, Sir Thomas Bond, i cili vdiq në vitin 1734, dhe motoja latine e familjes së tij është Orbis non sufficit, "Bota nuk mjafton". Emri i tij është një kolazh midis Bond Street, një rrugë e Haute couture dhe e galerive të artit në Londër dhe St James's Street, në Piccadilly, e cila ka klubin më të vjetër të xhentëlmenëve në kryeqytet.

Skena e tij e parë në ekran në James Bond kundër Dr. No zhvillohet në Rrethin e Ambasadorëve, një sallë private e lojërave në

Londër. Elegant dhe noshalant, mes veglave dhe efekteve speciale, kompletin përgjithësisht perfekt, Bond duket një klishe i pandryshueshëm, mondan dhe adhures i lojërave. Sidoqoftë, secili nga interpretuesit e tij do të sjellë "gjurmën" e tij personale, lidhur me jetën e tyre: me skocezin Sean Connery i cili vjen nga klasa punëtore, fillimisht marinar, shpërndarës porosish ose murator, 007 përfaqëson suksesin dhe me globalizimin e viteve 1980... Sa i përket interpretuesit të fundit, Daniel Craig, ai ndërthur aftësitë fizike dhe melankolinë e paparë, për një hero të errët dhe të brishtë... Por, përmes të gjitha variacioneve të tij, Bond mbetet personifikimi i integritetit të subjektit britanik dhe të besnikërisë ndaj Kurorës.

Humori i tij i ekscentrik tallet me seriozitetin, tallet me veten dhe me konventat. Uellsiani Timothy Dalton amerikanizon karakterin. 007 i tij korrespondon me kodet e liberalizmit ekonomik dhe me globalizimin e viteve 1980... Sa i përket interpretuesit të fundit, Daniel Craig, ai ndërthur aftësitë fizike dhe melankolinë e paparë, për një hero të errët dhe të brishtë... Por, përmes të gjitha variacioneve të tij, Bond mbetet personifikimi i integritetit të subjektit britanik dhe të besnikërisë ndaj Kurorës.

Në misionet e tij, ai shpalo vazhdimisht flamarin britanik: në një parashutë në The Spy Who Loved Me, në një balon me ajër të nxehët në Octopussy, ose në nëndetëse në Dangerously Yours. Ai mban me krenari ngjyrat e Mbretërisë së Bashkuar në gjithë botën, përgjatë aksioneve të skalitura në situatën gjeopolitike të kohës. Kur filmi i parë doli më 5 tetor 1962, Kremlini nisi operacionin ushtarak "Kama", dërgimin e nëndetëseve sovjetike drejt Kubës, brenda kufijve të Floridës. Anija amerikane Yerkon zbulon këtë aktivitet dhe njofton menjëherë Pentagonin.

Ndërsa filmi tregon se Shërbimet Sekrete Britanike mbrojnë Kepin Canaveral nga një kërcënim bërthamor që vjen nga ishulli karaibean i Dr. Jo-së , realiteti i përafrohet : kriza e raketave ndodh në Kubë midis Nikita Hrushovit dhe John Fitzgerald Kennedy. Me një nuancë, trillimi ia jep rolin e mirë diplomacisë britanike dhe kundërpeshon, në ekran, rënien e Londrës në skenën ndërkombëtare.

Vërtetë, skena ku operon Bond është një univers ku Mbretëria e Bashkuar përpigjet ta ruajë prestigjin e saj, pavarësisht nga humbja e pushtetit, madje edhe nga fundi i perandorisë së saj, rënia e saj në sfond nga Shtetet e Bashkuara, ndihmës i të cilit bëhet ai. Bond rrit imazhin e politikës përtej Kanalit La Manche, përballë një bote në ndryshim: në 1962, viti i filmit të parë, Konferenca e Bahamas dhe Marrëveshja e Nassau vulosin "Atlantizimin" dhe anëtarësimin e Londrës në Uashington. Goditje e rëndë, shtatë vjet pas dorëheqjes së Winston Churchill, shpërbërja e Federatës së re të Indive-Perëndimore, e cila bashkonte shumicën e kolonive britanike në



Antilles, Xhamajka, Ishujt Kajman, Trinidad dhe Tobago. Në filma, angazhimi i Bond për shërbimin e Anglisë gjatë Luftës së Ftohtë dhe në sfondin e pavarësisë së kolonive të saj është një përgjigje e dyshimit që ka kapluar zemrat e britanikëve, ngjashëm me mendimin e ish-sekretarit amerikan Dean Acheson: "Britania ka humbur një perandori dhe nuk ka gjetur ende një rol". Bond, xhentëlmen ironik, do ta ngushëllojë Mbretërinë e Bashkuar për humbjen e saj të ndikimit ...

Metamorfoza e tij zhvillohet në tre faza: në një pallat të zbukuruar me lule, transformimi i tij është i pari fizik. I shtrirë në një tavolinë operacioni, para se të veshë një kimono të artë, trupin, flokët dhe vetullat e tij të ndryshuara, ai lë qenien e tij britanike dhe "bëhet" japonez. Faza e dytë është atletike dhe mendore: heroi braktis sofistikimin perëndimor të veglave.

High-tech i 'Q', shefi i sektorit të kërkimit dhe zhvillimit të MI6, mëson trajtimin e armëve tradicionale, sanssetsukon shureido dhe shuriken. Më në fund, hapi i fundit është kulturor dhe dashuror. Bond martohet në një tempull duke ndjekur me përpikëri zakonin: ai bashkohet me Kissy Suzuki pas leximit të lutjes, këngës dhe ritualit të pastrimit. I veshur me rroba të peshkatarit, ai vendoset në ishullin e vogël Matsu me gruan e tij, në zemër të një arkipelagu vullkanik. Në The Spy who loved me, ai shndërrohet në një beduin dhe nisët për një udhëtim të heshtur në shkretëtirë. Në Living Daylights, ai kalëron një kalë, i veshur me çallmën e Muxhahedinëve në malet e Afganistanit. Me një kartë identiteti të rremë, ai sovjetizohet dhe bëhet Jerzy Bondov.

Fleming u ushqye nga imazhi i spiunëve të famshëm, si eleganti Sidney Reilly, i lindur në Ukrainë, agjent efektiv anti-komunist, aviatori kanadez William Stephenson, shumë i zgjuar Wilfred Dunderdale i dhënë pas vajzave të bukura dhe anëtar i shoqërisë së lartë, apo edhe oficeri i marinës Patrick Dalzel-Job, i njohur për një akt kumbues të mosbindjes humaniste gjatë luftës, dhe të cilin Fleming duket se e ka njohur. Por është e mundur që frymëzuesi i tij i vërtetë nuk ishte anglez, por serb: Dandy enigmatik Duško Popov i lindur më 1912 në Vojvodinë, adhures i pijeve dhe i kazinove, hoteleve luksoze dhe makinave sportive. Playboyi Popov është një agjent jugosllav (i dyfishtë), me emrin e koduar Tricycle. Gjatë luftës, ai informoi britanikët për veprimet e gjermanëve. Ai madje përpigjet të

paralajmërojë John Edgar Hoover për sulmin e afërt në Pearl Harbor, por shefi i Byrosë Federale të Hetimit (FBI) nuk e beson atë. Fleming u takua me të në 1941 në Estoril, Portugali dhe ishte mjaft i impresionuar nga gjakftohësia e tij kur blofoi gjatë një loje me baccarat sa për ta bërë atë modelin e Bondit të tij. Gjë që në autobiografinë e tij, Popov do ta konsiderojë si "fyerje të inteligjencës së tij" ...

Siç vuri në dukje Umberto Eco, është e vështirë të mohosh që Fleming në romanet e tij "tregon anti-komunizëm të brendshëm". Sidoqoftë, filmat nganjëherë janë befasues nga ky këndvështrim. Ndonjëherë Bond i afrohet më shumë shërbimeve sekrete sovjetike se amerikane. Me kalimin e kohës, bashkëpunimi gjeopolitik midis Londrës dhe Moskës bëhet i dukshëm. Bond preferon të punojë me agjentë sovjetikë dhe të shkojë përtej antagonizmit klasik të Luftës së Ftohtë: ai bashkohet me majorin Anya Amasova të KGB-së në The spy who loved me, me spiunen Pola Ivanova në filmin Dangerously Yours, ose me gjeneralin Gogol në Octopussy. KGB dhe MI6 janë aleatë, edhe pse aleati "natyror", Agjencia Qendrore e Inteligjencës (CIA), shpesh është tallur përmes karakterit që e përfaqëson, Felix Leiter, si i ngathët, kureshtar dhe disi budalla. Dallimi midis realitetit dhe trillimit është nganjëherë i qartë: në 1984, me pretekstin e mbrojtjes së interesave të vendit të tij, Ronald Reagan zhvilloi një luftë të përgjakshme në Nikaragua kundër qeverisë socialiste Sandinista. Në të njëjtën kohë, në ekranet në Dangerously Yours, James Bond dekorohet me Urdhrin e Leninit nga duart e Gjeneralit Gogol, shefit të KGB-së. Kjo miqësi e re anglo-sovjetike bën të mundur luftën kundër armikut të të gjithë popujve, organizatës ndërkombëtare kriminale Spektri. Duke lënë mënjanë aksionet strategjike të kampit të tij për t'u lidhur me armikun e botës së lirë në mënyrë që të përballon me një rrezik global dhe të përbashkët, Bond rrënjos efektivitetin e soft power-it të tij: madhështia britanike di të shkojë përtej mbrojtjes së interesave të saj, për t'u ngritur në mbrojtje të njerëzimit ...

* Autor i librit 'Les Cinq Secrets de James Bond' (Pesë sekretet e James Bond-it) , Max Milo, Paris, 2020.

REDAKSIA E BOTIMIT NË SHQIP

Botues: Instituti "Musine Kokalari" - Prishtinë (Kosovë)**Drejtör:** Belgzim Kamberi**Kryeredaktor:** Ardit Rada**Redaksia:** Leart Kola, Shkodran Hoti**Përkthimi:** Lemanë Muriqi, Nerimane Kamberi, Bora Deda, Belgzim Kamberi**Layout design:** Josif Xhemali**Email:** botadiplomatiqe@gmail.com

Édité par la SA Le Monde diplomatique.
Actionnaires: Société éditrice du Monde,
Association Gunter Holzmann,
Les Amis du Monde diplomatique
1, avenue Stephen-Pichon, 75013 Paris
Tél.: 01-53-94-96-01. Télécopieur: 01-53-94-96-26
Courriel: secretariat@monde-diplomatique.fr
Site Internet: www.monde-diplomatique.fr

Directoire: Serge HALIMI,
président, directeur de la publication
Autres membres: Vincent CARON, Bruno LOMBARD,
Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Directrice des relations et des éditions internationales:
Anne-Cécile ROBERT

Secrétaire générale:
Anne CALLAIT-CHAVANEL
Directeur de la rédaction: Serge HALIMI
Rédacteur en chef: Benoît BRÉVILLE
Rédacteurs en chef adjoints:
Martine BULARD, Renaud LAMBERT
Cheffe d'édition: Mona CHOLLET
Rédaction: Akram BELKAÏD, Philippe DESCAMPS,
Evelyne PIEILLER, Hélène RICHARD,
Pierre RIMBERT, Anne-Cécile ROBERT
Cartographie: Cécile MARIN
Site Internet: Guillaume BAROU, Thibault HENNETON

Conception artistique:
Maria IERARDI, Boris SÉMÉNIAKO
(avec la collaboration
de Delphine LACROIX pour l'icongraphie)
Rédacteur documentaire: Olivier PRONET
Mise en pages et photographie:
Jérôme GRILLIÈRE, Patrick PUECH-WILHEM
Correction: Xavier MONTHEÂRD, Sarah ZHIRI

Directeur de la gestion: Bruno LOMBARD
Directeur commercial,
chargé de la diffusion numérique: Vincent CARON
Contrôle de gestion: Zaia SAHALI
Secrétariat: Yuliya DAROUKA (9621),
Sophie DURAND-NGÔ, attachée communication
et développement (9674), Eleonora FALETTI (9601)
Courriel: prenom.nom@monde-diplomatique.fr
Fondateur: Hubert BEUVE-MÉRY. Anciens directeurs:
François HONTI, Claude JULIEN, Ignacio RAMONET

Publicité: Hélène FAVERIE (01-57-28-38-03)
Diffusion, mercatique: Brigitte BILLIARD, Saveria COLOSIMO-MORIN, Sophie GERBAUD, Sabine GUDE, Carole MERCERON, Christiane MONTILLET
Relations marchands de journaux (numéro vert):
0805-050-147

Service relations abonnés
● Depuis la France: 03-21-13-04-32 (non surtaxé)
www.monde-diplomatique.fr
● Depuis l'étranger: (33) 3-21-13-04-32

Reproduction interdite de tous articles,
sauf accord avec l'administration
© ADAGP, Paris, 2019,
pour les œuvres de ses adhérents
Prix de l'abonnement annuel à l'édition imprimée:
France métropolitaine: 59 €
Autres destinations: www.monde-diplomatique.fr/abo

FAQE 2-3
(Pa)drejtësia ndërkombëtare dhe narracioni i (pa)mundur i luftës çlirimtare,
NGA BELGZIM KAMBERI

FAQE 3
Një rezultat që nuk do të pranohet,
NGA SERGE HALIMI

FAQE 4
Specialja shqiptare,
NGA JAKIN MARENA

FAQE 5
Për një pension realisht universal,
NGA ANNE DEBREGEAS*

FAQE 6
Rikthimi i diplomacisë transatlantike në Ballkan,
NGA DRILON S. GASHI

FAQE 7
Vala demokratike drejt digave të pushtetit serb,
NGA DEJAN ILIQ

FAQE 8-9
Beteja gjeopolitike rreth 5G,
NGA EVGENY MOROZOV*

FAQE 10-11
Midis identitarizimit të fesë dhe fetarizimit të identitetit,
NGA SHKODRAN HOTI

FAQE 12
Të nxirret nga hijja grujaja parahistorike,
NGA MARYLÈNE PATOU-MATHIS

FAQE 13
Libani, prej dy shekujsh në kërkim të kombit,
NGA NGA GEORGES CORM*

FAQE 14
« Le të rrëzohet regjimi i bankave »,
NGA E DËRGUARA JONË SPECIALE DOHA CHAMS*

FAQE 15
Në Bjellorusi, rinia urbane në vijën e parë,
NGA I DËRGUARI YNË SPECIAL LOÏC RAMIREZ*

FAQE 16-17
Ç'do të thotë t'i trajtosh kafshët me mirësi?,
NGA JACQUES BOUVERESSE

FAQE 18
Moda sipas James Bondit,

NGA ALIOCHA WALDLASOWSKI*